

KRITERET
ose
DRITAT E RRUGËS
(ese, gjykime e aforizma)

M. Fethullah Gylen

Tiranë, 2012

KRITERET

ose

DRITAT E RRUGËS

(ese, gjykime e aforizma)

Titulli i origjinalit: Ölçü veya Yoldaki Işıklar

M. Fethullah Gylen

Përktheu: Dr. Mithat HOXHA

Redaktoi: Silvester MANAJ

ISBN: 978-99927-944-1-0

PËRMBAJTJA

PREZANTIM 13

MBI UDHËTIMIN PËRTEJ 15

UDHËTARI 19

PJESA E PARË: NGA PIKËVËSHTRIMI I URTËSISË

Mbi dijen 25

Pritshmëria nga shkenca 26

Ditura dhe injoranca 30

Respekt për mendimin 31

Feja 32

Kurani 35

Profeti Muhamed (pqmT) 40

Tasavufi 41

Kultura 44

Liria 45

Qytetërimi 47

Përparimi 49

Arti 51

Letërsia 53

Poezia 58

Jeta dhe shpirti 63

Mrekullia dhe thagma 66

Ëndrra 67

Pasioni 70

Femra 74

Natyra 79

Largpamësia 80

Ndjenja dhe ndijimi 82

Vezullime urtësie, ose sipas filozofisë 85

Urtësia 90

Ndërgjegjja nga këndvështrimi i urtësisë 95

Dija nga këndvështrimi i urtësisë 97

Nderi në gjuhë të urtësisë 99

Gënjeshtër në sy të urtësisë 101

Urtësia dhe virtyti	102
Shtypi në horizontin e urtësisë	103
Tërheqja ndjesore nga këndvështrimi i urtësisë	104
...Dhe njeriu u mashtrua	105
Historia është e mbushur me shembuj mësimdhënës	105
Gjërat e vogla që bartin mbi supe gjërat mëdha	106
Mbi kohën	106
Mallkimet	107
Shoku perëndimor	107
Parajsa	107

PJESA E DYTË: NJERIU DHE SJELLJET E TIJ

Njeriu	111
Respekt ndaj njeriut	112
Drejtëpeshimi mes trupit dhe zemrës	113
Toleranca dhe mirëkuptimi	115
Thjeshtësia	117
Njerëzorja	119
Burrëria dhe bujaria si veti të larta njerëzore	121
Mëkati dhe pastrimi	124
E fshehta dhe mbajtja e saj	125
E keqja e gjuhës	128
Premtimi	131
Kujdesi dhe maturia	131
Mirë më mirë	132
Sjellja dhe veprimi	133
Tërësia e ndjenjave të larta	134
Dhuntia dhe vetëdija e dhuntisë	135
Altruizmi ose vetëmohimi	136
Besimi monoteist dhe dashuria për Allahun	136
Pishtari i errësirës	138
Bota e brendshme	138
Mendimi për mirë	139
Shoqëria dhe miqësia	139
Njerëz të shtrenjtë	141
Kapitali më i madh	141

Vdekshmëri	142
Të qash e të qeshësh	142
Mbi frikën dhe shpresën	143
Dy ditë për çdokënd	143
Spektri i të qarit e i të qeshurit	143
Ai me jetën të begatë	144
Jeta e vërtetë	144
Vetmi	144
Thellësi	145
E keqe	145
Ca sëmundje zemre	145
Pangopësia	146
Zhgënjim	146
Injoranca	147
Fytyra e vërtetë e kësaj bote	147
Shpirtrat mëkatarë	148
Çiliminj	148

PJESA E TRETË: ÇËSHTJE MORALE, ETIKEDHE SHOQËRORE

Kombi	151
I riu	152
Rinia	153
Martesa dhe foleja familjare	154
Divorci	156
Prindërit	158
Fëmija	159
Të drejtat e fëmijës	161
Morali dhe etika	163
Virtyti	164
Edukata	166
Këshilla	169
Këshillimi	170
E drejta	172
E drejta dhe drejtësia	173
E mira dhe e keqja	174
Republika	174

Politika	176
Xhamitë dhe funksionet e tyre	184
Tregtia	185
Mbi gjuhën	187
Mendimi makiavelist	187
Fitorja e së mirës dhe e së bukurës	187

PJESA E KATËRT: PERSPEKTIVA TË VEPRIMIT

Pikat e përbashkëta	191
Njeriu i shërbimit	208
Burrave të këshillës	209
Besimi i më të lartëve	212
Therorët e dashurisë	213
Qëllimi dhe mjeti	213
Këshillimi	215
Maturia	216
Durimi	219
Jo zemërim, por qëndresë!	220
Kthimi dhe qëndresa	223
Besimtari një herë gënjehet	225
Antagonistët	227
Mendimi për të shërbyer	229
Përfaqësuesi i çdo niveli	229
Uniteti brenda-jashtë	229
Shpirti ideal	230
Vullnetet e larta	230
Të vetmuarit	230
Rruga e popullit	231
Mendimi për t'u marrë vesh	231
Në fillim plan	232
Plani	232
Fundi dhe rezultati	232
Njeriu i kauzës	233
Pretekst-qëllim final	233
Preteksti i paqenë	233
Pasioni pas rehatisë	234

Pasioni për post	236
Tensionimi i humbur	239
Defekt mase	239
Dy qëndrime ekstreme	239
Përfytyrime prej beduini	240
Vorbulla e egoizmit	240
Në rrugën e pafundësisë	243
Lutje	246

PREZANTIM

Beili (Bailey) thotë: “Jetëgjatë janë ata që mendojnë shumë.” Të njëjtën ide, Xhejms Ellën (James Allen) e shpreh kështu: “Lëvizja është bulëzimi i mendimit, gëzimi apo dëshpërimi, fryti i tij!” Dhe kështu, njeriu jeton me fryte të ëmbla ose të hidhura, të cilat janë vepra e vet. Fakti që profeti Muhamed e ka konsideruar një orë mendim më me vlerë se sa adhurime suplementare shumëvjeçare, bart një rëndësi krejt të veçantë përse i përket vlerës së mendimit.

Mendimi është foshnja e përkëdhelur e një truri që heq të prerat e lindjes. Kur Dekarti thoshte, “Mendoj, pra jam!”, përmblihte në dy-tri fjalë qëllimin dhe synimin e jetës, urtësinë dhe shkakun e ekzistencës!

Ashtu siç ndodh që një ide e menduar para nesh nuk bëhet pengesë që atë ide ta mendojmë edhe ne, ashtu edhe një ide e menduar prej nesh nuk bëhet pengesë që edhe të tjerët ta mendojnë atë! Vetëm se asnjëri prej nesh nuk mund ta shprehë të njëjtën ide me të njëjtën formë mendimi. Forma e të shprehurit e cila, në përgjithësi, quhet stil i të shprehurit, është e pafundme në shumëllojshmërinë e saj si dhe identitetet vetëm i vetvetes. Për rrjedhojë, stili i të shprehurit i çdo njeriu është i ndryshëm. Nëse pranojmë se stili ndikon mbi mendimin, atëherë, dy ide, në pamje si identike, do të paraqesin një ndryshim të dallueshëm, të paktën nga ky pikëvështrim.

Mendimi është dhunti, kurse formësimi i tij, aftësi. Ekzistenca nuk i nxjerr në shesh të fshehtat e saj vetvetiu; ato i zbulojmë ne duke kaluar nëpër shtigjet e mendimit. Edhe vetë ligjësitë e mendimit, me anë të mendimit i zbulon njeriu. Uniteti shkak-pasojë në formën e tij më të bukur vetëm në mendim ekziston.

Nëse pas lodhjes së shkaktuar prej përpjekjes të pazë, por gjigante në mjedisin intim të meditimit, arsyeja dhe logjika e thatë nuk ia presin udhën frymëzimit e nuk i bëhen pengesë imagjinatës të shpalosë flatrat, nëse, nga ana tjetër, frymëzimi dhe imagjinata nuk i thonë jo filtrit të arsyes dhe logjikës realiste, do të thotë se është ndezur, më në fund, shkëndija e shenjtë e quajtur ide! Kështu, idetë janë, për të gjithë njerëzimin, një pasuri kurdoherë e re!

Mendimi është ngjitje spirale e njohjes, ardhje e vetëdijes në formën e fjalës së bukur, ekuilibër mendje-zemër, begati e komunikimit kolektiv, far i orientimit, atlas i përvojës, tufë rrezesh e kumtesës, buzëqeshje e ngacmimit, buqetë e frymëzimit, hauz fshehtësish, informacion efektiv, trarë ideali, alfabeti Mors i misionit. Dhe, me aspektin e veprës që keni në dorë, silueta e përmbajtjes me dekor drite!

Shtëpia jonë botuese është e lumtur që po jua ofron juve, lexues të respektuar, “Kriteret ose Dritat e rrugës” me këto ndjenja e mendime!

Me dëshirën që ta shoqëroni me përpjekjen për të menduar...

Shtëpia Botuese “PRIZMI”

MBI UDHËTIMIN PËRTEJ

O më i Larti i të lartëve!

Ndërsa merrnim krahë me shpirtin tonë duke soditur ekspozitat që i shtrove përgjatë rrugës sonë e pastaj na ftove për t'i parë, duke soditur më të spikaturat, më të çuditshmet veprat e Tua artistike, të cilave u dhe trajtat më të përsosura, duke soditur më të shkëlqyerën e më poetiken e atyre pikturave syverbuese e marramendëse, që i vendose në zemër të natyrës e cila është një revistë arti e Jotja e që Ti i solle ato në formën e një valleje mijëra ngjyrash si shfaqje të bukurive të Tua të fshehta, si dhe duke të ndjerë e duke të parë Ty në gërvimën e lapsit Tënd e në harmoninë e librit Tënd, të cilin e shkrove me atë laps dhe e vure në shesh, pra, ndërsa merrnim krahë, kështu, me anë të shpirtit tonë, na mbetën sytë në burimin e të gjitha rregullsive dhe akordeve të dukura nga të çarat e hapura nën dritën e emrave të Tu, në burimin e të gjitha ngjyrave dhe trajtave të soditura, në burimin e tingujve dhe zërave të dëguara prej gjithkrah, si dhe të koreve e simfonive të krijuara prej tyre, dhe atëherë, zemrat, me atë enigmën e botëve të larta që është burimi i gjithçkaje, na ranë në dalldi...

Duke u kredhur në soditjen e së përtëjshmes nga ato dritaret veç e veç të hapura për syrin e zemrës e të besimit, guxua të vëzhgonim formën origjinale, si një pemë të bërthamës së Tuba-s¹ së zemrave tona dhe u nisëm drejt një udhëtimi shumë të gjatë, shumë të vështirë, por dhe shumë kënaqësi dhe kërsërindjellës për përtej, drejt një udhëtimi që zgjatet e shkon përtej e më përtej. Dhe, duke e bërë këtë, duke e bërë Fjalën Tënde prijës për shpirtin tonë, u derdhëm rrugëve të bërë me flatra nën rrezet ndriçuese të emrave dhe atributeve të Tua, të bërë me flatra me të vërteta dritash që shkojnë rrugë-rrugë drejt pafundësisë.

Dhe nëse në një udhëtim të tillë sublim të përshkruar dhe lejuar në Fjalën Tënde, me hartën të vizatuar me hollësitë më të imta, në një udhëtim për të cilin, pas hapjes, më në fund, të të gjitha dyerve me miraxhin e një të Lumturi, lindi mundësia për secilin burrë të zemrës të ngjitet në ato botë me anë të karrocës mbretërore të zemrës, e kapërcyem masën dhe prekëm në tokmakun e dyerve enigmatike të Tua, po ia lemë fajin paturpësisë së shpirtit tanë të pagdhendur, që s'dinë se ç'është edukata dhe mirësjellja dhe, duke u strehuar në mirëkuptimin Tënd të gjerë, të lutemi të na falësh...

O Krijues i Lartë, i Bukuri i të bukurve, që na ke dhënë ekzistencë e që i ke bërë ndjesitë tona të shijojnë kënaqësinë e pafundme të ekzistencës! Ti je, që na e ke shtruar para si një libër këtë gjithësi të stërmadhe, dhe prapë je Ti që na i ke bërë ndërgjegjjet ta ndejnë enigmën e saj, asisoj që ndërgjegjjet tona i ke bërë një breg për dallgët e enigmës hyjnore! Ne nuk do të ekzistojmë po të mos na kishe bërë Ti të ekzistojmë. Po të mos na e kishe hapur këtë gjithësi të shkëlqyer para si një libër e të na e tregojë dhe shpjegojë me anë të protokollarëve dhe ciceronëve të Tu të lartë², do të shembeshim e do të shkonim si një tufë injorantësh që s'të njihnin, që nuk kishin mundur të arrinin dot nëpër thellësitë e ndjesive. Dhe si do t'i njihnim këto, dhe Ty, dhe si do të jepeshim me mahnitje pas rrugës Sate, nëse nuk do të kishe mirësinë të na e përshkruaje Veten, nëse nuk do të shtresojë në shpirtin tonë atë miratuesin e parë që kap e mbërthen gjërat që dimë e nuk dimë për Individualitetin e Lartë, duke siguruar lidhjen mes botëve të jashtme dhe ndërgjegjeve tona e u jep atyre gjërave formë e orientim, që e bën diturinë dituri dhe intuitën intuitë?

¹ Pemë në Parajsë. Shënim i përkthyesit.

² Është fjala për Profetët. Shën. i përkth.

Ne jemi robërit me kular në qafë të portës Sate, kurse përshndritjet që reflektohen pa prâ ndërgjegjeve tona, janë drita e ekzistencës Tënde. Ç'të kemi ne në dorë, është e dhënëprej Teje, dhurata Jote. Edhe një herë tjetër po e shpallim këtë; me pohimin se jemi robëri e portës Sate që s'pranojnë çlirim, po duam të përsërisim betimin tonë!

O Mbreti i zemrave, përmendja e të cilit u jep besim e siguri shpirtrave që mendojnë! Për t'ua çuar gjërat që ua mësove dhe përçove shpirtrave tanë, atyre me zemra të vdekura e endacake sikurse zemrat tona, u përpoqëm të hulumtojmë dhe përcaktojmë dritaret që shohin kah gjërat që ndodhin, dhe nga kjo ecuri e përgjithshme për kah ekzistenca Jote, duke u futur vende-vende në vorbullën e materies dhe dukurive, e duke u kthyer kohë më kohë edhe në vetvete, rrugët që do të na ngjisinin për në audiencën Tënde! Ndërkaq, duke dashur t'ua bëjmë të ditur zemrave nevojtarë Individualitetin Tënd të Lartë dhe atë ditë të lumtur kur do të takohemi me Ty pa pasur kurrfarë pengese, nuk mundëm t'u mbeteshim besnikë të vërtetave të larta të vizatuara dhe qëndisura nga shprehjet më të hapura e më të kthjellëta. Me mendimin për t'u treguar disa gjëra ca shpirtrave të pagdhendur të mbetur në lëvozhgë e me zemrën të dhënë pas bukurive sa për dukje të kësaj bote, u hoqëm nga një lustër lëndës dhe konkretes duke lëkundur muret e shenjta të abstraktes. Mos ndofta mëkatuam se nuk mundëm t'u ofronim të vërtetat më të hapura brenda dëlirësisë së tyre origjinale, mos ndoshta u bëmë shërbim dëshirave dhe iluzioneve tona?

Në paçim bërë gabim, kemi bërë duke ardhur tek Ti dhe duke u përpjekur për t'u treguar udhë të tjerëve. Në paçim bërë faj, në udhën Tënde kemi bërë. Gabimi mbetet gabim, gjithmonë, e faji, faj. Me zemrat në dridhje, me shpirtrat përthyer më dysh, me kularë në qafa, jemi duke pritur me tërë qenien tonë vendimin që ke për të dhënë ndaj nesh. Dhe, duke thënë këtë, e dimë se mëshira Jote që zgjatet e shkon gjer në pafundësi, gjithmonë është kudogjendur para ndëshkimit Tënd. Është jashtë çdo diskutimi se rojave të portës Sate që i kanë njohur favoret e Tua, nuk u ka hije faji, vetëm, të lutemi, ki mirësinë të na lejosh të themi se falja Ty të ka hije shumë!

Po, Zoti im, Mbretit i ka hije mbretëria dhe lypësit, përgjërimi!

E, tani, në na falsh, duke ruajtur të vërtetën e udhëtimit për përtej, për në vendin më të veçantë të zemrave tona, duam t'i trazojmë fletët e librit Tënd të kësaj gjithësie, të kridhemi në lexime tejet të gjata me një mendim udhëtimi të ri, t'i dëgjojmë lajmëtarët që flasin për Ty dhe saora të biem në ekstazë me thirrje drejtuar Ty.

Dhe, duke u dhuruar krahë për fluturim nevojtarëve e endacakëve që kërkojnë të arrijnë në kuvendin Tënd, gëzoji ata me takimin me Ty!

Udhëtari

Njeriu është një udhëtar, kurse botët, ekspozita shumëngjyrëshe, ofruar studimit të tij, libra të dendur me informacion e të ilustruar. Udhëtari është dërguar në këtë botë për t'i lexuar këta libra, për ta shtuar kulturën dhe për t'u lartësuar më tej si njeri. Ky udhëtim i këndshëm e shumëngjyrësh çdo njeriu një herë të vetme i mundësohet dhe pandeh se për ata që i kanë zemrat të zgjuara e mendtë në kokë, ky udhëtim i vetëmith mjafton dhe tepron për të ngritur parajsa si ato kopshtet e famshme të varura të Babilonisë! Kurse ata që jetojnë me sy lidhur për të mos parë, s'merret vesh se kur erdhën e kur shkuan: vijnë e ikin shpejt sa një frymë, pa lënë asnjë gjurmë pas...

Dikush që mendon thellë mbi ligjet e natyrës e të jetës, duke i vlerësuar ato, sheh, që nga ngjyrat përshndritëse të luleve, te degët e pemëve që lëkundën, nga bubullimat drithmështirëse të rrufeve te zërat harmonikë të zogjve, në çdo gjë, lojërat e një bukurie të pafundme, duke ndjerë në çdo zë reflektimin e Qenies Fuqipashtershme; në dritën, nxehtësinë, gravitetin, marrëdhëniet kimike dhe dukuritë dhe ligjet e prires dhe administrimit të gjallesave, vëzhgon gjurmët dhe shenjat e shfaqjeve hyjnore.

Kur shpirti largohet nga kjo atmosferë e zhurmshme e rrapëllimtare e botës lëndore, duke u zhytur në thellësitë e botës unike, bie në dalldi duke soditur atë shfaqjen shkëlqimplote të Krijuesit të Lartë në tërë gjithësinë. Për ata që në ndjenjat e tyre kanë arritur në një takim të tillë hyjnor, dhe e kanë lëshuar veten në baticë-zbaticë mes dallgëve të ekstazës dhe mbylljes në vetvete pafundësisht, trazia dhe gjëmimi që përshkon tej e tej oqeanet, peizazhi i pazë i korijsve të qeta, qëndrimi hijerëndë i majave të maleve që maten me retë, hijet e mbrëmjes që luajnë në rrëzë të kodrave të blerta dhe aromat lloj-lloj, që e dehin mjedisin përreth, të përhapura nga bahçet me ato pamje magjistare të shtrira nëpër të gjithë sipërfaqen e tokës, lulet e vockla që përkëdhelen me filladin, dhe vesa që ka ngritur fronin te lulet e që lëshon buzëqeshje përgjithkrah, për ata, pra, të gjitha këto, ç'mund të jenë tjetër, përpos reflektimeve mbi bukuritë pashtershme të Tij.

Pasi që çdo zë të jetë një thirrje prej Tij dhe çdo gjë një shenjë e Tij, ç'rëndësi ka nëse ne e njohim apo jo natyrën e Tij? Poeti gjerman, Gëte, thoshte: "Ne e ndiejmë ekzistencën e Zotit edhe në natyrë, edhe në shpirtin tonë. Ç'rëndësi ka nëse nuk ia dimë esencën? Me të vërtetë, ç'dimë ne mbi natyrën e Hyjnisë? Fundja, ç'vlerë kanë mendimet tona të kufizuara e të ngushta për Zotin? Edhe sikur ta kujtoja Atë me qindra emra dhe një sërë atributesh, prapëseprapë do të mbetesha shumë shumë poshtë nivelit të së vërtetës. Meqë qenia e lartë që i themi Hyu, shfaq atributet e Tij në çdo trajtë, jo vetëm te njeriu, por edhe te të gjitha dukuritë e mëdha e të vogla të gjithësisë, te zemra e pasur dhe e fuqishme e natyrës, a mundet që ideja sipas karakteristikave njerëzore që mund të përftojmë mbi një Individualitet të tillë të Përsosur, të jetë e mjaftueshme dhe e patëmetë?" Me këto fjalë Gëteja tërhoqte vëmendjen mbi atë Qenien e Panjohur, që e tregon veten me anë të veprave të veta, teksa nuk është e urtë që të shfaqet me Individualitetin e Tij në jetën e kësaj bote.

Edhe ne mendojmë udhëtarë dhe udhëtime për atë Individualitetin e fshehtë për sytë, i Cili kërkon të na e bëjë të njohur Vetën me anë të veprave të Veta, jemi kah kemi dalë në një udhë që s'i vjen fundi, për t'u ndodhur gjithherë në udhën e Tij duke kapërcyer portat e hapura për tek Ai. Dhe jemi të vendosur që, sa të jetë bota, ta gjëmojmë gjithkrahjen me këngë kushtuar Atij... E si të mos e gjëmojmë kur ne dhe çdo gjë jemi këtu për ta njohur Atë dhe për ta bërë të njohur dhe kur nuk dimë detyrë më të lartë se këtë? Të gjithë ne s'jemi veçse hije të qenies së Tij, kurse Ai, burimi i çdo gjëje, synimi përfundimtar i çdo gjëje!

Ai është që i bën të shpërthejnë ujërat nga thellësitë e tokës dhe të rrjedhin çezme nga bujaria e Tij, që i lidh diellit brez prej drite e i vë në kryet kurorë prej nxehtësie, që e zbukuron tokën me lule ngjyra-ngjyra e që i vesh sipërfaqes një mijë e një forma. Prej Tij e kanë qenien qiejt, dheu dhe detet e pamatë. Retë rrinë e e shohin Atë me sytë e deteve, kurse detet e përmendin Atë me gjuhën e reve. Ai është që e mbush barkun e tokës me një mijë e një dhimbje, që i ngjyen në gjak të kuq mushkëritë e koraleve. Diejt janë roje të portës së Tij, kurse botët, skllëvërit me qafën nën kular të Tij!

O Krijues i Lartë! E gjithë pasuria dhe mbretërimi i kësaj bote të është nënshtuar Ty nën flamurin Tënd dhe të gjithë mbretërit shërbejnë si shërbëtorë në portën Tënde! Çdo gjë vrapon për tek Ti, qenia prej Teje lypet, kurse Ti je i qenë në vetvete! Qeniet e krijuara krijohen, trajtësohen dhe, pastaj, shuhën e mbarojnë, kurse Ti je diametralisht i kundërt me to! Ti je një i vetëm. Je i pashoq. I tëpanevojë! Të gjitha qeniet, tek uniteti Yt e kanë shpresën. Uniteti Yt është uji jetëdhënës i të mbeturve në shkretëtirë, parajsa e tyre. Këto toka, me urdhrin Tënd rrinë në vend. Kupa e qiellit, me fuqinë dhe vullnetin Tënd e ruan harmoninë. Po që se të gjitha këto nuk do të mbështeteshin tek Ti, yjet do të shpërndaheshin nëpër gjithësi si kokrrat e një rruzareje të këputur e këtë askush nuk do të mund ta pengonte!

Ne të gjithë, me Ty e arritëm lumturinë. Duke të njohur Ty, e njohëm se ç'do të thoshte lumturi e vërtetë. Ne ikim prej lumturisë që s'vjen prej Teje e s'mbështetet tek Ti, e mallkojmë lumturinë që bën të harrohesh Ti. Është e domosdoshme të heshtet e të ndihet zemërim ndaj çdo gjëje që s'flet për Ty e të lihen në harresë ata që s'të kujtojnë Ty!

O Krijues i Lartë me mëshirë të pasosur! Si skllëvër të portës Tënde dhe rob të Tu besnikë e të vendosur për të kaluar, me këtë synim, nëpër botë dhe përjetësi, s'iu përkulëm e s'iu bëmë rob askujt gjer më sot! Askujt tjetër s'ia hapëm zemrën për t'ia qarë hallin tonë. Edhe nëse ia hapëm, u penduam shpejt e, me një mijë pendesa, u kthyem nën strehën Tënde sërish për t'u strehuar! Mbushua Ti me dashurinë Tënde kupat atyre që s'janë ndarë nga kjo portë dhe bëjua fytyrën t'u qeshë atyre që prej shekujsh s'u ka parë buza buzëqeshje!

O Ti, shpresa dhe qetësia e të mbeturve në zi! O i zoti i të vetmuarve! O shërimi i të pashpresëve për shërim! Hap një perde për robërit e Tu të mbetur pa shërim, shuajua urinë dhe jepu shërim! Dëshëm të të tregonim Ty me anë trajtash dhe pikturash dhe bukuritë e Tua që i ndjemë në ndërgjegjjet tona me këto, deshëm t'ua përcjellim edhe të tjerëve që t'i ndejnë... Nëse me këtë përpjekje i kemi dëmtuar të vërtetat e larta që s'mundëm t'i njihnim, të kërkojmë falje, falna ne!

PJESA E PARË

NGA PIKËVËSHTRIMI
I URTËSISË

Mbi dijen

Qëndrimi larg shkencave pozitive duke pasur frikë se mos çojnë në ateizëm, është foshnjarake; po ashtu, edhe trajtimi i tyre si pretekst që çon në mohim, duke i parë ato në tërësi si antagonistë të fesë dhe besimit, është paragjykimdhejorancë!

* * *

Shkencat janë të dobishme me aq sa na e garantojnë lumturinë duke na lartësuar në vlera njerëzore. Në të kundërt, shkenca dhe teknologjia që e bëjnë njeriun të përjetojë ëndrra të frikshme, janë nga një shtrigë e një djall që na ka zënë udhën!

* * *

Në krye të shekullit të kaluar, dikush, në kundërshtim me një pjesë materialistësh dritëshkurtër të cilët e patën hyjnizuar shkencën duke ia kushtuar çdo gjë asaj, i godiste në formën më delikate përçartjet e çuditshme që patën mbështjellë një shekull të tërë, duke thënë: “Shkenca pa fe është e verbër, feja pa shkencë, e çalë!” S’e di se ç’do të thoshte, po t’i shihte këta tanët sot, që janë edhe të verbër, edhe të çalë!”

* * *

Pretendimi se shkencat pozitive s’janë asgjë, është fanatizëm i tepruar dhe injorancë, ndërkaq që hedhja poshtë e çdo gjëje jashtë tyre, është sektarizëm naiv, kurse njohja dhe pranimi, nën dritën e çdo njohurie të re të mësuar, se janë edhe male të tëra të vërtetash të panjohura, është mendësi shkencore dhe orientim mendimi!

* * *

Shkenca dhe teknika janë në shërbim të njeriut dhe s’ekziston asnjë shkak serioz për t’u trembur prej tyre. Rreziku nuk është te shkenca dhe ngritja e një bote sipas shkencës. Rreziku është te injoranca, pavetëdijshmëria dhe shmangia nga marrja e përgjegjësisë!

Pritshmëria nga shkenca

Meqë jeta e vërtetë për njeriun mundësohet me shkencë dhe kulturë, ata që e lënë pas dore mësimin, quhen të vdekur edhe po të jenë në jetë, sepse qëllimi më i rëndësishëm i krijimit të njeriut është vëzhgimi dhe mësimi, dhe më pas, mësimi të tjerëve i gjërave të mësuara vetë.

* * *

Masat dhe vendimet që merr një individ janë të goditura me aq sa ç’janë në marrëdhënie me mendjen dhe logjikën, kurse këto zhvillohen në përpjesëtim të drejtë me shkencën dhe intuitën. Prandaj ndodh që atje ku nuk ka shkencë dhe intuitë, mendja është e ngathët, logjika, mashtruese dhe vendimet, të pagoditura!

* * *

Vlera njerëzore e një njeriu shquhet dhe del në shesh pasi t’u ketë mësuar dhe ndriçuar të tjerët me atë që ka mësuar vetë. Ai që nuk rreket të mësojë megjithëse në dijeni të padijenisë së vet, që

nuk mundohet të bëhet shembull për të tjerët, pavarësisht shfaqjes së jashtëm njeri, të lë të mendosh në është me të vërtetë i tillë!..

* * *

Gjërat që do të mësohen për vete e që do t'u mësohen të tjerëve, pastaj, duhet të synojnë zbulimin e natyrës dhe cilësisë esenciale të njeriut, si dhe të fshehtat e gjithësisë. Shkenca që nuk u hedh dritë mbi të fshehtat e unit, që nuk i hap dhe ndriçon pikat e errëta e të zëna të ekzistencës, nuk është shkencë!

* * *

Posti dhe funksioni, të arritur me anë të diturisë dhe intuitës, janë më të lartë dhe jetëgjatë sesa postet e arritura me rrugë të tjera. Sepse dituria, në këtë jetë, duke e mbajtur njeriun larg të këqijave, e bën të virtytshëm e të vlefshëm, kurse, në jetën tjetër, projektet e ngritura në ndjesi me anë të besimit dhe diturisë, i lumturon nëpërmjet pozitash tejet të larta.

* * *

Çdo nënë e baba, duhet që, para se mendjet e fëmijëve t'u mbushen me gjëra të panevojshme, t'ua mbushin ato me dije e kulturë. Sepse ndjesitë e zbrazëta nga e vërteta dhe shpirtrat e privuar nga intuita, janë si parcela toke të përshtatshme për hedhjen dhe mbirjen e çdo lloj mendimi të keq. Tekembramja, ç'të mbillet, do të korret!..

* * *

Synimi i mësimi është që dija t'i bëhet njeriut prijës dhe udhërrëfyes, që të ndriçohen udhët që shkojnë në përsosjen njerëzore. Për rrjedhojë, dituritë dhe shkencat që ia kanë zënë vendin shpirtit, duke e shmangur krejtësisht atë, janë një barrë në shpinë të të zot, kurse intuita që nuk e orienton njeriun kah objektivat e larta, një hamallëk ndjesish dhe mendimi!..

Ja, se si shprehet për këtë gjë poeti turk, Junus Emré:

Dije do të thotë të dish,
Do të thotë veten të kuptosh;
E nëse ti veten s'e kupton,
Më kot që lexon.

* * *

Dituria apo shkenca me synimin dhe qëllimin të përcaktuara, janë, për të zotin, pretekst begatish dhe thesar i pasur. Ata që e zotërojnë këtë thesar, vizitohen si të ishin një burim uji të ëmbël, vazhdimisht, përse të jenë gjallë dhe bëhen pretekst për dobi. Kurse hipotezat boshe me synim të papërcaktuar, që u hedhin zemrave dyshim e lëkundje e që i nxijnë shpirtrat, janë një grumbull plehrash përreth të cilit sillen vërdallë shpirtrat, ose një kurth shpirttrash.

* * *

Edhe nëse dituritë dhe shkencat me degët e tyre të ndryshme dhe dobitë që përmban çdo degë janë dobishëse pothuajse për çdo njeri, meqë jetëgjatësia e njeriut është e paracaktuar dhe mundësitë, të kufizuara, është e pamundur që të mësohen që të gjitha, të nguliten në kujtesë e të përfitohet prej tyre. Nisur nga kjo, çdo individ duhet t'i mësojë dhe vërë në punë gjërat e domosdoshme për të dhe kombin e tij, pa qenë e nevojshme ta çojë kot jetëgjatësinë me gjëra që s'i hyjnë në punë!..

* * *

Dijetari apo shkencëtari i vërtetë do t'i ketë kurdoherë krahët të lehta dhe zemrën të qetë, nëse kërkimet dhe studimet do t'i organizojë dhe zhvillojë nën dritën e informacioneve më të drejta, e pohimeve më të sigurt që s'të gënjejnë, si dhe sipas përvojave shkencore. Kurse shpirtrat e mjerë, të privuar nga burimi i vërtetë i dijes, s'do të bëjnë dot gjë tjetër, veç të rrinë e të ndërrojnë rrugë e drejtim vazhdimisht, duke mos shpëtuar dot kurrë prej iluzioneve bruto, për çka edhe do të rrinë e rënkojnë vazhdimisht prej dhimbjeve të zhgënjimit!..

* * *

Fuqia dhe vlera e çdo personi është sipas përmbajtjes dhe pasurisë së diturisë që ka marrë: e atij që e përdor diturinë thjesht si një element thashethemesh, po aq; e atij që, duke e përdorur diturinë si një prizëm në njohjen e materies dhe dukurive, arrin gjer në skajet më të errëta të hapësirës, e që duke marrë krahë me kulturën e vet, takohet me të vërtetat përtej natyrës, gjithashtu po aq...

Dituria dhe injoranca

Edhe nëse libërzimi i diturive apo shkencave duke i thjeshtëzuar dhe sistematizuar në një farë mënyre ato është i dobishëm për faktin që krijohet edhe një herë tjetër mundësia për t'i parashtruar gjërat ekzistente, mund të thuhet se ka një mijë e një dëme ngaqë e paralizon shpirtin e frymëzimit dhe deduksionit...

* * *

Dituria është një udhëzues; nëse do të mbështetej në zbulesën hyjnore, e do të ushqejej prej saj, do të arrinte në përmasa që i kapërcejnë tokë e qiej, duke marrë saora një vlerë të veçantë...

* * *

Tani nuk përgatiten më shpikës apo zbulues, por imitues. Tani ndihet nevoja e shpirtit kundërshtues e kryengritës, që të ndryshojë çdo gjë, qoftë edhe pjesërisht. Çdo gjë duhet ndërruar: libri, shkolla, klasa, banka.. çdo gjë..Dhe është thelbësore të niset me kritikë...

* * *

Injoranca është shoku më i keq, dituria, shoku më besnik!..

* * *

Kur dituria bashkohet me karakterin e butë, arrin një thellësi marramendëse!..

* * *

Kur nxehet, injoranti bërtet e thërret, kurse i mençuri planifikon se ç' duhet bërë...

* * *

Idealja qëndron mbi perustinë dituri-butësi-adhurim...

* * *

Po qe se dituria nuk është bërë burim për praktikën, është e paracaktuar të thahet e të shuhet...

* * *

Nevoja është prijësi symprehtë i shpikësve...

* * *

Është tjetër të dish, tjetër të kuptosh; është më mirë ta kuptosh një gjë, sesa vetëm ta dish...

* * *

Mësoje veten të thuash “nuk di”, në mënyrë që kurrë të mos mbetesh i turpëruar duke thënë “nuk e di”...

* * *

Po të bëhej edhe konkursi i varfërisë, siç bëhen shumë lloje konkurses, injoranca do të bëhej padyshim mbretëresha e tij!..

Respekt për mendimin

Kritika e çdo gjëje, kundërshtimi për çdo gjë, s’janë veçse, për çdo herë, një akt shembjeje. Nëse dikujt s’i pëlqen diçka, le të përpiqet ta bëjë më të mirën e saj, sepse pas shembjes s’mbeten tjetër veçse gjëmadha, kurse pas bërjes, ngrehina dhe jetë...

* * *

Më tepër se nga furia dhe dhuna e hapur, duhet pasur frikë nga armiqësia e fshehtë dhe zemërimi dinak. Edhe nëse miqtë bëhen të ashpër sy ndër sy, në të vërtetë janë, për njëri-tjetrin, si engjëj mbrojtës. Ndërsa tregohen të butë, armiqtë, ngrenë kurthe, kurse ashpërsinë, ashtu si merimanga, e shfaqin duke i dhënë të drejtë vetes pasi ta kenë zënë tjetrin në kurth!..

* * *

Thonë, “filani laget në mot të thatë”! Iu bëfsha kurban atij! Ç’t’u bësh atyre që s’lagen as nën shi!..

* * *

Në një kuvend, çdo fjalë ka vlerë. Nuk duhet të kundërshtosh menjëherë as mendimet që nuk përputhen me idenë tënde. Mendo se ato mund të jenë shprehur lidhur me diçka tjetër, duro gjer në fund dhe dëgjo!

* * *

Përvoja është mësuesi i mendjes dhe prijësi i mendimit!

Feja

Që nga dita kur është krijuar e gjer më sot, njeriu, vetëm në atmosferën e ngrohtë të fesë e ka gjetur qetësinë e vërtetë, duke mundur të bëhet i lumtur vetëm në sajë të fesë. Ashtu siç është e pamundur të bëhet fjalë për moral dhe virtyt të lartë atje ku s’ka fe, është mjaft e vështirë, gjithashtu, të bësh fjalë për lumturi. Sepse burimi i moralit dhe virtytit është ndërgjegjja, kurse i vetmi element që e urdhëron ndërgjegjen, është feja, lidhja me Zotin!..

* * *

Feja është shkolla më rezultative, më e begatë, e hapur për shprehitë e bukura. Dhe nxënësit e kësaj shkolle të lartë janë të gjithë njerëzit, pa përjashtim. Kushdo që e frekuenton këtë shkollë, shpejt a vonë arrin sigurinë dhe kënaqësinë e kërkuar. Kurse të mbeturit jashtë, me kohë humbin çdo gjë, madje edhe identitetin e tyre!..

* * *

Feja është manual parimesh hyjnore që i çojnë njerëzit, me vullnetin e tyre të lirë, në gjëra të mira e të dobishme. Është gjithmonë e mundur të gjesësh mes parimeve të fesë, bazat që përgatisin përparimin materialo-shpirtëror të njeriut, për rrjedhojë, lumturinë e tij në këtë e në jetën tjetër!

* * *

Feja është njohja e ekzistencës dhe njësisë së Zotit, arritja e kthjelltësisë shpirtërore duke vepruar në rrugën e Tij, harmonizimi i marrëdhënieve me njerëzit në emër të Tij, dhe sipas urdhrave të Tij, madje ndierja, për llogari të Tij, e një interesimi dhe dashurie të thellë ndaj gjithë ekzistencës!

* * *

Ata që s'e pranojnë fenë, me kohë nisin të sillen pa respekt edhe ndaj koncepteve të larta si nderi, kombi dhe atdheu...

* * *

Imoraliteti pothuaj në tërësinë e tij është zift që shpërthen prej burimit të mosbesimit; po ashtu dhe çdo lloj grindjeje dhe anarkie janë oleandra helmuese të luginave të mosbesimit...

* * *

A nuk duhet që një pjesë mosbesuesish që ia kanë kushtuar jetën veprimtarisë kundër fesë, të tregojnë, me ca fryte konkrete, të paktën për ç'vlen mosbesimi?..

* * *

Feja dhe shkenca e vërtetë janë si dy fytyrat e një të vërtete të vetme. Feja e shëtiti njeriun nëpër rrugë të drejta dhe e çon në përfundime të lumtura. Ndërkaq, shkenca me synim dhe qëllim të përcaktuar qartë, i bën dritë para, si një pishtar, nëpër rrugët dhe në fushat e veta.

* * *

Të gjitha lulet e bukura janë rritur në kopshtet dhe lulishtet e fesë. Ja, pra, parimet e saj, dhe ja profetët, të urtët dhe shenjtoret, frytet e mrekullueshme të saj! Edhe nëse mosbesimtarët bëjnë sikur s'i shohin këto fryte, nuk do t'u mjaftojnë fuqitë për t'i fshirë ata as nga faqet e librave, as nga zemrat e njerëzve!..

* * *

Mes njerëzve, profetët janë si malet. Ashtu siç janë malet për tokën element i përfundimit të qëndrueshmërisë së saj dhe i pastrimit të ajrit, ashtu janë edhe profetët për njerëzit. Prandaj ka ndodhur që malet dhe profetët të përmenden së bashku, në një kauzë të vetme. Profeti Nuh dhe mali Xhud, Profeti Musa dhe mali Sina, Profeti Muhamed dhe mali Hira janë nga një shenjë që hapin perden e së fshehtës së kësaj enigme...

* * *

Feja i drejtohet mendimit të shëndoshë, mendjes së kthjelltë dhe shkencës dhe, nga ky këndvështrim, s'ekziston mundësia e kritikës për asnjë çështje të saj. Ata që s'duan ta pranojnë atë,

ose e kanë të prishur sistemin e të menduarit, ose të gabuar botëkuptimin shkencor, ose të pamjaftueshëm gjykimin...

* * *

Feja është një burim i begatë që përmban parimet e vërteta të qytetërimit. Në sajë të fesë, njeriu lartësohet në botën e tij ndjesore, kryet i arrin në botët tejfizike dhe arrin në horizontin ku mund të pijë sa të dojë nga burimi i vërtetë i të gjitha dobive, bukurive dhe virtyteve...

* * *

Nëse virtyti dhe vlera duhen kërkuar diku, duhen kërkuar në fe. Është tepër e rrallë që një i pafe të jetë i virtytshëm e që të gjendet një fetar i vërtetë i pavirtytshëm!

* * *

Në sajë të fesë, njeriu rrok kuptimin e njerëzores dhe veçohet prej kafshëve. Në vështirimin e njeriut të pafe, njeriu nuk ka ndryshim prej kafshëve...

* * *

Feja është rruga e Zotit, kurse mosbesimi, e djallit. Si rrjedhojë e kësaj, lufta mes besimit dhe mosbesimit ka ardhur që prej Ademit, e gjer në ditët tona, dhe do të vazhdojë më tej gjer në kiamet!..

Kurani

Kurani është manuali më i mrekullueshëm i mesazheve dhe ligjeve hyjnore i lindur në horizontin e njeriut duke zbritur nga lartësia e lartësive në masën e vlerës së njeriut dhe duke marrë parasysh unitetin trup-mendje-shpirt të tij!

* * *

Kurani, pas të cilit janë lidhur sot afërsisht një miliard njerëz, me parimet e tij hyjnore, përjetësisht të pandryshueshme, është teksti i vetëm dhe unikal si tregues i rrugës më të shkurtër e më të ndriçuar që çon kah lumturia e tërë njerëzimit!

* * *

Kurani është libri burim drite i bashkësive më të shkëlqyera e më dritëplote të historisë njerëzore, mes të cilave ndodhen edhe miliona dijetarë, mijëra filozofë dhe mendimtarë, i bashkësive të cilat kanë vendosur për fatin e planetit! Në këtë kuptim, Ai është i pashoq edhe në mbretërimin e tij!

* * *

Qysh nga dita e zbritjes e gjer më sot, Kurani as është kundërshtuar e as është kritikuar, megjithatë, kundër tij janë ngritur gjyqe që kanë përfunduar të gjitha me “pafajësinë” e tij dhe betejat janë vulosur që të gjitha me fitoren e tij!

* * *

Kurani është një dritë që kristalizohet në zemra, një burim ndriçimi që u bën dritë shpirttrave dhe fund e krye një ekspozitë të vërtetash. Me fytyrën e tij të vërtetë, Kuranin mund ta njohin e

kuptojnë vetëm shpirtrat që mund t'i dallojnë të gjitha bukuritë e gjithësisë në një lule, që mund ta vëzhgojnë furtunën në një pikë ujë!

* * *

Kurani ka një të atillë stil shprehjeje që oratorët arabë dhe persianë kanë vënë ballin në tokë kur kanë dëgjuar ajetet e tij, kurse letrarët njohës të së vërtetës, që kanë ndjerë dhe kuptuar bukuritë e përmbajtjes së tij, para Mbretit të Fjalës janë përkulur më dysh me nderim të thellë!..

* * *

Myslimanët kanë mundur të arrijnë unitetin mes tyre vetëm me anë të besimit dhe besnikërisë ndaj Kuranit, dhe kështu ka për të ndodhur edhe në të ardhmen. Ata që nuk i qëndrojnë besnikë Kuranit, jo vetëm që s'mund të jenë myslimanë, por as që mund të ngrenë një unitet të qëndrueshëm mes tyre!

* * *

Të thuash se “besimi është çështje ndërgjegjeje”, do të thotë të pohosh se i pranon dhe vërteton Allahun, Profetin dhe Kuranin, jo vetëm me gojë, por edhe me ndërgjegje. Kurse adhurimi, me të gjitha llojet e tij, i lidhur pas kësaj mendësie, është shfaqja e detyrueshme e këtij vërtetimi të shëndoshë!

* * *

Vetëm një herë ka ndodhur ai transformimi më i madh, shembullin e të cilit historia nuk ka mundur ta përsërisë edhe një herë tjetër: shpërthimi në formë tufani drite në një periudhë kur njerëzimi vërtitej mes vedi në vorbullën e egërsisë së injorancës dhe mohimit; dhe mbytja në dritë e botës në një hop, gjë që është realizuar me Kuranin! Historia është një dëshmitare e mjaftueshme e saj!..

* * *

Kurani është libri që i mëson njeriut, me ekuilibrat më të imta, kuptimin dhe esencën e njeriut, të vërtetën dhe urtësinë, individualitetin, atributet dhe emrat e Zotit, dhe në këtë fushë është e pamundur të tregosh një libër të dytë të njëvlershëm me të. Edhe ti vetë do ta kuptosh këtë gjë nëse u hedh një sy urtësisë së të urtëve dhe filozofisë së filozofëve vërtetëdashës!..

* * *

Kurani është i vetmi libër që urdhëron drejtësinë e vërtetë, lirinë e vërtetë, barazinë e drejtpeshuar, dobinë, nderin, virtytin, dhembshurinë ndaj të gjitha qenieve, gjer te kafshët; që ndalon hapur dhunën, politeizmin, padrejtësinë, injorancën, mitën, kamatën, gënjeshtren, dëshminë e rreme...

* * *

Përsëri është vetëm Kurani, libri që duke marrë nën mbrojtje bonjakun, të varfrin dhe viktimën, i ul në të njëjtën karrige mbretin me skllavin, komandantin me ushtarin, akuzuesin me të akuzuarin, dhe i gjykon...

* * *

Ta tregosh Kuranin si burim të miteve e besëtytnive, s'është gjë tjetër veç një përçartjee pathemeltë e të pafeve të sotëm, trashëguar prej arabëve injorantë të katërmbëdhjetë shekujve më parë. Me një mendësi të tillë vihen në tallje urtësia dhe filozofia e vërtetë!..

* * *

A nuk do të duhej që ata që bëjnë fjalë për Kuranin dhe kontributin e tij, të thoshin ca fjalë, qoftë edhe me vlerë të përkohshme, mbi rregullin, harmoninë, qetësinë dhe sigurinë e njeriut? Ç'është e drejta, kur e vë përballë Kuranin me hallakatjen, dhe shkatërrimin e qytetërimeve të tjera me rënkimin e pashpresë të zemrave të privuara nga drita e tij, është mjaft e vështirë ta kuptosh këtë keqdashje dhe inat kundër tij!..

* * *

Jeta më e rregullt për njeriun është jeta ku merr frymë Kurani, ashtu që mund të themi pa u druajtur se një sërë bukurish të qytetërimit, të cilat sot përmenden e duartrokiten në të katër anët e botës, janë po ato gjëra që Kurani i pati inkurajuar qindra vite më parë. E kush është gabim dhe kush ka faj në këtë mes?..

* * *

Tek ne, ata që qysh prej kohësh hedhin e presin në adresë të Kuranit, e që e kanë bërë si profesion të merren me të, përgjithësisht kanë qenë dhe janë injorantët që nuk e dinë se s' dinë. Sa e hidhur është që këta të mjerë, as kanë bërë ndonjë hulumtim mbi librin që i janë kundërvënë, as kanë lexuar ndonjë gjë mbi të. Në të vërtetë, nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes pretendimeve të këtyre dhe pretendimeve të injorantëve që tregojnë keqdashje ndaj shkencave eksperimentale, mirëpo duhet pritur edhe ca kohë që populli të zgjohet për t'i rrokur të vërtetat...

* * *

Kush e beson Kuranin, konsiderohet se e beson Profetin Muhamed, dhe kush e beson Profetin Muhamed, konsiderohet se e ka besuar edhe Allahun. Kush nuk e beson Kuranin, nuk konsiderohet se e beson Profetin Muhamed dhe kush nuk e beson Profetin Muhamed, nuk konsiderohet se e ka besuar Allahun. Ja, pra, këto janë përmasat e myslimanit të vërtetë!..

* * *

Në saje të Kuranit, njeriu është ngjitur në kulmin e pozitave siç është ajo e bashkëbiseduesit të Zotit. Njeriu i vetëdijshëm se ndodhet në një pozitë të tillë, e dëgjon Zotin në gjuhën e Vet të Kuranit, bisedon me Të, dhe nuk quhet gënjeshtar në betim, nëse betohet se ka folur me Të!

* * *

Në klimën e ndritshme të Kuranit, njeriut i bëhet sikur kalon nëpër varr ndërsa ndodhet ende gjallë në botë, sheh ringjalljen dhe Siratin, rrëqethet nën tmerrin e ferrit, dhe ndien se po shëtit në majat e hareshme të parajsës...

* * *

Ata që i pengojnë myslimanët për ta kuptuar Kuranin e për t'u thelluar në të, i largojnë ata, për rrjedhojë, nga fryma e fesë së tyre dhe thelbi i Islamit!

* * *

Pandeh se në një kohë shumë të afërt, kur, nën shikimet plot miratim dhe mahnitje të njerëzimit, ujëvarat e shkencave të ndryshme, e teknikës dhe artit, duke rrjedhur drejt oqeanit kuranor, të derdhen në burimin e tyre të origjinës e të bëhen një me të, dijetarët, hulumtuesit shkencorë dhe artistët do ta gjejnë edhe një herë veten brenda atij deti të paanë...

* * *

E ardhmja nuk duhet parë shumë si periudhë e Kuranit, sepse ai është fjala e Individualitetit që i sheh dhe i njeh të shkuarën me të sotmen dhe të sotmen me të ardhmen si një e tërë e pandarë...

Profeti Muhamed (pqmT)

Njeriu e njohu dhe e përvetësoi qytetërimin e vërtetë në saje të Profetit Muhamed (pqmT). Pastaj, çdo përpjekje e treguar në këtë drejtim nuk ka shkuar më tej se imitimi dhe revizionimi i parimeve të sjella prej tij. Nisur nga kjo, do të ishte më e përshtatshme që të quhej ai themeluesi i qytetërimit të vërtetë.

* * *

Është Profeti Muhamed (pqmT) ai që nuk u ka lëshuar kurrë rrugë dembelit dhe dembelizmit, që e ka quajtur punën adhurim dhe e ka duartrokatur njeriun punëtor, që u ka treguar ndjekësve të Vet kohën përtej epokës së jetuar dhe koordinatat si elementë drejtpeshimi për krejt njerëzimin!

* * *

Në daljen e tij si një shpatë e trimërisë dhe fjalës kundër mohimit dhe egërsisë, në shpalljen e së vërtetës pa pushim në të katër anët, dhe në tregimin njerëzimit të rrugëve të ekzistencës së vërtetë, Profeti Muhamed (pqmT) është individualiteti unikal e i papërsëritshëm!..

* * *

Nëse ka në botë njeri që nuk i do injorancën, mohimin dhe egërsinë, ai është Profeti Muhamed (pqmT)! Sidoqoftë, herët a vonë, zemrat që e kërkojnë të vërtetën, e të etura për diturinë shpirtërore, kanë për ta gjetur atë dhe kurrë më s'kanë për t'u ndarë prej gjurmëve të tij!..

* * *

Është Profeti Muhamed (pqmT) që i ka marrë nën mbrojtje fenë, nderin dhe atdheun, që i ka kumtuar njerëzimit në një formë përsosmërisht të ekuilibruar, se përpjekja për t'i mbrojtur ato është një luftë e vërtetë identiteti dhe ndërgjegjeje, dhe se kjo luftë është detyrë e lartë e sublime e rrjedhur nga besimi!

* * *

Ka qenë Profeti Muhamed (pqmT) i pari që i ka kumtuar njerëzimit lirinë e vërtetë, që u ka bërë të ditura ndërgjegjeve, se njerëzit janë të barabartë para të drejtës dhe ligjit, që e ka kërkuar epërsinë në moral, virtyt dhe devocion, si dhe që e ka quajtur adhurim thënien me zë të lartë të së vërtetës përballë dhunuesit dhe idesë së dhunës e padrejtësisë!

* * *

Është Profeti Muhamed (pqmT) që e ka grisur perden e hedhur në fytyrën e vdekjes dhe vdekësisë, që e ka treguar varrin si sallon pritjeje të botës së lumturisë së amshuar, që i ka çuar zemrat e çdo moshe që kërkojnë lumturi, të pinë në burimin e eliksirit të pavdekshmërisë!..

Tasavufi³

Tasavufi është metoda e ndjerjes dhe rrokjes së të vërtetës së islamit nga ndërgjegjja. Nisur nga kjo, ata që nuk janë të vetëdijshëm për jetën që jetojnë, nuk do të mundin ta arrijnë një përjetim të

³Rymë mistike islame ku njeriu thellohet në dashurinë për Allahun dhe botën shpirtërore, duke u distancuar nga gjërat kalimtare.

tillë, madje as ata që kënaqen vetëm duke dëgjuar legjendat për të tjerët, nuk do të mund të kuptojnë gjë nga kjo.

* * *

Nisur nga përfundimi, tasavufi është një emërtim tjetër i dukurisë sipas së cilës njeriu, i cili, pasi të ketë kuptuar thellë varfërinë, dobësinë dhe tërë mangësitë e veta, shkrihet, përhumbet dhe asgjësohet i tëri përballë rrezatimeve të ekzistencës së Zotit dhe pasqyrimeve tëatributevetë tij.

* * *

Tasavufi është situata cilësore sipas së cilës, shpirti i njeriut, pasi të jetë purifikuar, dhe pastaj, njësuar me origjinën e vet, të arrijë në një dimension të panjohur, duke kapërcyer të gjitha kohët dhe hapësirat... Ja, pra, kështu, në saje të këtij përjetimi, njeriu, duke kaluar nëpër portën e hapur nga miraxhi profetik, shkon e arrin tek Zoti i vet, pra, bëhet i merituari i një lloj miraxhi... Natyrisht, i një miraxhi sipas kapaciteteve të veta...

* * *

Urtësia dhe filozofia ia zgjerojnë njeriut horizontin e mendimit dhe e ndihmojnë t'i njohë më mirë materien dhe dukuritë. Kurse mistika mundëson kontaktin e njeriut, në një dimension pamundësisht të njohur, me Zotin e materies dhe të dukurive, duke e bërë atë mikun dhe të afërmin e Tij...

* * *

Tasavufi, ashtu siç mund të vërehet në personin e figurave përfaqësuese të tarikatisë, është identiteti i ndriçimit të shpirtit të njeriut duke marrë ushqim, me rrugën e dhikrit dhe meditimit, nga Fjala Hyjnore që është e pafundme. Nisma është shtruarja drejt pafundësisë e disa linjave hipotetike, duke marrë për etalon unin njerëzor, kurse fundi, duke hequr dorë prej të fshehtave të unit, është njohja se çdo gjë është prej Tij...

* * *

Tasavufi është rruga e hulumtimit me anë të dorës së zemrës, këmbës së zemrës dhe syrit të zemrës të të vërtetës hyjnore, tek e cila dora e filozofisë nuk mundet të arrijë! Në këtë rrugë, ku mendja këmbëzbathur e kryezbuluar bie përmbys e dërrmuar, zemra merr krahë si një pëllumb dhe përpiqet ta njohë, me kriteret e veta vlerësuese, Atë, Qenien e Panjohur. Dhe pastaj, diturinë shpirtërore të fituar, e shpall duke thënë: "S'të njohëm dot siç duhet...!"

* * *

Tasavufi është shpirti i Islamit. Islami nuk mund të mendohet pa të! Kurse tarikatet e kanë sistematizuar tasavufin.

Kultura

Kultura është një burim i rëndësishëm, të cilit i drejtohet rregullisht një komb gjatë procesit të zhvillimit dhe përparimit të vet, në vijën e posaçme për të. Mes harmonisë dhe orientimit të jetës së kombit dhe kthjelltësisë së burimeve të kulturës, ka ekzistuar gjithmonë një lidhje e ngushtë.

* * *

Kultura është tërësia e parimeve të lindura nga ndjenja të tilla si gjuha, edukata, zakonet dhe arti të një shoqërie, të shndërruara më pas, duke u përpunuar vazhdimisht, në mënyrën e jetesës të asaj shoqërie, tërësia e parimeve, çdo fragment i të cilave është, pothuaj, shumë i rëndësishëm. Të bësh sikur s'i sheh këto parime, është verbëri, kurse përpjekja për ta larguar shoqërinë prej tyre, do të thotë ta hutosh dhe trulllosësh atë, duke e lënë pa rrugë dhe pa drejtim.

* * *

Në përfundim të kontakteve të shumta a të pakta të kombeve me njëri-tjetrin, kultura, në një farë mase, ashtu si dhe qytetërimi, mund të kalojë nga një shoqëri në tjetrën. Ndërkaq, nëse në këtë kalim, distilatorët e shpirtit kombëtar nuk funksionojnë mirë dhe nuk kryhen mirë seleksionimet dhe kompensimet e duhura, si rezultat, amullia dhe depresioni kulturor-qytetërimor bëhet i pashmangshëm.

* * *

Kultura e vërtetë maturohet në potën ku shkrihen së bashku feja e vërtetë, morali i lartë, virtyti dhe dituritë e përvetësuara. Në atmosferën ku sundojnë mosbesimi, imoraliteti dhe injoranca, nuk mund të bëhet fjalë as për kulturë të vërtetë, as për përfitim prej këtij burimi nga ana e njeriut të rritur e formuar në atë atmosferë.

* * *

Shoqëritë që përpiqen për t'i siguruar vazhdimësi ekzistencës dhe përhershshmërisë së vet duke u ndërryer me kulturën dhe qytetërimin e kombeve të tjerë, u ngjajnë pemëve të zbukurimit me fruta artificiale të varura nëpër degë, gjë që është sa qesharake, aq edhe vetëmashtruese!

* * *

Kultura lind dhe zhvillohet nga natyra e kombit dhe shoqërisë. Ç'të jenë lulet dhe frutat për një pemë, ajo është edhe kultura për një komb e shoqëri. Kombet që nuk kanë mundur ta zhvillojnë dhe maturojnë ose që e kanë humbur kulturën e vet, u ngjajnë pemëve që s'japin fruta, ose që u janë derdhur. Ato janë të dënuara që, në mos sot, nesër, të priten për t'u përdorur për lëndë druri.

* * *

Kultura zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e çdo kombi. Kultura e lidhur ngushtë dhe e njësuar me të kaluarën e kombit dhe rrënjët e tij shpirtërore, hap dhe i ndriçon rrugët e gjallesës e të lartësimit për atë komb. Në të kundërt, zikzaket e vazhdueshme me nga një mendësi dhe ide të re për çdo ditë, e shpërbëjnë kombin, e kalbin duke e shtrirë përdhë.

Liria

Liri do të thotë që shpirti të mos pranojë asnjë kusht tjetër çfarëdo, veç ndjenjave të larta dhe mendimeve të larta, do të thotë të mos bëhet rob i asnjë parimi tjetër veç virtytit, vlerës dhe dobisë.

* * *

Sa e sa vetë ka, që megjithëse ndodhen nën pranga e zinxhirë, fluturojnë pa prà në qiejt e lirë të ndërgjegjeve të veta, pa ndjerë qoftë edhe për një çast burgosje e robëri. Dhe sa e sa vetë ka, që pavarësisht nga shkëlqimi dhe pompoziteti marramendës e syturbullues i pallateve ku jetojnë, assesi nuk munden ta ndiejnë e shijojnë lirinë në thellësitë e vetvetes së tyre!

* * *

Ata që e kuptojnë lirinë si mundësi absolute veprimi, ngatërrojnë lirinë njerëzore me lirinë shtazore. Diametralisht e kundërt me lirinë ku mbështeten zemrat e pafrë për të realizuar dëshirat e errëta të trupit, të të gjithë natyrës lëndore të njeriut, liri e cila është krejtësisht një simptomë shtazore, liria që, duke hequr pengesat para shpirtit, i hap udhë trokut të tij, është krejtësisht një simptomë njerëzore.

* * *

Lirinë mund ta interpretojmë, gjithashtu, edhe si shkëputje të trurit të njeriut prej litarëve që do ta pengonin nga përparimi materialo-shpirtëror, sigurisht, pa rënë në indiferentizëm dhe moskokëçarje.

* * *

Liri do të thotë t'i thuash njeriut, "pasi t'i rrish besnik idesë së të drejtës e të mos u sjellësh dëm të tjerëve, mund të bësh ç'të duash!"

* * *

Liria e pëlqyeshme dhe e pranueshme është liria qytetare. Edhe ajo, e lidhur me zinxhirët prej perlash të fesë dhe moralit, e shtrënguar me rrathët prej floriri të mendimit të shëndoshë.

* * *

Liria që nuk njeh ndjenjë fetare dhe mendim fetar, që nuk i jep vlerë moralit dhe që s'shërben si fidanishte virtytesh e vlerash, i ngjet zgjebes, nga e cila neveriten dhe ikin me vrap të gjithë popujt, ashtu që, popujt që u bie zgjebja, ashtu siç do të ndodhë që herët a vonë ta humbin qetësinë, do të ndodhë, pashmangësisht, t'i humbin edhe të njohurit, shokët e miqtë!..

Qytetërimi

Qytetërimi s'është pasuri materiale, dukje, shijim i kënaqësive trupore dhe notim i lëndores mes dëfrimesh. Qytetërimi është pasuri ndjesore, delikatesë shpirtërore, thellësi pikëpamjeje dhe pranim i të tjerëve duke u njohur edhe atyre të drejtën për të ekzistuar.

* * *

Qytetërimi i vërtetë është mundur të vërtetohet vetëm në kushtet kur kanë prirë vazhdimisht dituria dhe morali bashkë. Prandaj ka ndodhur që qytetërimi perëndimor, që e trajton çdo gjë lidhur me shkencat dhe teknologjinë, ka mbetur vazhdimisht paralitik, kurse qytetërimet lindore që përballë shkencës janë zhveshur e ia kanë këputur gjumit, ndodhen sot në një farë gjysmegërsie. Qytetërimi i së ardhmes do të hedhë shtat e zhvillohet në fidanishten ku kultivohen shkencat dhe teknologjia e Perëndimit bashkë me filozofinë e besimit dhe moralit të Lindjes.

* * *

Qytetërimi që nuk mbështetet në virtyt dhe moral, që nuk ushqehet nga hauzet e arsyes dhe ndërgjegjes, është një festë e përkohshme me flamurka e banderola, që nuk i shërben lumturisë së njerëzimit, por vetëm ca të pasurve si dhe dëshirave të ca qejflinjve. Mjerë për ata që gënjejnë pas parullave të tij me drita që ndizen e shuhen!

* * *

S' duhet pandehur se qytetërim do të thotë të kesh përparuar shumë në shkencat e natyrës e teknologji, të zotërosh mundësi moderne si anije, trena e avionë, të jetosh në qytete të mëdha, të ecësh në rrugë e bulevarde të gjera e të banosh në qiellgërvishtësa. Të pranosh se këto gjëra, çdonjëra prej të cilave konsiderohet, në duart besimtare e të orientuara, vetëm një pretekst i qytetërimit, janë vetë qytetërimi, s' është tjetër veçse një vetëmashtrim!

* * *

Qenia të qytetëruar e individëve duhet kërkuar në përpjekjet e tyre për të fituar një natyrë të dytë, duke zhvilluar e zhvilluar embrionet e gjërave të mira që ndodhen në esencën e njeriut. Ata që e quajnë të qenit të qytetëruar si identitet të veshjes dhe flokëve, si dhe të përfitimit prej çdo lloji të kënaqësive fizike, janë një sërë të patrush e një duzinë fatkeqësh të vënë poshtë nga jeta e përbërë prej kënaqësish fizike.

* * *

Nuk ka dyshim se popujt e egër dhe endacakë janë gjakderdhës, mizorë e piratë. Ndërkaq, është një e vërtetë se, meqë kjo gjendje e tyre dihet nga të gjithë, nuk është shumë e rrezikshme për të tjerët. Mirëpo ç't'u bësh endacakëve të qytetëruar të pajisur me armë moderne që ruajnë në çdo kohë rastin e volitshëm për të pirë gjak!

* * *

Nëse qytetërimi është tregimi nga një komb i qenies së vet, materiali i kësaj ligjërata të shkëlqyer duhet të jenë veprat shkencore, morale e teknologjike të atij kombi. Sepse edukata shoqërore dhe mjeshtëritë e artet e ndryshme i japin trajtë qytetërimit, kurse morali, si një gjuhë oratorike, e prezanton atë.

Përparimi

Zhvillimi dhe përparimi i një kombi varet nga edukimi ideor dhe ndjesor i individëve të tij. As nuk mund të pritet, që kombet me individë me arsye dhe ndriçim të brendshëm të pazhvilluar të përparojnë!

* * *

Kusht për lartësimin e kombeve është që individët të kenë arritur mes tyre unitetin e qëllimit. Në një shoqëri ku asaj që njëri i thotë e bardhë, tjetri i thotë e zezë, edhe nëse mund të vihen re përplasje sa majtas, djathtas, kurrresi nuk mund të vërehen zhvillim dhe lartësim.

* * *

Brezat që nuk kanë marrë një edukatë të përbashkët, gjithmonë janë ndarë në kampe të veçanta sipas kulturave të marra, duke e parë njëri-tjetrin si armiq. Të presësh përparim nga një shoqëri e tillë e përbërë prej gjelash që janë gati t'i hidhen sipër njëri-tjetrit, edhe në mos qoftë krejt e pamundur, është aq e vështirë sa mund të thuash e pamundur!

* * *

Çdo përparim shfaqet në fillim si një projekt dhe ide, pastaj u bëhet e pranueshme shtresave shoqërore dhe, më pas, realizohet me zellin dhe përpjekjet e individëve të lidhur dorë për dorë e zemër për zemër. Në të kundërt, çdo hap përparimi, që në planin ideor, nuk "ka marrë vizë" prej

shkencës ose ka pësuar fatkeqësinë të mos mundet ta shprehë veten, është e dënuar të mbetet pa rezultat.

* * *

Më e pastra, më e shkëlqyera, më e rregullta dhe më e mira e çdo gjëje është ajo që ka përparuar. Sipas kësaj, të kënaqurit me atë që ke është një numërim në vend, kurse nxjerrja në shesh e veprave më me nivel, më madhështore duke e kapërcyer dhe tejkaluar atë që ke, është përparim.

* * *

T'i kthesh në djerrë fusha e kodra, t'i katandisësh kopshtet e vreshtat në plehërishte, është rënie e regres; t'i bësh djerrinat pjellore dhe t'i kthesh plehërishtet në kopshte e vreshta, është përparim. Vendi i kombeve të përparuara është parajsë, malet, vreshta, kurse faltoret, pothuajse çdonjëra një pallat i shkëlqyer. Në kundërshtim me këtë, qytetet e vendeve të prapambetura, janë gërmadha, sokakët, plehërishte, kurse faltoret, nga një korridor i errët e i mykur.

* * *

Megjithëse ndikimi i shkrim-leximit mbi përparimin dhe lartësimin e kombeve dhe shoqërive është i madh sa nuk mund të mohohet, rezultati i kërkuar nuk ka qenë i mundur të arrihet kur brezat nuk janë edukuar me kulturën kombëtare në një drejtim të caktuar, dhe nuk do të arrihet...

* * *

Çdo hap dhe ndërmarrje përparimi bëhet rezultative në atë masë sa ç'i jepet rëndësi vlerësimit të mirë të gjendjes aktuale si dhe përfitimit nga përvojat e brezave të shkuar. Në të kundërt, nëse çdo brez i ri nuk mendon të përfitojë prej përvojës së brezit paraardhës dhe secili ze një udhë sipas mendjes së vet e shkon, atëherë, sado që të përpiqen brezat, me qëndrime dhe veprime të tilla foshnjara as edhe një pashë rrugë s'kanë për ta bërë dot!..

Arti

Arti është nga rrugët më të rëndësishme që bën të zhvillohen shpirti dhe ndjenjat e përparimit. Kapacitetet e pafata që e lënë t'u ikë nga dora rasti për ta përdorur këtë rrugë, njëra anë, ashtu si njëra anë e trupit të gjysmëparalitikët, u mbetet e vdekur gjatë gjithë jetës...

* * *

Arti është si një çelës magjik që i zbulon dhe hap thesaret e fshehta. Pas dyerve të hapura me të, idetë veshin rrobën e trajtës, kurse iluzionet pothuaj trupëzohen...

* * *

Nëse ka ndonjë pulëbardhë ideje që i shëtiti njerëzit në pafundësinë e deteve dhe lartësinë e kaltërsinë e qiejve, ajo është arti. Në saje të artit njeriu hap velat drejt gjerësive të pamata të tokës e qiejve, arrin perceptime dhe parandjenja tej kohës dhe hapësirës...

* * *

Arti vjen në krye të faktorëve që, me ruajtjen e botës ndjesore të njeriut, duke i treguar për çdo çast asaj bote ndjesore më të lartën e synimeve, i shtyn shpirtrat e ndjeshëm nga thellësia në thellësi. Po të mos ish arti, në botën e ndërhyrjes dhe zbulimit të njeriut nuk do të kishim mundur

të shihnim asnjërën prej bukurive që ekzistojnë aktualisht. Dhe ata shpirtrat artistë të zjarrit do të groposeshin në tokë për të humbur me gjithë projektet, planet dhe përfytyrimet e tyre...

* * *

Më e para tablo që i përshkruan thellësitë e botës së brendshme të njeriut, është arti. Është në sajë të artit, që ndjenjat dhe mendimet më të thella, konstatimet më të çuditshme, dëshirat më intime, janë regjistruar si të ishin regjistruar në një plan dhe pothuaj janë bërë të pavdekshme!

* * *

A nuk qe si rrjedhojë e shoqërimit të besimit prej artit, që kjo botë madhështore, me faltoret e ngritura kas, me minaret si gishta dëshmie që tregojnë botën përtej, me motivet dhe disenjot e bekuara në ballë të mermerëve, të cilat konsiderohen secila si një mesazh më vete, me artin e shumëllojshëm të shkrimit, me ornamentet përshndritëse prej varaku, me punimet e pazbehura dhe qëndisimat e bukura sa krahët e fluturave, kjo botë madhështore, pra, qe shndërruar në një galeri bukurish që s'ngopesh së pari?

* * *

Dituria e vërtetë e tregon veten me artin. Gjithashtu nuk mund të thuhet se dikush që nuk ka mundur të nxjerrë në shesh ndonjë vepër artiçfarëdo, di diçka si shumë...

* * *

Gjallëria e dhuntive njerëzore ka lidhje shumë me shpirtin e artit. Një njeri pa art, edhe në mos qoftë i vdekur, i gjallë s'mund të quhet...

* * *

Të gjitha përpjekjet artistike të pavlefshme sipas shpirtave artistike e që nuk gjejnë interesim dhe konsideratë, burojnë prej pamundësisë për ta dalluar nga njëra-tjetra formën me shpirtin.

* * *

Nuk ka dyshim se interesimi dhe konsiderata për një vepër arti i përkasin, më tepër se vetë veprës, mjeshtërisë dhe artit në shpirtin e saj.

* * *

Është arti që e bën hekurin më të çmuar se arin, bakrin se bronzin. Sigurisht, në sajë të artit, mineralet më të pavlefshme shndërrohen në gjëra më të çmuara se ari, argjendi dhe diamanti...

* * *

Ashtu siç të gjitha artet e bukura, të cilat, në vijën tonë të të menduarit, janë dhurata të pavdekshme të shpirtave të bekuar artistikë për njerëzimin, edhe të gjitha mjetet që konsiderohen pretekst kënaqësie e mirëqenieje për njerëzimin, nga ora që na tregon kohën te syzet që u japin fuqi syve të dobësuar, nga telefonat dhe radiomarrësit që i afrojnë largësitë, te televizorët që i reflektojnë në dhomat tona fytyrat dhe zërat e kapura nga të katër anët e botës, nga trenat, autobusët dhe avionët që na bartin dhe çojnë nga një vend në tjetrin, te anijet kozmike, të gjitha këto mjete, pra, janë vepra të këtyre shpirtave të ndjeshme të hapur ndaj artit.

* * *

Të gjithë shpirtrat e mbyllura ndaj artit janë si ca turma amorfe, me qenien e mosqenien të njëvlershme, të cilat nuk i sjellin ndonjë dobi vetes, familjeve, kombit, madje mund të jenë të dëmshme...

Letërsia

Letërsia është konstrukti shpirtëror, bota ideore dhe gjuha e maturuar e jetës kulturore të një kombi. Individët që nuk ndajnë mes tyre të njëjtin konstruksion shpirtëror, të njëjtin sistem të menduari, dhe të njëjtën jetë kulturore, edhe pse mund të jenë pjesëtarë të një kombi, e kanë të pamundur ta kuptojnë njëri-tjetrin.

* * *

Fjala është nga mjetet më të rëndësishme në bartjen e ideve nga një tru në një tjetër, nga një mendje në një shpirt tjetër. I zoti i fjalës, i cili mundet ta përdorë me sukses këtë mjet, gjen shumë shpejt përfaqësues turma-turma për idetë që tharmoi nëpër shpirtra, duke arritur pavdekësinë me idetë e tij. Kurse ata që s'e zotërojnë një mundësi të tillë, fshihen, ikin e mbarojnë së bashku me dhimbjet ideore që hoqën një jetë të tërë...

* * *

Çdo lloj letërsie është, me të veçantën e materialit që përdor dhe me të veçantat e formësimit të qëllimit, një rrugë tregimi më vete dhe një gjuhë e posaçme për atë lloj. Edhe nëse nga ajo gjuhë çdokush mundet të kuptojë ca gjëra, janë vetëm poetët dhe prozatorët ata që e përdorin atë gjuhë me kuptimin e saj të vërtetë, e që flasin me të.

* * *

Ashtu siç arin dhe argjendin e kuptojnë sarafët e argjendarisë, ashtu edhe perlën e gjuhës, e kuptojnë sarafët e fjalës. Kafshët e fusin në gojë dhe e përtypin lulen e rënë përtokë, ose meqë nuk e njohin vlerën, e shkelin dhe kalojnë, kurse njerëzit i marrin erë dhe e venë në gjoks.

* * *

Idetë e larta dhe konceptet e larta duhet që patjetër të tregohen me një stil të lartë që do të zërë vend në mendjet, do të zgjojë emocion në zemrat dhe do të gjejë pranim në shpirtrat, ndryshe, ca llafollogë, duke parë kah rroba e grisur dhe e shqyer në shpinë të kuptimit, mund t'i shohin si të pavlera perlat brenda tij.

* * *

Po të mos ish letërsia, as urtësia do të mund ta merrte atë vendin e saj të bujshëm, as filozofia do të mund t'i arrinte këto ditë, as ligjërata nuk do të mund ta jepte atë që pritej prej saj. Ndërkaq, nuk duhet harruar se si urtësia, si filozofia, ashtu edhe ligjërata kanë shtruar para letërsisë si një kapital të pasosur pasurinë e tyre të fushave të veta, duke i përftuar asaj pavdekësinë.

* * *

Poetët dhe prozatorët i përngjajnë një fyelltari që u jep tingëllim bukurive që sheh dhe ndjen në botët e jashtme e të brendshme. Nëpërmjet tyre njerëzit rrokin kuptimin dhe natyrën e tingujve që lartësohen nga ky kor polifonik, ndryshe, personat që s'dinë gjë për flakët, që të ardhura me rrugën e ndjenjave, ua kanë përfshirë shpirtrat, e kanë të pamundur t'i kuptojnë si fyellin, ashtu dhe klithmën e lartësuar prej tij...

* * *

Krejt ashtu si të gjitha llojet e tjera të artit, edhe fenomeni "letërsi" arrin pavdekësinë me anë të parandjenjës, njësimi me materien, qenies në një gjendje tejqëllimi e kohe, me anë të cilësisë ose

përmasave të tij. Prandaj është shumë e rëndësishme që artisti, duke i kapërcyer të gjitha ç'sheh dhe ndjen, t'i përgatisë ndjesitë për t'u hapur ndaj frymërave që vijnë prej botëve përtej...

* * *

Çdo fjalë poetike dhe prozaike me qëllim shprehjeje, që do të përdoret, duhet t'i bëhet enë margaritarit të mendimit, nuk duhet të zërë vendin e tij dhe nuk duhet t'i bëjë hije atij. Edhe sikur të jetë prej krizoliti kjo enë, fjala e humb ndikimin dhe fuqinë e ndjeshmërisë në atë masë, që t'u bëjë hije përmbajtjes dhe qëllimit. Për rrjedhojë, një fjalë e tillë nuk ka mundësi për të qenë jetëgjatë...

* * *

Krahas të qenit mjet shprehjeje e një mendimi dhe e një kuptimi, gjuha ka lidhje të ngushta edhe me artin, bukurinë dhe çështjet e edukatës dhe ndoshta fjala "letërsi", shprehja e këtij aspekti të saj është.

* * *

Elementi bazë në letërsi është kuptimi. Nisur nga kjo, është e rëndësishme që shprehja të jetë e shkurtër, por e pasur dhe e dendur. Edhe nëse disa njerëz kanë dashur ta parashtrojnë këtë veçanti me figura letrare të përdorura nga të vjetrit në shprehje, si krahasim dhe similitudë, metaforë, metonimi, aluzion, kalambur, anaforë, për mua, fjala më e thellë duhet kërkuar në shpirtrat e ndjeshëm që entuziazmohen me anë të frymëzimit, në imagjinatat e gjera që dinë ta përfshijnë qenien e ta shtesojnë në ndjesi, në mendjet besimtare dhe konstruktive që kanë arritur t'i lexojnë këtë botë dhe amshimin së bashku, si një të tërë, si dy fytyrat e një të vërtete të vetme.

* * *

Ashtu siç ndodhen mbi tokë qytetërime dhe kultura të ndryshme, është e natyrshme të ndodhen edhe lloje të ndryshme letërsie. Ndërkaq, letërsia, me ndjenjën e së bukurës në shpirt, me dashurinë për të bukurën dhe me vijat dhe tingujt përkatës të librit të natyrës, është, brenda shumëfytyrësisë, një e tërë e vetme dhe natyrisht e gjithëbotshme.

* * *

Nëse letërsia e Divanit, e zhvilluar dhe e përsosur në fidanishten e një kulture dhe qytetërimi të veçantë, shihet nga një pjesë njerëzish e rëndë, e stërholluar dhe e pakuptimtë, shkaqet e një opinionit të tillë duhet t'i kërkojmë në ngushticën e horizontit tonë. Ju lutem, letërsinë e tharmuar nën rrezet qiellore të Librit dhe Sunetit, në ndjesitë emocionuese të heronjve që kanë treguar vendosmërinë për ta bartur gjer në pafundësi dritën e ardhur prej botëve përtej, si dhe në shpirtrat e lartë të ngritur kas me mendimin për ta trajtësuar botën përsëpari, a është e mundur ta kuptojnë kufomat e pajeta të një periudhe të vdekur?

* * *

Çdo e vërtetë shfaqet në fillim si një embrion në shpirtin e njeriut, ndihet, pastaj, me fjalë, me kalem, me çekiç, gjallërohet dhe kristalizohet, duke u bërë përpjekje për ta shprehur atë me pika dhe vija në çehren e një vepre arti ose si një vepër arti më vete. Kurse marrja nga një vepër e tillë e dimensioneve mbikohore e mbihapësinore, ka të bëjë krejtësisht me besimin dhe nivelet e pasionit në atë besim.

* * *

Disa herë, edhe mes njerëzve të një krahine e të një vendi, tensionimi letrar dhe shpërthimi letrar mund të jenë krejt të ndryshëm. Ky ndryshim i lidhur me fytyrën e jashtme të gjërave, buron prej ndryshimit në këndvështrimin e materies dhe dukurive si dhe prej pranimi ose mospranimi

të besimit dhe shumë vlerave të tjera. Ashtu siç janë për atë që ndodhet në majë të malit, mërmërima të pakuptimta thirrjet e atij që ndodhet në fund të lumit, ashtu edhe për atë që ndodhet në fund të lumit, thirrjet e atij në majë të malit mund të merren si mërmërima që s'kanë kuptim.

* * *

Një vepër letrare e mirë ka lidhje të afërt me përsosmërinë e elementëve që e kanë formuar atë; edhe përsosmëria e elementëve ka lidhje të afërt me përsosmërinë e nënelementëve që i përbëjnë ata. Atje ku embrioni (i një ndjenje) nuk është i shëndoshë, është e pamundur të formësohet një ndjenje e pastër si dhe atje ku nuk gjendet një ndjenje e pastër, është e pamundur të formësohen shprehje prej flake dhe vepra të gjalla si flaka, që do të mbeteshin po ashtu të gjalla gjithmonë.

* * *

Ashtu si çdo artist, edhe shkrimtari, gjithmonë e kërkon veten në vijat, format dhe ngjyrat e të vërtetës së gjithësisë. Atë ditë që artisti e gjen atë që ka kërkuar, dhe arrin ta shprehë me artin e vet, e thyen lapsin, e hedh furçën, e fluturon tutje çekiçin dhe, i shtangur nga habia dhe mahnitja, kapërcen vetveten. Prandaj edhe artistët më të mëdhenj duhen kërkuar mes robërve të Zotit që s'pranojnë lirim, që jetojnë duke medituar dhe ndjerë.

Poezia

Poezia s'është gjë tjetër pos shprehjes në shpirtrat poetikë të bukurisë dhe simetrisë të ndodhura fshehur në shpirtin e gjithësisë, të buzëqeshjes dhe vetisë zemërgazmuese në çehren e qenies. Mes këtyre shpirtrave të larta ka të tillë që zemra iu është bërë shishe, kurse frymëmarrja e Shpirtit të Shenjtë, boja e tyre.

* * *

Poezia është zhurma që dëgjohet në rrugën e ngacmimit të botëve përtej ose rënkimet e përpjekjes për këtë qëllim. Zërat dhe tingujt në poezi, sipas situatës shpirtërore dhe thellësisë së brendshme, disa herë dalin të kthjelltë e gurgullues, disa herë, të hollë, tepër të hollë. Nisur nga kjo, çdo zë dhe fjalë që i përket poezisë, mund të rrokët e plotë vetëm me anë të situatës shpirtërore të çastit kur u shqiptua.

* * *

Poezia lind dhe formësohet sipas mënyrave të besimit, kulturës dhe mendimit që ndikojnë mbi vështrimin dhe ndijimin e poetit. Ndërkaq, burimi i vetëm që, duke i dhënë thellësi poezisë, e ngre atë në nivel përtej njohjes, është frymëzimi. Në zemrën që merr flatra me anë të frymëzimit, molekula bëhet diell, kurse pika e ujit, det!

* * *

Sado i madh të jetë në poezi roli i mendjes dhe mendimit, zemra njerëzore ka një aspekt të thellë të posaçëm në vetvete. Siç thotë edhe Fuzuliu, "Fjala ime është, për armatën e poetëve, flamur që prin!" Idetë e bleruara në zemër, të bërë me krahë nga imagjinata, shkojnë e nisin të shtyjnë dyert e pafundësisë...

* * *

Poezia është një rreze që ndriçon të tashmen, një projektor që hedh dritë drejt së ardhmes dhe një melodi pasioni dhe emocionesh me burim nga përtej... Në klimën e poezisë së vërtetë, sytë fitojnë ndriçim, largësitë afrohen dhe shpirtrat arrijnë një ngazëllim dhe dëshirë që s'ka të shuar...

* * *

Ashtu si përgjërimet, edhe poezitë bëjnë fjalë për ulje-ngritjet në botën e brendshme të njeriut, për gëzimet dhe hidhërimet e tij, si dhe shndërrohen në frymëmarrje qiellore me aq sa individ i të përqendrohet në të vërtetën e lartë. Ç'është e drejta, çdo lutje është një poezi, çdo poezi, një lutje, mjafton që poezia të dijë të hapë flatrat drejt pafundësisë...

* * *

Poezia që, e bleruar në mendimin mbi të pafundmen, zë vend, me anë të flatrave të zemrës dhe fuqinë e shpirtit, në qiejt e mendimit të kulluar, nuk i jep fort konsideratë mendimit pozitiv siç ndodh me shkencat. Ajo merret me konkretën vetëm si një mjet. I gjithë synimi i poezisë është ta gjejë abstrakten e të rendë nga pas për ta zënë...

* * *

Nëse çdo gjë e ndjerë dhe e menduar në poezi, mund të përfytyrohet, nëse përfytyrimet mund të kalojnë nëpër gjykim pa firo, dhe pastaj, nëse këto elemente të fshehta të shfaqura si nga një frymë në botën e brendshme të poetit, munden ta ruajnë praninë dhe gjallërinë e vet gjer në çastin kur të kthehen në fjalë dhe fjali, ajo poezi është kandidate për të mbetur gjithnjë e gjallë dhe e freskët. Në të kundërt, gjërat që i nxjerrim në shesh duke u thënë "poezi", s'kanë ndryshim prej një unaze bakri me gur krizoliti, ose një gjerdani margaritarësh imitues.

* * *

Poezia, për shkak se zgjodhi për synim të kërkojë atë "Qenien e Panjohur", është lëmsh enigme në mendim, gjysmerrësirë e rrugëve nga kalohet dhe një zë shumëpërmasor e vështirësisht i kuptueshëm i një atmosfere të mbyllur në shumë aspekte të saj. Është për këto arsye që në çdo fjalë e fjali të poezisë së vërtetë ndihen soditjet dhe ndijimet e një udhëtari jashtëzakonisht të ndjeshëm i cili, në një shatëz enigmatike, habitet e tërhiqet prej çdo zëri dhe pamjeje.

* * *

Poezia është një rrahje zemre, një emocion shpirti dhe një lot syri; në të vërtetë, edhe lotët e syve do të thonë poezi e kulluar që ka ngritur krye kundër fjalëve.

* * *

Poezi do të thotë ca lule poetësh të pavyskshme dhe aroma që u shpërndajnë ato mjedisit. Kur ta kenë dheun të pastër, ujin të kulluar dhe rrënjën të zhvilluar, njeriu s'di të ngopur atëherë me ngjyrën dhe aromën e këtyre luleve...

* * *

Nuk është i paktë numri i poetëve që flasin shumë pa e ditur ç'thonë, por edhe i atyre që e dinë mirë se ç'thonë, por flasin pak. Në ndryshim prej lumit të fjalëve të të parëve, vështrimi dhe mendimi poetik i të dytëve mund t'u thonë shumë gjëra njerëzve, pa pasur nevojë për shumë fjalë.

* * *

Është gabim ta kuptosh poezinë vetëm në formën e fjalës metrike. Ka sa e sa fjalë prozaike, kuptimi figurativ dhe mënyra e të shprehurit e të cilave zgjon mahnitje dhe habi ndër zemra, të cilat janë, secila, nga një monument poetik më vete!

* * *

Edhe poezia, ashtu si çdo degë e artit, nisur nga përfundimi, është e zbehtë dhe shterpë, nëse nuk merr e jep me të pafundmen. Shpirti njerëzor i shtënë pas bukurive të pafundme, zemra njerëzore e pasionuar pas pafundësisë, ndërgjegjja njerëzore që s'ngopet me tjetër gjë veçse me të përjetshmen dhe përjetësinë, i pëshpërisin pa prapë artistit të merret me botët përtej. Artisti që nuk i ndien këto rënkime e dëshira që ngrihen lart prej shpirtit, zemrës dhe ndërgjegjes, merret një jetë të tërë vetëm me imitimin e fytyrës së jashtme të gjërave dhe qoftë edhe një herë të vetmenuk arrin dot të shohë se ç'ka përtej kësaj perdeje prej dantelle...

* * *

Kur, në poezi, forma të mos flijohej për përmbajtjen dhe përmbajtja për formën, në të kundërt, kur të dyja anët të trajtohen në marrëdhënie të tilla si ato mes trupit e shpirtit, ajo poezi arrin një akord dhe harmoni që çdo ndërgjegje, duke e parë si krejt të natyrshme, e do. Dhe nuk mund të mendohet që, për këtë lloj poezie, imagjinata të propozojë ndonjë çfarëdo motiv tjetër, të ri.

* * *

Poezia ka një fytyrë të jashtme ku sundojnë më shumë fjalët, fjalitë dhe veçori të tilla si metrika, forma e vargëzimit, etj. Sa për fytyrën e brendshme, atje, shpirti, për pohimin e ideve që tharroi në botën e tij të brendshme, kërkon, atje ku duhet, fjalitë më të zbukuruara e më të hijshme si çehra e luleve dhe krahët e fluturave, atje ku duhet, fjalët që, si shpuza, ndezin zjarr atje ku bien dhe, atje ku duhet, fjalët që do të shkaktojnë rënkime si të fyellit; i kërkon, i gjen dhe i vë nëpër vende ashtu që kësaj mund t'i themi muzikalizim i poezisë.

* * *

Nisur nga fakti që simbolet dhe figurat janë një prej burimeve kryesore të poezisë, në të ndihet një gjerësi dhe konceptualitet tej asaj ç'ka është në të vërtetë. Megjithatë, ky konceptualitet, në të gjitha përmasat e tij, ndodhet brenda intimitetit të shenjtë të poezisë dhe i rrethuar prej mureve të tij. Edhe kur poezia, duke përfutur dimensione në krahët e asociacioneve, përhapet e zgjerohet drejt klimave kuptimore shumëngjyrëshe, prapë është po vetë ajo!

* * *

Esencialisht, është një ton urdhër që i vjen poezisë nga bashkimi dhe njësimi i idesë me ndjenjën. Ndërkaq, janë edhe dy elemente të rëndësishëm si qëllimi dhe vështirimi, të cilët ashtu si hipofiza, i urdhërojnë idenë dhe ndjenjën duke u qëndruar në praparojë si dhe të cilët e bëjnë të ndihet praninë e vet në çdo moment; këto dy elemente u reflektohen si nga një ngjyrë të gjitha vargjeve e strofave, e kapin për dore mendimin atje ku i rrëshqet këmba, dhe si një llambë magjike para ndjenjës, përhapin nëpër rrugë dritë pa prapë.

* * *

Me urrejtjet dhe armiqësitë, me emocionet dhe dhimbjet, me shpresat dhe zhgënjimet, poezia është frymëmarrja e shoqërisë ku hedh filiz e rritet. Edhe poeti është, atje ku duhet, trakea dhe mushkëria e kësaj shoqërie, atje ku duhet, gjuha, buza e saj. Prandaj, ndërsa çdo poezi pohon ca gjëra kur trajtohet në kuadrin e veçorive të shoqërisë ku bletori dhe u rrit, të shoqërisë që përbën material për të, është mjaft e vështirë të kuptosh diçka prej saj pa mbajtur parasysht shoqërinë që i shërben asaj si dado.

Jeta dhe shpirti

Jeta është një e fshehtë hyjnore; natyrën e saj e njohin vetëm ata që janë bërë njësh me të fshehtat hyjnore.

* * *

Jeta, në kuptimin e saj absolut, është një gjëllim fizik, trupor. Temperatura dhe gjëllimi në trup janë krejtësisht natyrore dhe prodhohen brenda procesit të shndërrimit të lëndëve ushqimore në gjak dhe energji.

* * *

Qëllimi i jetës fizike (trupore, fiziologjike) është gjëllimi dhe kryerja e një sërë detyrash fizike (trupore); nisur nga një gjë e tillë, nga një lloj jete e tillë, mes njeriut dhe kafshës nuk ka asnjë ndryshim. Kurse jeta njerëzore është jeta e përbërë prej vetëdijes, njohjes dhe mundësisë për të komunikuar me botët përtej dhe ja, kjo është jeta e vërtetë!

* * *

Jetë s'do të thotë shpirt. Jeta është një gjëllim trupor, material. Kurse shpirti është një qenie e brishtë, e pazbërthyeshme, e papjesëtueshme, e ndryshme prej elementeve lëndore si dhe një "ligj i urdhëruar" i vetëdijshëm.

* * *

Shpirti hyn në raport me trupin së bashku me jetën dhe ndahet prej tij me ndarjen e jetës. Jeta shuhet e shkatërrohet, kurse shpirti jeton, në saje të urdhrit të Allahut, gjer në pafundësi.

* * *

Jeta është me burim krijimi dhe me dimensione natyrore. Kurse shpirti, një frymë hyjnore, zotëron një cilësi mbikrijimore e mbinatyrore. Jeta është e vdekshme dhe e fundme, kurse shpirti, me pamje përjetshmërie dhe i pavdekshëm.

* * *

Shpirti është një qenie që, mbi mekanizmin e trurit, njeh, ndjen, kërkon dhe dëshiron vetë. Kurse marrëdhënia e tij me trupin është një fqinjësi e përkohshme dhe fat i përbashkët.

* * *

Shpirti është një qenie e pavdekshme që, ashtu siç e kapërcen lehtësisht gropën e varrit dhe ikën, ashtu dhe, pa u penguar në pritën e jetës së varrit dhe grumbullimit pas ringjalljes, shkon dhe arrin pafundësinë e Ferrit dhe të Parajsës!

* * *

Shpirti reflektohet në pasqyra ose në ëndrra apo iluzione disa herë i shëmbëllyer si njeri, disa herë në formë avulli të lehtë e, disa herë, në formën e një elementi tjetër, dhe si engjëjt, merret me gjëra të dobishme ose, si djajtë, me gjëra të dëmshme e të këqija.

* * *

Jeta e vërtetë është ajo në të cilën jeta shpirtërore me jetën trupore shkojnë sup më sup. Një jetë e tillë është, në të njëjtën kohë, këtu një farë nga e cila del dhe çel lule jeta e njeriut të vërtetë, kurse përtej, jeta e të merituarve të Xhenetit që do të hedhë shtat e blerojë në të gjitha përmasat e saj.

* * *

Vetëdija dhe thjeshtësia janë rezultat i jetës ndjesore.

* * *

Nuk mund të ketë jetë shpirtërore tek ata që e jetojnë jetën pa përgjegjësi. Edhe përlotimi i tyre është një gënjeshtër më vete!

* * *

Qysh nga çasti kur erdhëm në këtë botë, jeta e vërtetë na është dhënë amanet e lidhur ngushtë me jetën shtazore dhe me qëllim për ta zhvilluar atë. Dhe kjo përgjegjësi mbetet mbi ne gjersa të vijë çasti që marrëdhënia shpirt-trup të prishet.

* * *

Përsa i përket jetës shtazore, njeriu është në koherencë me kafshët, kurse, përsa i përket jetës shpirtërore, në koherencë me engjëjt. Ashtu siç është i paracaktuar engjëllizimi me kohë i atyre që munden t'i vlerësojnë dhe përdorin mundësitë dhe dinamikat në esencën e krijimit të vet, ashtu edhe është e pamënjanueshme rënia herët a vonë nën nivelin e kafshëve, madje e djallëzimit të atyre që i lenë të verbra mundësitë dhe dinamikat në fjalë, madje, duke i shndërruar në elementë destruktivë, i përdorin për të keq ato!

Mrekullia dhe thagma

Ai që s'beson në mrekullinë, do të thotë se nuk e vërteton Allahun dhe fuqinë e Tij. Ai që thotë se "Hëna nuk ndahet me mrekulli", kërkon të thotë se "Allahu nuk mund ta ndajë Hënën në pjesë". Ai që thotë se "të vdekurit nuk ngjallen", pretendon se Allahu nuk mund t'i ngjallë të vdekurit.

* * *

Thagma është një eveniment i jashtëzakonshëm që shfaqet te prijësi shpirtëror, për rrjedhojë, që mbështet mrekullitë e profetit dhe profetësinë e tij.

* * *

Thagma është një dhuratë hyjnore e shfaqur me dorën e miqve të së vërtetës të cilët nuk pretendojnë për profetësi, dhe këtë munden ta kuptojnë vetëm ata që e kuptojnë njeriun.

* * *

Prijësia shpirtërore është pozita e personit që e do Allahun dhe duhet prej Tij. Ashtu siç ndodh që Allahu t'i lartësojë këta robër besnikë të portës së Tij me dhunti e favore që s'të shkojnë ndërmend e t'i bëjë të njohur mes njerëzve, ashtu ndodh edhe që t'i fshehë, si margaritari i fshehur brenda midhjes, gjer në stacionin e fundit edhe nga vetja e tyre, edhe nga të tjerët...

* * *

Këto pozita të larta të ekspozuara ndaj dhuratave shumë mbi nivelin e ndjenjave, njohjes dhe botëkuptimit njerëzor të zakonshëm, përfaqësojnë, në një pamje, hijen e së vërtetës profetike. Distanca në mes përcaktohet nga vlera e lartësimit si më sipër.

* * *

Prijës shpirtëror do të thotë i zoti i urtësisë. Sa më lart të jetë urtësia prej filozofisë, edhe prijësi shpirtëror po aq më lart qëndron në krahasim me filozofin, madje aq lart sa të mos mund të bëhet krahasim...

Ëndrra

Ëndrra është dritare e hapur për të parë në botën e së vërtetës; është vëzhgim i ngjarjeve që kanë për të ndodhur, drejtpërsëdrejti ose me anë të një sërë simbolesh. Në atë masë që mendja e njeriut të mbetet larg prej presioneve të ndryshme si dhe kufizimeve të kushtëzuara, në atë masë çdo ëndërr është një dritë që i vjen prej përtej, një dritë që, si një shenjë orientuese, mund t'i tregojë udhë njeriut duke ia ndriçuar errësirat që ka përpara.

* * *

Është për shkak se në ëndrra nuk ndihet nevoja për sy, lëndë dhe dritë, se gjërat e para kuptohen me anë të parandjenjës dhe njohjes shpirtërore, që ëndrrat shpesh mund t'i tregojnë njeriut edhe gjëra shumëpërmasore dhe papërfytyrimisht të bukura. Dhe nuk ka ndodhur rrallë që me një ëndërr të vetme të jepet dje për të sotmen dhe për të ardhmen informacion aq i gjerë sa të mos e nxënë as librat!

* * *

Mund të thuhet se s'ka njeri që të mos shohë ëndërr. Nisur nga kjo, ëndrrës mund t'i themi edhe vëzhgimi i natyrshëm i shpirtit. Me anë të këtij vëzhgimi njeriu pothuajse jeton jashtë mureve rrethues të lëndores dhe plotësisht në një dimension tjetër dhe kush e di se sa shumë të fshehta të fatit të të njëjtit brez arrin t'i parashikojë...

* * *

Aq të shumta janë ëndrrat që vërtetohen një për një, saqë, sikur çdo person të mund të përcaktonte nga ëndrrat që shihte, vetëm ato që u dilte kuptimi, me to do të formoheshin vëllime të tëra!

* * *

Sa e sa ëndrra të ekspozuara nga bota e përtejme ndaj horizontit të vëzhgimit të njeriut sipas kapacitetit të çdo zemre të pastër ka që zemra hyn në ato ëndrra e shëtiti, arrin në çizmat e ujit parajsor të atyre bahçeve që konsiderohen secila nga një trëndafilishte më vete dhe pi gjersa të ngopet si dhe, me anë të vëzhgimit të ç'pejzazheve të padukshme që sytë s'i kanë parë, veshët për to s'kanë dëgjuar e shpirtrat kanë qenë të paaftë për t'i përfytyruar, nga ato të çara të fshehta të hapura për kah e pafundmja, kapërcen vetveten...

* * *

Është në saje të ëndrrave që ne arrijmë të njohim qenien e dy receptorëve tanë të veçantë si zemra (ndjesitë) dhe parashikimi duke shpëtuar, kështu, prej errësirës dhe burgut tripërmator të materies. Kështu, për shpirtrat e lartë të njësuar me të vërtetën, nuk ndihet nevoja e ëndrrave për të vëzhguar të përtejmen. Ata gjithë kohën i shohin së bashku edhe të këtushmen, edhe të atjeshmen, duke jetuar të dehur me bukuritë e së pafundmes. Ç'e do se kjo portë s'është e hapur për këdo; edhe atyre që u hapet, vetëm pas përpjekjeve dhe përvojave tepër serioze mundet t'u hapet...

* * *

Ndërsa ata që e shohin mendjen njerëzore si një plehërishte ku ndodhen të përziëra edhe gjërat më të ulëta ose që kërkimet e tyre lidhur me këtë subjekt i ndjekin në botët e tyre të turbullta të ndjenjave shtazore, i shohin dhe i tregojnë ëndrrat ku përshkohen mijëra frymëzime hyjnore,

karnaval fantazmash të nënvetëdijes, mijëra shpikës dhe mijëra miq të së vërtetës që i marrin prej aty frymëzimet e tyre të para, do të vazhdojnë t'i jenë mirënjohës kësaj klime të begatë të botës simbolike.

* * *

Shpirti më i Lartë, i cili e mbyti botën në dritë, edhe duke soditur në detet e intuitës ku hapi velat me anë të ëndrrave, madje, është kthyer vende-vende në këtë shkallare të parë të shenjtë duke e hedhur fjalën për këtë fidanishte të bekuar që konsiderohet si një fragment i dyzet vjetëve që i përgatitën profetësinë.

Pasioni

Pasioni është një prej favoreve më të fshehta të dhënë njeriut nga Gjithëmëshiruesi. Si një embrion, si një farë, ashku ndodhet pothuaj te çdo individ. Dhe, me aq sa ta mundësojnë kushtet, kjo farë hedh degë e gjethe si pemët, zgjohet si lulet dhe, ashtu si frutat, plotëson qerthullin e përsosjes duke e bashkuar fillimin me përfundimin në një të vetëm.

* * *

Si një ndjenjë, ashku rrjedh nga të çarat sy, veshë dhe zemër për në botët e brendshme të njeriut, dhe gjersa të arrihet bashkimi, fryhet si një ujëmbledhës, rritet si një ortek dhe e mbështjell njeriun gjithandej si një flakë. Pastaj, kur të finalizohet me bashkimin, çdo gjë nis të shpërbëhet: zjarri shuhet, ujëmbledhësi zbrazet, orteku thërmmohet e mbaron...

* * *

Pasioni, i cili, si një kuptim dhe embrion, përbën një aspekt të rëndësishëm pothuaj të çdo shpirti, ngjyrën dhe tonin e vërtetë e gjen duke u shndërruar në pasion të vërtetë, dhe kur e gjen, fiton përjetësi dhe shkon e kthehet, në prag të bashkimit, në një shije të abstraguar.

* * *

Te njeriu, zemra është maja më e lartë, e hapur për shfaqjet hyjnore. Kurse treguesi më i hapur i meritimit nga zemrat të këtyre shfaqjeve, për rrjedhojë, të dashurisë së Allahut, është pasioni dhe dëshira e ndjerë në to për Krijuesin e Lartë.

* * *

Më e prera, më e shkurtra dhe më e shëndosha rrugë për të arritur në horizontin e njeriut të përsosur është rruga e pasionit. Është mjaft e vështirë të arrihet në atë horizont me rrugë të pahapura për pasionin dhe dëshirën. Mund të thuhet se, në arritjen e së vërtetës, nuk ka një rrugë të dytë të njëvlershme me pasionin, veç rrugës së "thjeshtësisë e përkorisë, dëshirës e falënderimit".

* * *

Pasioni është një "kalë shale" dhuruar neve nga Zoti në rrugën për gjetjen e parajsës së humbur. Dhe gjer më sot s'ka ndodhur kurrë që dikush nga ata që ia kanë shaluar këtij kali, të mbetet në rrugë. Ndërkaq, mund edhe të rasisë të hasen udhëtarë të cilët, edhe pse të hipur mbi këtë kalë qiellor, të ecin ngadalë si këmbësorë anës rrugës për shkak të dehjes me ngazëllimin e këtij pasioni. Megjithatë, kjo ka të bëjë me formën e marrëdhënieve mes tyre e Zotit.

* * *

Meqë pasioni e djeg njeriun dhe e bën hi, atij s'kanë ç'i bëjnë as zjarret e kësaj bote e as të botës tjetër, sepse, duke u mbështetur në parimin se dy siguri dhe dy frikë, dy dëshira dhe dy dhimbje s'mund të ndodhen së bashku në të njëjtin çast te i njëjti njeri, themi se s'mund të mendohet që personat të cilët gjatë gjithë jetës ua kanë hapur zemrat flakëve të pasionit e janë përleshur në botët e tyre të brendshme me zjarret skëterrore, të përjetojnë për herë të dytë të njëjtat ankthe e dhimbje...

* * *

Pasioni, i cili, duke e bërë njeriun ta harrojë qenien e vet, i jep mundësi të bëhet një me qenien e atij që do, është emërtimi i dukurisë së shkrirjes në kërkesat dhe dëshirat e të dashurit duke e dëshiruar, pastërsisht dhe pa interes, vetëm atë, gjë që, me ç'pandeh unë, ky është dhe synimi për t'u bërë njeri.

* * *

Sipas mjeshtërisë së pasionit, hyrja e të tjerave iluzione në sytë e të dashuruarit është e ndaluar, dhe nëse ndodh një gjë e tillë, pasioni vdes. Pasioni vazhdon të jetojë për sa kohë dhe në atë masë që gjërat që dëgjohen e ndjen përreth, të jenë emri dhe cilësitë e të dashurit, karakteristikat e bukurisë dhe eposet e përsosmërisë së tij, ndryshe, shuhet e vdes...

* * *

Në asnjë çështje i dashuruari nuk mendon t'i dalë kundër të dashuruarit, nuk mund të mendojë. Sidomos, nuk dëshiron kurrësi që gjëra të tjera t'i bëjnë hije atij, t'i dalin para duke shkaktuar harrimin e tij. Për më tepër, çdo fjalë që nuk flet për të, e quan të kotë e të padobi. Edhe çdo punë që s'ka lidhje me të, i duket si mosmirënjohje e pabesi.

* * *

Pasioni është interesimi i zemrës, prireja e vullnetit dhe dëshirës, zhveshja dhe pastrimi i ndjenjave prej elementeve të huaj si dhe gjendja në të cilën të gjithë receptorët e lartë e të brishtë njerëzorë të mos kapin gjë tjetër veç ëndrrave dhe iluzioneve mbi të dashurin duke mundësuar që në çdo sjellje të të dashuruarit të përshndrisë një ide e re mbi të dashurin dhe, atëherë, zemra të rrahë me dëshirë vetëm për atë, gjuha të pëshpërisë vetëm për atë, sytë të hapen e mbyllen vetëm për atë...

* * *

Në erën që fryn, në shiun që bie, në lumin që buçet, në pyllin që uturin, në mëngjesin që zbardh dhe në natën që errëson, pasionindjen e gjallërohet veç me erën karakteristike të të dashurit, sheh veç bukuritë e tij të reflektuara në mjedis dhe ngazëllehët, ndjen në çdo fryrje frymët e tij dhe mbushet me hare, po kështu, vende-vende parandjen qortimet e tij dhe rënkton...

* * *

Të dashuruarit që zgjohen në agimin e shenjave të të dashurit, e gjejnë veten me buzët të kuqe gjak, me një tufan flakësh në zemër, brenda një qerthulli të zjarrtë. Dhe s'duan të dalin më jashtë prej këtij ferri plot kënaqësi...

* * *

Njëvlerësimi i pasionit me dashurinë epshore të perversëve është i gabuar si dhe flet për mosnjohjen e dashurisë së vërtetë. Në fakt, ka ndodhur ndonjëherë edhe që dashuritë e figurshme të shndërrohen në dashuri apo pasion të vërtetë, mirëpo kjo s'do të thotë aspak se dashuria e

figurshme përfaqëson një vlerë individuale, në të kundërt, kjo argumenton se ajo është e mangët dhe e paperspektivë.

* * *

Për shkak të sëmundjes së pasionit që i zë të dashuruarit e vërtetë, botët e tyre të brendshme u rënkojnë vazhdimisht e janë tërë tym e flakë si një vullkan. Për ata që arrijnë t'i kuptojnë, rënkimet e tyre që u këputen nga gjokset janë llavë të tilla që e djegin vendin ku bien duke shkaktuar zjarr...

* * *

Tregimi i pasionit me fjalë është mjaft i vështirë, madje i pamundur. Prandaj, pjesa e madhe e gjërave që thuhet për dashurinë, s'janë më shumë se shenja të reflektuara prej saj jashtë, sepse dashuria është një përjetim dhe gjuha që mund ta shprehë atë është po vetë përjetimi.

* * *

I dashuruari është një i dehur që, duke e bërë rrugë dashurinë për Zotin, e ka stisur jetën me habi, mahnitje dhe ndjenja pëlqimi ndaj të dashurit, kështu, pra, një i dehur i tillë, që me sa duket, mund të vijë në vete vetëm me borinë e kiametit...

* * *

I dashuruari është si një burim, vazhdimisht gurgullon nga brenda...

* * *

Është vetëm një gjë që do ta heshte dhimbjen e vdekshmërisë, që do ta shuante zjarrin e ankthit të shpirtrave që jetojnë me vjeshtën: pasioni i vërtetë. Po, shpëtimi i vetëm dhe shërimi i vetëm për të gjitha hallet, për sëmundjet e pandehura si të pashërueshme, për ndrojtjet dhe frikërat, për grindjet dhe vorbullat tona prej vitesh, vetëm ashku ka qenë!

* * *

Nëse në zemrat e brezave që përpiqen të ripërtërihen me dije e kulturë, si dhe me kulturën e ditës, nuk lëshojmë qoftë edhe pak nga shkëndijat e ashkut, ata do të mbeten vazhdimisht të mangët dhe kurrësi nuk do të mund ta kapërcejnë natyrën materiale në vetvete...

Femra

Gruaja dhe nëna janë mësuesi i parë i shkollës së njerëzimit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve, për rregullin, harmoninë dhe kënaqësinë e familjes. Fakti që sot, kur për femrën kërkohen vende dhe role të reja, rikujtojmë edhe një herë tjetër këtë pozitë krejt të posaçme të dhuruar asaj prej Zotit, andaj jemi të mendimit se do të parandalojë ca kërkime boshe për të.

* * *

Shtëpia që ka një grua të edukuar dhe të lidhur pas folesë së saj familjare, është një prej këndeve parajsore, dhe zërat që dëgjohen dhe frymëmarrjet që ndihen në atë fole, nuk kanë ndryshim prej zërave të hyrive, prej shushurimës së ujërave parajsore.

* * *

Disa herë, njeriu, kur sheh një femër të shtypur nën stolitë e jashtme, mendon: "Mos vallë kjo femër u jep po kaq vlerë edhe stolive të saj të brendshme si nderi, virtyti dhe personaliteti?"

* * *

Gjërat që e bëjnë femrën më të lartë se engjëjt dhe e shndërrojnë në një margaritar të pashoq, janë thellësia e botës së brendshme, nderi dhe serioziteti. Femra e përfolur për nderin është si njëmonedhë kallpe, kurse femra joserioze është një kukull për të luajtur e tallur me të; në atmosferën vrasëse të femrave të tilla është e pamundur të flitet për fole të lumtura a për breza të shëndoshë.

* * *

Një grua me botë të brendshme të çmuar i përngjet një abazhuri të kristaltë për shtëpinë ku ndodhet. Në çdo lëvizje të saj, dritat bëjnë lojëra që reflektohen në të gjitha këndet e shtëpisë. Kurse fatkeqja e veshur femërisht, e dorëzuar, në botën e saj të brendshme, mendimeve të errëta, është një burim mjegulle dhe tymi, e tillë që, kudo ku shkon, fëlli, duke lerë veç fëlliqësira pas vetes.

* * *

Libri i vetëm që femra duhet të mos e lëshojë kurrë prej dore, është libri i edukatës shoqërore për të cilin s'mund të thuhet se sot ndodhet i shkruar, më së fundi, në formën e tij më të përkryer.

* * *

Kur shoh femrat e lëshuara në dëshirat egoiste, i shoh shumë të matur ata që kanë thënë për femrën "flokëgjatë e mendjeshkurtër"! Pandej se, sikur ata të jetonin sot e të shihnin se si femra është kthyer në subjekt reklame, nuk do të dinin dot ç'të thoshin!

* * *

Të parët thoshin: "Gjilpëra në dorë të femrës, si heshta në dorë të luftëtarit!" Ç'është e drejta, në këtë fjalë unë nuk shoh kurrfarë teprimi!

* * *

Periodhat kur femra është bërë për të tjerët mjet kënaqësie, subjekt dëfrimi dhe material reklame, janë aq shumë sa s'mund të nënvleftësohen. Bekuar qoftë që të gjitha këto periudha fatkeqe janë bërë gjer tani gjithmonë fillim i ripërtëritjes e i rilindjes së saj, si dhe i rigjetjes së vetvetes dhe i vendit të vet të merituar në shoqëri!

* * *

Dikur djalit i thoshin "bir", kurse vajzës, "bujare" ose "bebe e syrit" duke e nënkuptuar atë si një krijesë të shtrenjtë, të nevojshme po aq sa edhe të shtrenjtë dhe delikate.

* * *

Ne themi: "Ruaje rrobën prej pluhuri e dheu!" S'e di, a e vlerësoni dot se sa duhet ta ruajmë, pra, femrën, beben e syrit, nga ndotja?

* * *

Ashtu siç janë nderi dhe virtyti, stolia e femrës, ashtu edhe aspekti i saj i merituar për pëlqim e që do të shihej me mahnitje, është edukata shoqërore dhe besnikëria e saj ndaj të shoqit!

* * *

Femra e mirë është ajo me urtësinë në buzë, me brishtësi dhe delikatesë në shpirt, me respekt ndaj kujtdo në sjellje ashtu që vështimet konfidente, duke e ndjerë këtë aspektin e saj të shenjtë, turbullitë e brendshme me burim njerëzor i kthejnë në mësim dhe meditim.

* * *

Një femër që, ndërsa trupi i zhvillohej, sythat zemër dhe shpirt nuk ka mundur t'i zhvillojë, edhe nëse në krye u ngjan, për një farë kohe, luleve për kurorë, pashmangmërisht do të zbehet më pas, do të derdhet fletë-fletë e do të shkelet me këmbë... Ç'fund i hidhur për ata që s'arrijnë ta gjejnë rrugën për t'u bërë të përjetshëm!..

* * *

Femra është një margaritar aq i çmuar sa të mos zhvlerësohet duke e hedhur në dëfrime të marra... Ne ende s'e kemi humbur shpresën se brezat fatlumë që e shohin të ardhmen të lidhur me diturinë, kulturën dhe të vërtetën, do ta ruajnë atë të shenjtë, si dritën e syve...

* * *

Femra jonë është guri themelor i shëndoshë edhe i nderit, edhe i fisnikërisë kombëtare. Pjesa e saj e kontributit në sendërtimin e së kaluarës sonë tejet të gjatë e të famshme nuk mbetet aspak më pas pjesës së kontributit të luftëtarëve të përleshur fyt më fyt me armikun...

* * *

Shumica e apologjetëve të lirive dhe të të drejtave të botës femërore s'kanë tjetër synim veç sakatimit të botës shpirtërore, dhe, më pas, shfrytëzimit të saj për të gjitha llojet e kënaqësive trupore e materiale.

* * *

Në saje të pasardhësve të dobishëm të përgatitur e të lënë pas nga një femër-nënë me pjekuri shpirtërore, në atë fole familjare mbretëron prehja e kënaqësia dhe ajo fole familjare bëhet një bahçe parajsore që nuk mund të përshkruhet!

* * *

Një grua shtëpie që e ka ndriçuar zemrën me dritën e besimit, kurse kokën, me dritën e arsimit dhe edukatës shoqërore, çdo ditë, sikur ta rindërtonte sërish, i shton shtëpisë së saj bukuri të reja, kurse femra e ulët dhe injorante, e dhënë pas dëfrimeve e shpenzimeve, edhe atë fole që e ka gjetur gati, madje, e shemb duke e kthyer në gërmadhë, e mbush me ankth e brengë duke e kthyer në varrezë...

* * *

Femra s'është ndonjë enë e palarë apo ndonjë copë metali e pavlerë, pra s'e ka vendin te enët e palara apo hekurishtet; ajo është një perlë e pashoqe që duhet ruajtur në kutinë e perlave...

* * *

Në ndjeshmëri, delikatesë e brishtësi, femra ka një vend të posaçëm. Me këto veçori, ajo mund të bëhet e dobishme për follenë e vet familjare, për rrjedhojë, për shoqërinë, vetëm për sa kohë që mbetet brenda qerthullit të krijimit dhe natyrës së vet!

* * *

Çdo lloj propozimi i pretenduar gjer më sot nga feministët për femrën ka shkaktuar gjithmonë zhvlerësimin, banalizimin e personalitetit dhe shformimin e natyrës së saj. Kurse femra është një hallkë tepër e rëndësishme në zinxhirin e ekzistencës, ndërkaq që aspekti më i rëndësishëm i saj është respektimi i mbetjes së saj brenda kufijve të natyrës së vet!

Natyra

Në kuptim të përgjithshëm, natyra është tërësia e ekzistencës, karakteristikat dhe veçoritë e saj të rrjedhura nga krijimi i vet. Kurse te njeriu, natyra është karakteri dhe temperament i tij. Në ç'aspekt dhe në ç'formë që të trajtohet, natyra është, në fund të fundit, një dantellë e punuar me dorën e Fuqisë së Pafundme, një sistem ligjor në dorë të Fuqisë Krijuese si dhe një libër që këndon urtësitë e Tij. Krejt si lënda, edhe natyra është e pandjeshme dhe e pavetëdijshme. Nisur nga kjo, themi se natyra, me gjuhën e shumë e shumë qenieve që krijohen çdo ditë në gji të saj si dhe me gjuhën e të gjitha qenieve që kërkojnë vetëdije, vullnet, njohje dhe planifikime shkencore, s'bën tjetër veçse pohon me zë të lartë dobësinë dhe varfërinë e vet. Domethënë, natyra shpall me zë të lartë e pa pushim diturinë që e rrethon, fuqinë e shkëlqyer dhe një vullnet marramendës.

* * *

Meqë natyra është identitet i veçorive të lëndës dhe i cilësive të saj të bashkëlindura, nuk mund të jetë parësore ndaj lëndës në saje të së cilës ekziston. Atëherë, nëse është kështu, mbështetja e ekzistencës dhe e dukurive te natyra dhe përpjekja për t'i shpjeguar ato me natyrën, s'është tjetër veçse gënjeshtër e vetëmashttrim!

* * *

Sot, edhe ata që merren fare pak ose kanë të bëjnë fare pak me shkencat eksperimentale, e dinë shumë mirë se natyra është një forcë e shurdhër dhe e verbër dhe se ajo nuk mund të krijojë asgjë, kështu që përpjekja për ta vënë atë në vend të Fuqisë Krijuese s'duhet të jetë gjë tjetër veç një mohim ekstrem dhe trashanik!

* * *

Paraqitja e natyrës brezave të rinj si një fuqi krijuese duke ua treguar atë të ndryshme nga ç'është ndërkohë që cilësia e saj njihet fare qartë, konsiderohet kundërshtim ndaj shkencave si dhe fyerje ndaj të gjitha krijesave të ekspozuara në ekspozitën e kësaj bote, krijesave që janë secila nga një vepër arti më vete!

* * *

Po qe se natyra është vetë qenia, s'e di, ata që thonë për qenien "e ka krijuar natyra", a i bien në të se me këto fjalë duan të thonë "natyra e ka krijuar vetveten"? Por, po qe se me fjalën "natyrë" duan të tregojnë për gjëra të tilla si karakteret, temperamentet, atributet, ligjet, disiplina, etj., a nuk duhet të japin shpjegime se si ka ndodhur që natyra, e cila është djepi i materies dhe dukurive, i ka krijuar dhe i ka vënë në rregull këto?

Largpamësia

Largpamësi do të thotë konceptim i plotë e gjithëpërfshirës i specifikave që përbëjnë bazat themeltare për të parë e parandjerë, për të ditur e vlerësuar me anë të diturisë, përvojës dhe dritës së aftësisë konceptuese. Dhe, nëse njeriu parashikues sipas këtij kuptimi, është i hapur edhe për botët përtej, ai është bërë, më në fund, një njeri i së vërtetës, një hero i shpirtërores, i vendosur për t'u bërë i përsosur!

* * *

Mendja (arsyeja) është një burim i rëndësishëm diturie, kurse largpamësia, një burim serioz kulture. Është mjaft e vështirë, madje e pamundur që njeriu me arsye, por pa aftësi parashikuese të arrijë diku me ato që di, edhe nëse di shumë gjëra dhe kupton nga shumë gjëra!

* * *

Po që se largpamësia është konceptimi i një gjëje ashtu siç është ose afër asaj që është, çdo njeri i mençur mund të mos quhet i aftë për të parashikuar.

* * *

Në kundërshtim me dukjen shpesh të dyshimit, lëkundjes dhe pavendosmërisë të mendja e paaftë për të parashikuar, klima e parashikimit është gjithmonë e ngrohtë, e butë, e vendosur dhe e sigurt.

* * *

Mendja dhe mendimi janë niveli i fundit konceptual i trurit, kurse largpamësia është shkalla e parë njohëse e shpirtit, ndërkaq që kulmi i tij është urtësia, për çka edhe Kurani, duke thënë “Atij që i është dhënë urtësia, i është dhënë një mirësi e jashtëzakonshme”, e nxjerr në pah këtë të vërtetë!

* * *

Ata që e shohin qenien vetëm me sy, mund ta rrokin atë vetëm sa e lejojnë përmasat përfshirëse të shikimit. Ata që e hulumtojnë cep më cep materien me anë të aftësisë parashikuese, ashtu siç mbledhin bletët nektarin lule më lule, mund të nxjerrin kuptime të reja nga çdo gjë!

* * *

Syri rrok formën, fytyrën dhe vendin që zënë në hapësirë njerëzit që sheh. Përtej këtyre, largpamësia rrok te ata edhe gjëra të tilla si morali, virtytet dhe niveli cilësor shpirtëror.

* * *

Sytë i shohin materien dhe dukuritë me fytyrën e jashtme dhe aspektet e tyre lëndore, kurse largpamësia i sheh, i njeh dhe i koncepton edhe me aspektet e tyre të brendshme si përmbajtja, dobia, qëllimi përfundimtar dhe urtësia!

* * *

Largpamësi nuk do të thotë mendje as edhe mendim. Ndërsa mendimi është fryt i mendjes, largpamësia është një aftësi hyjnore shumë përtej mendimit!

* * *

Gjëja që e dallon njeriun prej kafshëve, është vetëdija, parashikimi, dhe më tej, meritimi i frymëzimit dhe urtësisë. Ata që janë të privuar nga këto dhunti, quhen se nuk kanë arritur dot në pikën e fundit ku duhet të ndodhen sido që të paraqiten në pamjen e jashtme!

Ndjenja dhe ndijimi

Ndjenjë dhe ndijim do të thotë rrokje nga njeriu e gjërave që hyjnë në nivelin njohës dhe perceptues të tij të brendshëm e të jashtëm, domethënë konceptim me anë të shqisave të

brendshme e të jashtme; kështu, ai që arrin të rrokë disa ose shumë gjëra në të njëjtën kohë, quhet “i ndjeshëm”.

* * *

Mendja është forma konceptuese e trurit, kurse ndërgjegjja, e shpirtit. Nëse të parën do ta përkufizonim “njohje”, të dytën do të ishte e përshtatshme ta quanim “ndierje”. Nisur nga kjo, kurrsesi nuk mund të mendohet që personat mendjetrashë e ndërgjegjevedekur ta ndiejnë dhe përjetojnë ekzistencën si dhe t’i njohin dhe kuptojnë gjërat që ndodhin brenda saj!

* * *

Nga aspekti filozofik, ndjenja është ndërgjegjja, mekanizmi njohës vetjak i shpirtit. Kështu, njeriu pa ndjenjë, në një kuptim, është pandërgjegje, kurse njeriu pandërgjegje, në një kuptim, është pa ndjenja!

* * *

Në një kuptim më të hollë, ndjenja është kuptimi diferencues, me anë të një mekanizmi të brendshëm, i të mirës dhe të bukurës nga e keqja dhe e shëmtuara, dhe në këtë rrugë mund të dalin në pah shumë karakteristika njerëzore. Për shembull, pasi ta kemi zënë rob armikun, ne vendosim për vrasjen ose faljen e tij më shumë me ndjenjë sesa me arsye. Po ashtu për një person që na ka njollosur nderin: ta njollosim edhe ne atë, apo të sillemi njerëzisht ndaj tij!

* * *

Ndjenja edukohet dhe zhvillohet me urtësi. Kurse filozofia materialiste e qorron ndjenjën dhe e shuan. Prandaj ndodh që ata që e trajtojnë një çështje duke e mbështetur në arsyen, asnjëherë nuk munden ta njohin botën e ndriçuar të ndjenjës.

* * *

Ndjenja e drejtë kërkon një ndjeshmëri të pacenë, të pamëri. Kështu, ndjeshmëria e plotë dhe e vërtetë lind prej një ndjenje të plotë e të vërtetë!

* * *

Të gjitha fitoret e të pandjenjëve e të të pandërgjegjshmëve janë krejtësisht fitore kafshërore si dhe nga një varg shëmtish më vete, asisoj që teprimi në aspektin material dhe egoistik finalizohet me thyerje shpirtërore dhe me paralizimin e mekanizmit ndërgjegjësor.

* * *

Ata që i ndiejnë në ndërgjegje dhimbjen dhe ankthin e fatkeqësive të rëna mbi fenë, atdheun dhe kombin, janë ca shpirtra të larta me botë të brendshme të ndjeshme, të cilët nuk druhen ta flijojnë me gjithë dëshirë edhe jetën për këto vlera të larta të cilave ua kanë falur zemrën. Sa për personat e pandjenjë, edhe sikur të shpenzojnë shumë fjalë për fljimin, nuk u mjafton fuqia për të bërë edhe më të paktën prej gjërave që zënë në gojë...

* * *

Prania te njeriu, edhe në dëm të vetes, e vetive të larta si altruizmi, pra, mendimi për tjetrin para vetes, jetesa për tjetrin, marrja pjesë në gëzimet dhe hidhërimet e tjetrit, që janë secila vlera më vete, rrjedhin nga prania tek ai e ndjeshmërisë shpirtërore të lartë. Kurse te njerëzit të privuar krejtësisht nga një pasuri e tillë ndjesore, është krejtësisht e pamundur të shohësh jo më tërësinë e këtyre vlerave, por as edhe njërin prej tyre! Sa për gjërat si virtyte apo burrëri të dukura në njerëz të tillë, ato u ngjajnë më shumë mërmëritjes nga dikush të një pjese të kompozuar nga dikush tjetër.

* * *

Përparimi dhe lartësimi i një kombi varet nga uniteti ndjesor dhe thellësia emocionale e individëve të tij, të cilët, nëse kanë botë shpirtërore të thellë, e flirtojnë pa iu trembur syri çdo gjë që kanë në dorë për hir të ideve dhe kauzës së tyre, kurse, kur mbeten të pashpresë, vuajnë e treten si qiri.

* * *

Shkalla më e lartë e ndjenjës është një emfazë e ndezur, e shfaqur kur dhunohen vlerat fetare e kombëtare, e cila i dridh shpirtat e ndjeshëm si një ethe, duke i bërë të hidhen përpjetë. Kësaj ne mund t'i themi edhe atdhedashuri e zjarhtë.

* * *

Atdhedashuria është vuajtje e përpëlitje e një shpirti në atë vend ku vlerat janë shembur e kthyer përmbys dhe janë këto vuajtje e përpëlitje si veçoria më e dallueshme që i ndan nga njëritjetri njeriun e vërtetë nga qenia me trajtë njeriu. Të gjitha kokat e vuajtura, nga Shpirti më i Lartë që ndodhet në majë e gjer në të vuajturit e ditëve tona, kanë vuajtur e rënkuar, vuajnë e rënkojnë nën ethet e kësaj sëmundjeje duke rënë e ngritur e duke u përsjellë maleve, shpellave e varrezave... Sipas meje, ata që kanë krijuar epokat më të shkëlqyera të historisë, janë pikërisht këta heronj të ndjenjës dhe atdhedashurisë!

Vezullime urtësie, ose sipas filozofisë

Kundërshtimi i shumicës është gabim. Por kur shumica të jetë shumicë, përndryshe, miratimi është një gabim. Ashtu siç nuk është gabim kundërshtimi i opinionit të dhënë, bie fjala, nga inxhinierët për një të sëmure, ashtu edhe nuk është gabim të mos merren parasysh pikëpamjet, bie fjala, të mjekëve për llogaritjet ndërtimore të një objekti...

* * *

Paaftësi nuk do të thotë vetëm mungesë fuqie apo pushteti. Sa e sa persona të fuqishëm e të aftë ka, të cilët, meqë nuk vlerësohen e nuk përfitohet prej tyre, ndodhen në gjendje pasiviteti e paaftësie.

* * *

Ashtu siç drita e atyre që e kanë atë në vetvete, nuk mund të fshihet e të shuhet me anë të errësirave, as edhe nuk mund të mposhtet me anë të ndonjë drite tjetër. Një burim i tillë drite, pavarësisht nga çdo gjë, digjet e ndriçon për sa të jetë gjallë...

* * *

Për ata që nuk e veshin dhe stolisin veten me besim, mendja është një vegël e dëmshme e shqetësuese...

* * *

Ai që bën vetëm duke parë, nuk mund të jetë i suksesshëm sa ai që bën duke ditur; po kështu, ai që bën vetëm duke ditur, nuk mund të jetë i suksesshëm sa ai që bën duke ndjerë e duke qenë i ndërgjegjshëm për atë që bën...

* * *

Varfëri s'është vetëm mungesa e parasë, por edhe e diturisë, mendimit, aftësisë. Nisur nga kjo, edhe të pasurit në para por të varfër në dituri, në mendim e në aftësi, janë një lloj tjetër të varfërish.

* * *

Disa herë syzet për syrin, kurse gjithmonë syri për mendjen, mendja për parashikimin, parashikimi për ndërgjegjen dhe ndërgjegjja për shpirtin janë "e çarë" për të vëzhguar dhe mjet për të parë.

* * *

Njeriu më për të ardhur keq në çmendinë, është i mençuri. Po të hyjë një i çmendur mes nesh, bëhet për të ardhur keq. Çdo njeri është një i çmendur, por forma e çmendurisë është e ndryshme...

* * *

Njerëzimi është një pemë, kurse kombet, degët e tij. Ndodhitë, të cilat u përngjajnë erërave të forta, i përplasnin ato me njëra-tjetrën me atë forcë që fryjnë. Natyrisht, dëmin e pëson pema. Ky duhet të jetë edhe kuptimi i fjalës së urtë, "Kush bën, vetes ia bën!"

* * *

Netët janë si sheshe të hapura për zhvillimin e njeriut dhe për përgatitjen e lumturisë së njerëzimit. Gjithë në këtë mitër të errët janë ngjizur dhe zhvilluar idetë e larta dhe veprat e larta, duke iu ofruar saora përfitimit të njeriut!

* * *

Pothuajse gjithmonë ata që kanë ftuar për udhëtim përtej qiejve, janë zgjedhur mes atyre që derdhen udhëve në të aguar.

* * *

Barku i hedh jashtë ushqimet e patretshme e të padobishme e, pastaj, pështyn mbi to... Të njëjtën gjë bën edhe historia ndaj njerëzve të padobishëm!

* * *

Ndryshku është armiku i hekurit, plumbi, i diamantit, dëfrimi i shfrenuar, i shpirtit... Në mos sot, nesër, pa diskutim, dëfrimi i shfrenuaro ta kalbë e shkatërrojë shpirtin...

* * *

Çdo gjë e verdhë nuk është ar, çdo gjë që shkëlqen nuk është dritë, çdo gjë që rrjedh nuk është ujë...

* * *

Çdo shtrëngatë krijohet prej pikash të vogla uji të parëndësishme dhe arrin në një nivel të papërballueshëm. Trupi i shoqërisë është i ekspozuar çdo kohë ndaj këtyre lloj shtrëngatave dhe disa herë ndodh që këto shtrëngata i marrin me vete edhe ata që kërkojnë t'u dalin para si pritë...

* * *

Nëse do t'u tregosh naivëve se ç'është dituria dhe e vërteta, ajo është po aq e vështirë sa të merresh me prova e argumente me të çmendurit, andajmësuesit dhe udhërrëfyesit duhet ta bëjnë këtë detyrë me dashuri...

* * *

Më e rrezikshmja e të këqijave që mund t'i bien në kokë njeriut, është ajo që i vjen duke i qeshur në fytyrë...

* * *

Meqë të vërtetat lakuriqe nuk i kupton çdokush në të njëjtin nivel, është braktisur rruga e meditimit dhe është zgjedhur rruga e identifikimit dhe analogjisë.

* * *

Ankesa bëhet gjithmonë për kohën dhe vendin, kurse fajtori i vërtetë është injoranca. Koha dhe vendi janë të pafajshëm, kurse njeriu, shumë injorant dhe mosmirënjohës!

* * *

Atdheu s'është pyll, por kopsht. Për ta mbushur dhe rregulluar atë, ka nevojë për përgatitjen e luleve e të fidanëve frutorë...

* * *

S'e di se ç'mund t'u thuhet atyre që, pasi ua lenë kopshtin furisë pushtuese të barërave të këqia, ankohen për fatin...

* * *

Sa e sa rrugë të bukura me diell, me bar e lule ka që përfundojnë në shkretëtira vrasëse. Dhe sa e sa të përpjeta plot gjemba ka që arrijnë në dyer të parajsës...

* * *

Siç duket, njëra prej urtësive më të mëdha është fjala e urtë, "Njeriu ndodhet i fshehur nën gjuhën e vet!" Kurse për mua, fjala e urtë, "Në kërkofsh mik, Allahu të mjafton, në kërkofsh shok, Kurani të mjafton!"

* * *

Njerëzit e dinë se ç'është njohja dhe gjëja e njohur, por s'e dinë se kush e bën njohjen. Ai që njih, është shpirti me anë të mjetit mendje; ai që sheh, është prapë shpirti me anë të mjetit sy...

* * *

Nëse lëvizja krijohet si rezultat i motiveve apo faktorëve racionalë apo natyrorë, është kafshërore, kurse, nëse mbështetet në motive apo faktorë ndërgjegjësorë e të vullnetshëm, është humane dhe shpirtërore.

* * *

E paqena është një hiç i frikshëm në tërë përmasat e të cilit, në mund të shprehemi kështu, nuk mund të gjesh as edhe një grimcë që të dëshmojë për ekzistencë në të...

* * *

Tani, njerëzve fetarë u thonë fanatikë. Fanatizmi është këmbëngulje e verbër dhe neurastenike në të shtrembrën, kurse këmbëngulja në të vërtetën është virtyt, pra kjo sjellje e besimtarit kurrsesi s'është fanatizëm...

* * *

Filozofia e pambështetur në mesazhet hyjnore është stonaturë e mendimit...

* * *

Filozofia e vërtetë është një brengë e mendimit dhe e shpirtit, e krijuar vetëm e vetëm me anë të zgjimit të njeriut nga ana e Allahut për ta rrokur urtësinë...

Urtësia

Gjendet një pishtar hyjnor që, duke ia ndriçuar rrugën mendjes, i hap asaj horizonte të reja dhe, rrugët që kërkojnë vitin për t'u përshkuar, nën ndriçimin e të cilës mund të përshkohen në një orë: ideja!

* * *

Detyra e idesë është të hulumtojë të drejtën. Në laboratorin e saj, që ka për mjete dhuntitë hyjnore, shumë gjëra të drejta, për ta gjetur të drejtën, ndryshohen pa pushim; këtu qëndron edhe fisnikëria e idesë.

* * *

Ide do të thotë të mendosh. Më tepër se besimi pa i gjykuar i gjërave që vijnë në mendje dhe shkatërrimi i të tjerave duke kërkuar të meta në to, e duke i kundërshtuar ato, mendimi është një përpjekje e virtytshme që e merr fuqinë nga logjika, urtësia dhe dhuntia hyjnore që të çon tek e vërteta...

* * *

Në një kuptim, ideja është eleganca dhe dritësimi i mendjes. Mungesa e idesë nuk do të thotë mungesë e mendjes. Në ndryshim prej mendjes e cila e kap çdo gjë të ndriçuar dhe e vlerëson, idesë i pëlqen më shumë t'i përcaktojë në errësirë gjërat që kërkon t'i përcaktojë. Po, ideja dhe shpirti bëjnë punë më shumë në errësirë...

* * *

Urtësia ose filozofia islame është zhvilluar dhe ka hedhur shtat në majat e mendimit vetëm në këtë kuptim. Urtësia e shëndoshë është shfaqur kudo e kurdoherë kur ka sunduar mendimi i shëndoshë, kurse në ato periudha e në ato vende ku mendimi i mangët e i çalë është imponuar, ka dalë në shesh një filozofi defektoze e mashtruese.

* * *

Po qe se filozofinë me të metat dhe plasaritjet e saj do ta quanim urtësi, edhe filozof do të thotë i urtë që e do urtësinë.

* * *

Njëri prej burimeve më të rëndësishëm të dritës i cili, duke e shpëtuar mendimin njerëzor prej turbullirës dhe zemrën prej egërsisë, pas pastrimit shpirtëror, i vë në dorë ndërgjegjes një pishtar të ndezur për t'i ndriçuar vendet ku ka për të arritur, dhe që nën këtë ndriçim, bën të lexohen shkrimet në fytyrën e ekzistencës, është urtësia apo filozofia islame.

* * *

Shkencat vërtiten brenda kornizës së mendjes, urtësia bleron e zhvillohet në atmosferën shpirtërore. Tërësia e vlerave morale-shpirtërore lind dhe rritet në klimën shpirtërore shumë përtej kornizës së mendjes.

* * *

Synimi i urtësisë është ndriçimi i rrugëve që shkojnë për te Allahu dhe shpirti. Ky proces ndriçimi bëhet herë duke kaluar nga vepra te autori i veprës, e herë nga autori te vepra. Që të dyja

rrugët mund ta çojnë njeriun te e dobishmja dhe bukuritë absolute, në atë masë sa janë të shëndosha qëllimi dhe botëkuptimi i atij që mban në dorë këtë pishtar të urtësisë!

* * *

Dijetar nuk është ai që di, por ai që e ndien në ndërgjegje atë që di. Ç'të jetë dijetari përballë injorantit, të tillë janë edhe i urti dhe filozofi përballë dijetarit.

* * *

Dijetari hyn në marrëdhënie me qeniet me aspektin e tyre thjesht material që i përket botës konkrete, kurse i urti merret vazhdimisht me botën e padukshme e metafizike përtej...

* * *

Gjërat e bukura që i sheh e bëhet dëshmitar i tyre, por që nuk i ndjen në ndërgjegje si një kënaqësi sublime, dijetari mund t'i quajë të këqija. Ndërkaq, meqë çdo gjë e trajton nga ana e saj e fshehtë, "pas kuintave", i urti e zhvillon të gjithë veprimtarinë e vet ideore pothuajse në një atmosferë adhurimi...

* * *

Nuk do të thotë që çdo gjë e padëshirueshme të jetë e shëmtuar dhe e keqe. Fëmijët nuk e kanë qejf të vrasin mendjen e të mësojnë, nuk u pëlqen të pinë ilaç a të bëjnë gjilpërë, por mpaken për të luajtur me zjarr dhe gjarpërinj... Në të njëjtat përmasa mund të trajtohen edhe dituria, mendja dhe urtësia.

* * *

Filozofët e rinj tek ne janë ata që kanë lidhje më pak se të tjerët me filozofinë. Ajo çka kanë bërë shumica prej tyre, është ndonjë përkthim gjysmak... Eh, sikur ta kishin bërë saktë qoftë edhe aq gjë!..

* * *

Urtësia mund të vërtetohet jo me mendjen, por me miratimin dhe dëshminë e shpirtit. Sigurisht, urtësinë, prapë urtësia e kupton; mendja është ose armiku ose miku i pasinqertë i saj...

* * *

Fakti që mendja shumë herë s'e pëlqen urtësinë, rrjedh prej pamundësisë për ta kuptuar atë. Çështjet e urtësisë janë aq të holla dhe përtej mendjes, saqë mendja që s'ka marrë krahë prej frymëzimit, e ka shumë të vështirë t'i afrohet asaj, madje, të pamundur!

* * *

Nëse mendja është shtresa e bardhë e syrit, urtësia është shtresa e zezë e tij e cila lind nga errësira që pason dritën e mendjes...

* * *

Mendja është emërtimi i rrokjes së materies me anë të punës së duarve, kurse urtësia, me anë të syve. Mendja është emërtimi i shikimit të ekzistencës me syze, kurse urtësia, i vëzhgimit të saj me dylbi ose me teleskop...

* * *

Mendja nuk mund t'i kapërcejë kufijtë e lëndës; tej lëndës mund të shohin e të parandiejnë urtësia dhe filozofia e vërtetë. Por sa e hidhur është që, në vend që të dëgjojnë atë zërin gurgullues e që s'të gënjen të urtësisë, njerëzit shkojnë e dëgjojnë daulle e zurna...

* * *

Janë dy pishtarë që ndriçojnë rrugët e errëta e të ngatërruara të jetës: njëri, mendja e shëndoshë, tjetri, urtësia...

* * *

Dituritë janë drita e mendjes, kurse urtësia, rrufetë që shkreptijnë në qiellin e shpirtit...

* * *

Ngatërrimi me njëra-tjetrën i filozofisë materialiste me urtësinë, është shprehje e mosnjohjes së të dyjave. Por sa çudi që tani nga të gjitha anët vetëm përçartjet e këtyre lloj injorantëve dëgjohen...

* * *

I urti, brumi i të cilit është zënë me urtësi, i sodit gjithësitë që nga muret e ngushta të qelisë së vet dhe arrin në pika të tilla të paarritshme, asisoj që udhëtarët që shëtisin botën, nuk mundën të shohin as dhe një të qindtën e atyre gjërave që sheh ai...

* * *

Filozofit i thonë “njohës i gjithësisë”; ai që s’është njohës i të vërtetës dhe “i afërm i Zotit”, nuk mund të jetë filozof i vërtetë.

* * *

Çdo fjalë i shpërthen njeriut nga shpirti e del në shesh sipas nivelit kulturor të tij dhe ia kuptojnë vetëm ata me horizontin në atë nivel. Pamundësia për t’i kuptuar fjalët e holla, të vërtetat e imta, ose vlerësimi i tyre si të thjeshta apo vulgare rrjedh jo nga mosdija apo trashësia e shpirtit, por nga mungesa e kulturës te ai.

* * *

Shumë shpesh kombet kanë mbetur e janë shtypur nën paletet e fuqisë së paurtësi. Në fakt, kur fuqia e paurtësi e shtyp urtësinë e pafuqi, është dikush që shtypet me të vërtetë e qan: e vërteta!..

* * *

Vlerën e margaritarit e njohin sarafët, shkencëtarin, dijetarët si dhe njeriun, e njohin njerëzit e përsosur të ngjitur në nivelet më të larta të vlerave njerëzore. Margaritari duket i çuditshëm në tregun e bakrit, dijetari, mes injorantëve, njeriu, mes shpirtrave shtazorë si dhe i urti, në një botë ku gjykimi dhe ndërgjegjja janë hedhur pas shpine...

Ndërgjegjja nga këndvështrimi i urtësisë

Ndërgjegjja, e cila është emërtimi i ndjerjes së vetes e i ekzistencës së vet, është një mekanizëm shpirtëror që kërkon, parandien, koncepton dhe që ndodhet gjithmonë i hapur ndaj të pafundmes.

* * *

Mjetet përkapëse të shpirtit si vullneti, ndjenja, mendja dhe zemra janë, në të njëjtën kohë, edhe fundamentet themelore më të rëndësishme të ndërgjegjes që e çojnë njeriun këtu te përsosja njerëzore, kurse përtej, te lumturia e amshuar dhe soditja e Zotit.

* * *

Ndërgjegjja është një pasqyrë vezulluese që e tregon të Vërtetën, Zotin, si dhe s'e ka shopen si interprete e Individualitetit të Lartë, mjafton të gjejë shpirt që ta bëjë t'ia ndjejë qenien dhe veshë që t'i bëjë t'ia dëgjojnë zërin!..

* * *

Meqë ndërgjegjja është ndjenja e shpirtit, vëzhgimi dhe njohja e tij, ajo është pranuar gjithmonë mbi hapësirën, e hapur ndaj botëve përtej, me kriteret të sakta si dhe me një pafajësi të njëvlershme me atë të engjëjve...

* * *

Myftinjte janë shumë dhe, pothuajse të gjithë ata, me aq sa kuptojnë, u drejtohen të njëjtave burime dhe ashtu japin fetva. Ndërgjegjja është një myfti me vështrim të mprehtë, i tillë që, kur jep fetva, jep sipas të vërtetës dhe, në fetvatë që jep, askënd s'e le të zhgënjyer dhe askujt s'i bën të padrejtë!..

* * *

Ndërgjegjja e Përgjithshme do të thotë ndjenja e shumicës dërrmuese, parandjenja dhe njohja e saj, në atë nivel sa rënia e saj në gabim, është pothuajse e pamundur, sidomos nëse informacioni dhe njohuritë e përftuara mbështeten në të njëjtin burim frymëzimi...

* * *

Pasi Ndërgjegjja e Përgjithshme të bëhet një i urtë i pagabueshëm e i pamashtrueshëm, individëve u mbetet vetëm miratimi i konkluzioneve të saj dhe pranimi i saj si arbitër, gjë që do të thotë për të instancë e fundit në një sërë çështjesh.

* * *

Detyrë është ajo që e urdhëron Zoti dhe që i japin gjallëri ndërgjegjjet e shëndosha si profetët. Atëherë, është e pamundur që ajo të mos pranohet. Zoti është i Urti absolut, kurse ndërgjegjja, pasqyra më besnike e Tij. Edhe në tregoftë herë-herë turbull, në shumicën e herëve, atë që tregon, e tregon drejt.

* * *

Rregullsia e një njeriu në sjellje e veprime shfaqet prej rregullsisë së tij në shpirt dhe ide, kurse karakteri sublim i akteve të tij rrjedh ngaqë ndërgjegjen e ka të hapur ndaj botëve përtej...

Dijanga këndvështrimi i urtësisë

Leximi, studimi dhe qëndrimi kërkues për të arritur dijen, janë nga ushqimet më të rëndësishme të shpirtit, kurse privimi prej këtyre është një mangësi shumë serioze, plotësimi i së cilës është i pamundur.

* * *

Ndërsa të huajt, duke e shkelur vendin tonë me pëllëmbë e duke kërkuar në shkëmbinj e gurë, përfitojnë prej thesareve tona kulturore, nëse ne vetë nuk i hulumtojmë, nuk i lexojmë a nuk mundim t'i lexojmë burimet diturore e kulturore të së shkuarës sonë, duhet të ulemi e të vajtojmë për batakun ku kemi rënë...

* * *

Qëndrimi ynë i pamoralshëm dhe i turpshëm si komb ndaj veprave shkencore e letrare të lëna trashëgim nga etërit, që bota e sotme u bie pas me dëshirë e pasion, ç'është e drejta, është i pakuptueshëm.

* * *

Ata që i turbullojnë mendimet e brezave të rinj me njohuri të panjohura mirë ose të njohura e të papranueshme, nuk janë vetëm të dëmshëm, por, njëkohësisht, konsiderohen edhe tradhtarë.

* * *

Ankthi është burimi më i kulluar i frymëzimit.

* * *

Qenësia dhe shkëlqimi i një kombi janë në përpjesëtim të drejtë me thellësinë kulturore e artistike të tij. Një komb që ekspozon veprat e veta kulturore e artistike në të katër anët e botës, thotë pa reshtur me aq gjuhë sa ç'është numri i atyre veprave, "edhe unë ekzistoj!"

* * *

Vlera e njeriut dhe nderi i tij mes njerëzve arrihen me dije e nivel shpirtëror. Edhe një njeri i ulët e i pavlerë, madje, mund të jetë, çdo kohë, i pasur, por i nderuar, kurrë!

* * *

Sado të shumta të jenë ato që ka lexuar e mësuar një njeri, kurrë nuk duhet ta pengojnë për të lexuar e mësuar më tej. Shkencëtarët e vërtetë kanë dalë më shumë nga radhët e atyre që, krahas kërkimeve shkencore, dijet e veta i kanë vlerësuar të pamjaftueshme.

* * *

Kur e vërteta nis të flasë, injoranca zemërohet, fanatizmi shqetësohet, kurse dituria hap veshët e dëgjon.

* * *

Nuk është e drejtë të thuhet për çdo injorant, i paditur. Injorant i vërtetë është njeriu i paaftë për ta ndjerë të vërtetën. Sado që të dijë, një njeri i tillë është, prapëseprapë, injorant!

* * *

Të jetosh, nuk do të thotë të shohësh e të dish, të hash e të pish. Të jetosh, do të thotë të ndjesh. Ai që di, është i dobishëm, ai që s'di, i dëmshëm, kurse ai që di pak, është më i dëmshëm se ai që s'di. Edhe sikur ata që dinë gjithçka bashkë me ata që s'dinë asgjë, të gënjehen ndonjëherë rrallë, nuk gënjejnë, kurse ai që di pak, gënjen shumë!

* * *

Gjërat e treguara në emër të shkencës, pranohen si të kuptuara, kurse ato që s'ka qenë e mundur të tregohen, konsiderohen, në një farë mase, si të papërvetësuar. Është për këtë arsye që, ndërsa në shkollë qëndrohet mbi të rinjtë që s'kuptojnë gjë, do të ishte mirë të shihej ca edhe gjendja e mësuesve.

* * *

Gjer në çastin kur shkollat të shndërrohen, në dorë të mësuesve, në tempuj, është e kotë të presësh të zbrazen burgjet...

* * *

Pasi njeriu të vërë si qëllim për të bërë një punë çfarëdo, në fillim duhet të përpiqet për të mësuar mirë gjërat lidhur me atë subjekt, dhe pasi të formojë besimin e plotë se mund ta bëjë, nuk duhet të lerë gjë mangët në iniciativë.

* * *

Çdo njeri duhet ta dijë mirë profesionin dhe punën e vet dhe, me sa ia lejojnë mundësitë, duhet të mbetet brenda fushës së specialitetit të vet. Sepse, jo gjithkush mund të bëhet i suksesshëm jashtë fushës së vet. Prandaj, mjeku duhet të mbetet mjek, inxhinieri, inxhinier. Mësuesi nuk duhet të bëjë mjekësi, kurse mjeku nuk duhet ta vendosë në vështirësi veten duke thënë “do të bëhem jurist”.

Nderi me gjuhën e urtësisë

Nderi është një brumë i bekuar, i formësuar prej virtytit, besnikërisë dhe fjalës së drejtë. Një brumë i atillë që nuk është parë kurrë ose tepër rrallë, që ndërtesa e ngjizur prej tij, të tronditet a të shembet.

* * *

Nderi është aspekti më i lartë dhe atributi më i rëndësishëm i trimit. Kurse gjendja më e ulët e më e mjerë e trimit është moskokëçarja në çështjen e nderit...

* * *

Aspekti më i vyer i një femre është qenia pa njollë në nder. Është krejt e qartë se njerëzit e pandjeshëm në mbrojtjen e nderit të vet e të familjes, nuk do të jenë të ndjeshëm as në mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit kombëtar!

* * *

Nderi është tjetër, respekti është tjetër. Pasuria mund të bëhet bazë për respekt, por jo për t’u quajtur i ndershëm ose për të fituar nderin e humbur. Kurse varfëria kurrsesi nuk ia pakëson ose zhvlerëson nderin njeriut!

* * *

Nderi është për të gjitha kombet i shenjtë në atë masë që të betohen mbi të, dhe njëkohësisht njëri prej gurëve më të çmuar mes elementeve të virtytit. Nderi dhe virtyti i atij që s’e njeh nderin, janë të falsifikuara e të rreme.

* * *

Nderi është një diamant i pashoq dhe duhet të ruhet në vendet më të veçuara. Kështu, vlera e tij do të rritet edhe një herë më shumë!

* * *

Asgjë nuk mund t’u lihet amanet personave të pandjeshëm, si për mbrojtjen e nderit të vet, ashtu edhe të të tjerëve. Asnjë çështje nuk mund t’u besohet atyre!

* * *

Ashtu si lakuriqët e natës që nuk e duan dritën, edhe të pafetë që nuk e duan fenë, injorantët që nuk e duan diturinë, të pamoralshmit që nuk i duan parimet morale dhe ata që nuk e njohin nderin, nuk e duan atë!

Gënjeshtër në sy të urtësisë

Gënjeshtër është një thënie heretike. Në këtë botë, pasi gënjeshtarit t'ia ketë marrë vesh gënjeshtren ndërgjegjja e përgjithshme, ai dënohet me zhvlerësim, kurse në botën tjetër, me vuajtjen në skëterrë...

* * *

Gënjeshtër është dallkauke, e vërteta, serioze dhe e përplotësuar; gënjeshtër është e lëvizshme dhe e paqëndrueshme, e vërteta, hijerëndë dhe madhështore!

* * *

Vendet ku gënjeshtër, dredhia, mashtrimi, vjedhja dhe shpifja janë të përhapura, janë gërmadhë; populli i vendeve të tilla është i varfër, kurse ushtria, rebele.

* * *

Në çfarëdo rrobe të futet gënjeshtër, nuk mundet ta fshehë veten nga ndërgjegjja e përgjithshme, si dhe kurrë nga shikimi i të virtytshmëve që shohin me dritën e Zotit!

* * *

Në kohët kur gënjeshtër merr hov dhe sheshet dridhen nën buçitjet e saj, gjuha e të vërtetës quhet e belkëputur.

* * *

Ndërgjegjja e përgjithshme i ngjet detit; edhe sikur gënjeshtarët të futen gjer në mes të tij, deti përsëri i mbledh e i hedh në breg.

* * *

Nëse është dikush që pështyn në fytyrë të gënjeshtres, mohimit, keqinterpretimit dhe hipokrizisë dhe që vazhdimisht i bën me turp ato, ajo është ndërgjegjja!

* * *

Gënjeshtarët dhe veprimet për dukje janë të zhurmshme, kurse e vërteta dhe sinqeriteti, të pazë. Rrufetë e arrijnë qëllimin e tyre para bubullimës.

Urtësia dhe virtyti

Virtyti rri, mes njerëzve të thjeshtë, në minder ose ndenjor, kurse krenarinë nuk e nxënë as kolltukë madhështorë! Nëse krenarinë do ta përngjasonim me një gropë me pamje kubeje të kthyer nga ana tjetër, virtytin mund ta përngjasojmë me qiellin të dukur sikur ka zbritur në horizont.

* * *

Injoranca çon në krenari, kurse urtësia, në virtyt. Krenaria është fëmija bastard i injorancës, kurse virtyti, fëmija fisnik i urtësisë. Krenaria është përkrahëse e despotizmit, kurse virtyti, përkrahës i lirisë dhe barazisë.

* * *

Krenaria vërtitet gjithnjë në vetmi duke kërkuar shok, kurse virtyti, mes kënaqësisë se ka gjetur shok, vazhdimisht me popullin rri.

* * *

Thonë se “s’bëhet bukuri me zor”! E drejtë! As i madh s’bëhesh dot me zor. Që të dyja këto, ndërgjegjja e përgjithshme i emëron!

* * *

Ka njerëz të tillë që, sipas tyre, njerëzit që i pëlqejnë, i quajnë mirëdashës, kurse njerëzit që s’i pëlqejnë, keqdashës. Këta i duan të parët e ua hapin prehrin, kurse të dytët i përzënë “shtatë katunde larg”. Në fakt, vetë këta egoistë janë ata që duhen përzënë shtatë katunde larg.

* * *

Mirëdashësi e sheh çdo gjë si të mirë, kurse keqdashësi, çdo gjë si të keqe. Që të dy këta janë të dëmshëm. E mira duhet quajtur e mirë dhe e keqja, e keqe, gjë që është “vërtetësidashje”!

Shtypi në horizontin e urtësisë

Media është interpreti i ndjenjave të popullit, udhërrëfyesi i shtresave të shoqërisë dhe shpërndarësi i ideve. Në qeverisjet e dhunshme e despotike, media ka mbetur gjithmonë ose rob, ose servil!

* * *

Çdo autor duhet të jetë i edukuar në fjalë dhe sjellje, i pastër në gjuhë dhe penë, ndryshe, për hiçgjë, pa diskutim, do të bëhet shkak për dëme...

* * *

Kombet, njerëzit e penës të të cilit nuk shkruajnë dot siç duan mbi ndjenjat dhe mendimet kombëtare, i përngjajnë më shumë “robërisë babilonase”.

* * *

Meqë media është një institucion i hapur për çdo lloj mendimi të qëlluar a të paqëlluar, është e domosdoshme të disiplinohet sipas kombit dhe shpirtit të tij.

* * *

Si gazetat, ashtu edhe televizionet duhet të ruhen jashtëzakonisht nga shërbimi kushtuar dëshirave e pasioneve të personave; ata duhet të kenë për synim vetëm e vetëm orientimin e kombit.

* * *

Sa e sa kafka të braktisura në kalbëzim ka në varreza që, për shkak të dhunës, despotizmit e censurës, i kanë marrë me vete duke i dënuar me asgjësim pa lindur ende librat që nuk kanë mundur të shkruajnë.

Tërheqja ndjesorenga këndvështrimi i urtësisë

Tërheqja ndjesore ndaj gjërave lëndore është trupore e materiale, kurse ndaj gjërave moralo-shpirtërore, shpirtërore e ndërgjegjësore. Kështu, tërheqja dhe dashuria ndaj bukurive të jashtme, meqë ato janë të përkohshme, është e shoqëruar me ndërprerje dhe ndarje, kurse tërheqja dhe dashuria ndaj bukurive moralo-shpirtërore është pa ndarje, e përhershme.

* * *

Në qoftë se në një zemër, dashuria është e vërtetë, armiqësia është simbolike; po qe se armiqësia është e vërtetë, dashuria është simbolike. Një çelës, ky, magjik, që zbërthen shumë gjëra të vështira.

* * *

Kur kënaqësitë e shpresuara shtihen në dorë, vjen vdekja si e shpresës, ashtu edhe e dashurisë për to. Dashuria dhe shpresa janë flatrat e shpirtit dhe kërkues dhe shfaqen tek ta gjatë gjithë kohës së kërkimit.

* * *

Mjekët e përcaktojnë veprimin e sëmundjes me anë të simptomave, kurse i sëmurit, duke e ndjerë dhe vuajtur atë. Po kështu, dashurinë, kush dashuron, tërheqjen, kush tërhiqet, kënaqësitë shpirtërore që përbëjnë diturinë e shpirtit, dijetarët e shpirtit...

... Dhe njeriu u mashtrua!

Nëse do të shkruaja një skenar, fjalët e para të tij do të ishin: “... Dhe njeriu u mashtrua!”

Historia është e mbushur me shembuj mësimdhënës

Është gabim të presësh që ngjarjet historike të përsëriten në trajtë identike. Edhe në pastë ngjasim, çdo ngjarje është e kushtëzuar nga koha dhe mjedisi. Nisur nga kjo, nga historia merret shembull e jo mësim!

* * *

Nuk ka qoftë edhe një gjë të vetme mes gjërave mbi të cilat lind e perëndon dielli, që të mbetet e freskët...

* * *

Nuk ka qoftë edhe një individ të vetëm e një komb të vetëm që të ketë mbetur në majat e përjetësisë...

* * *

Krahas faqeve të këndshme të historisë, njeriu duhet të lexojë pak edhe faqet e frikshme e rrëqethëse të saj në mënyrë që të marrë masat e nevojshme, ndryshe, në mendimet e veta, mund të mbetet gjithmonë femënor!

Gjërat e vogla që bartin mbi supe gjëra të mëdha

Një fije shkrepëse mund t'i vërë zjarrin brenda një çasti e ta bëjë hi brenda një kohe fare të shkurtër një pyll që duhen dhjetëra e qindra vite për ta krijuar...

* * *

Disa herë, një grimcë gjë mund ta shtrijë për tokë një burrë sa një div...

* * *

Druri i stërmadh ka ardhur nga një farëz, njeriu, kjo qenie e jashtëzakonshme, nga një mikroorganizëm, dielli, nga molekulat, deti nga pikat e ujit. Dhe ç'përfundime marramendëse nga shkaqe a pretekste akoma edhe më të imta!..

Mbi kohën

Kur hajet e pijet, pasi i fusim në gojë, ia japim trupit, ndiejmë kënaqësi dhe përfitojmë prej tyre. Kështu është edhe koha: në atë masë që i bëjmë tonat sekondat, minutat, ditët dhe javët, e shijojmë kënaqësinë e saj dhe nuk duam që të na ikë. Ndërsa jeta është një dhunti, me shijimin e të cilës s'kemi të ngopur në atë masë sa t'ia ndiejmë shijen dhe gëzimin, në atë masë sa të na premtojë ca gjëra për të sotmen e të ardhmen, kur jetohet në mënyrë të pavetëdijshme e të paqëllimshme, s'është gjë tjetër veçse një barrë e rëndë mbi supet e njeriut...

* * *

Koha është si telat spiralë të një gjeneratori me ndryshimin që zgjatet gjer në pafundësi. Nuk është një vijë e drejtë dhe as e rrafshët; aty ka ngjitje e zbritje. Trupi i vërtetë i kohës është çasti që jetohet...

Mallkimet

Ashtu siç ndodhen në trupin e njeriut një sërë pikash që paraqesin rëndësi për jetën e tij, edhe në trupin e shoqërisë janë të pranishme veçanti shumë të rëndësishme si besimi, vetëdija historike, kultura kombëtare e ideja kombëtare. Ashtu siç është për individin e paracaktuar dhe e

pashmangshme tronditja dhe shembja nëse njëra nga pikat jetësore në trupin e tij goditet, ashtu edhe për kombet shembja nëse njëra prej këtyre elementëve me rëndësi krejt të veçantë merr plagë e dëmtohet. Një mijë mallkime atyre që luajnë me besimin dhe historinë e kombit! Një mijë mallkime armiqve të së shkuarës! Një mijë mallkime shkatërruesve të idesë dhe kulturës kombëtare! Një mijë mallkime keqndjellësve që e shohin dhe e tregojnë të errët të ardhmen tonë!

Shoku perëndimor

Revolucioni industrial është ngjarja që ka dhënë goditjen e parë në botën islame. Krejt si macja që, pasi e turbullon miun, luan me të, ashtu edhe Perëndimi, pasi e ka shokuar botën islame, ka luajtur e vazhdon të luajë si të dojë me të!

Parajsa

Parajsa s'është vendi as i përparimit, as i regresit. Ajo është klima e zhytjes në kënaqësi...

PJESA E DYTË

NJERIU DHE SJELLJETE TIJ

Njeriu

Njeriu është një qenie e pajisur me ndjenja të larta, e aftë për virtyt dhe e shtënë pas përjetësisë. Edhe në shpirtin e një njeriu në dukje si më i mjeri, madje, është e pranishme një klimë e shumëngjyrtë si ylber e formësuar prej idesë së pavdekësisë, pasionit për të bukurën dhe ndjenjës së virtytit, prandaj edhe lartësimi i tij gjer në arritjen e pavdekësisë varet prej zhvillimit dhe daljes në shesh të këtyre dhuntive në natyrën e tij.

* * *

Njerëzorja te njeriu duhet kërkuar jo në trupin e tij shtazor e të vdekshëm, por në shpirtin e tij të shtënë e të pasionuar pas të përjetshmes. Prandaj ka ndodhur që, kur njeriu është trajtuar vetëm si trup duke iu mohuar ana shpirtërore, assesi nuk ka arritur të ngjitet në pikën e ngopjes dhe kurrë nuk ka mundur të kënaqet.

* * *

Njeriu më fatbardhë e i lumtur është njeriu me ndërgjegjen gjithnjë të dehur me dëshirën dhe ashkun për përtej. Ata që e kalojnë jetën në errësirën e kufizuar, të ngushtë e mbytëse të trupit, edhe nëse ndodhen në saraje, në fakt janë në errësirë...

* * *

Detyra e parë dhe numër një e çdo njeriu është ta zbulojë dhe njohë veten dhe, në saje të këtij zhvillimi cilësor, të orientohet kah Zoti i vet. Fatkeqët që nuk e njohin veten, pra, s'e dinë se ç'janë, për çka edhe nuk munden të krijojnë lidhje me Krijuesin e Lartë, jetojnë si hamallët që bartin, por nuk e dinë se ç'bartin dhe, po ashtu si ata, ikin nga kjo botë pa kuptuar gjë!

* * *

Është e vërtetë se njeriu në vetvete është një qenie e dobët, por është gjithashtu e vërtetë se, në saje të mbështetjes te Fuqia e Pafundme, zotëron një pushtet të jashtëzakonshëm. Sigurisht, është në saje të kësaj mbështetjeje që njeriu është një pikë uji e bëhet përrua, është një molekulë e bëhet diell, është një lypës e bëhet mbret!..

* * *

Në atë masë që njeriu të bëhet i afërt me ekzistencën dhe librin e ndodhive e të njehsohet me to, në atë masë shfaqen në botën e tij të brendshme vezullimet e urtësisë. Për rrjedhojë, ai njeh esencën e vet, arrin aftësinë për ta njohur dhe ndjerë Zotin e, më tej, shkon e bashkohet me Të! Mjafton që kjo ecuri e ky udhëtim që kërkohet të realizohet në planin ideor, të mos jetë i varur nga mohimi dhe ateizmi!

* * *

Njerëzit e vërtetë, aktet e përbashkëta me kafshët, vazhdimin e llojit dhe brezit, i kryejnë dhe plotësojnë me vetëdijen e detyrës dhe brenda kufijve të domosdoshmërisë. Kurse ata që jepen pa masë pas kënaqësive trupore, e ngushtojnë distancën mes tyre e qenieve të tjera dhe i cenojnë kufijtë njerëzorë!

Respekt ndaj njeriut

Kafsha, pasi vdes, harrohet dhe gropa i humbet. Por njeriu s'është kështu... Kombet që nuk i mbrojnë kujtimet dhe varret e etërve, s'e di, a janë të vetëdijshëm se i zbresin ata në nivel të kafshëve? Në të vërtetë, respekti ndaj të vdekurve është një garanci e dhënë të gjallëve për të ardhmen...

Drejtëpeshimimes trupit dhe zemrës

Jeta e vërtetë është jeta e bërë në nivelin ndjesor. Njeriu që ekziston me botën e tij ndjesore, duke i parë të shkuarën e të ardhmen si dy fytyra të një të vetmeje, kthehet e bëhet një qenie mbikohore. Një shpirt i tillë nuk ndrydhet as me dhimbjet e së shkuarës, as me frikërat e së ardhmes. Sa për ata që nuk kanë mundur ta gjejnë dot veten në botën e vet ndjesore, e jetojnë jetën e vet mëngjarashe të kredhur në pesimizëm. Në shikimin e të tillëve, e shkuara është një varrezë e frikshme, kurse e ardhmja, një humnerë që s'i duket fundi. Keq të vdesin e keq të rrojnë...

* * *

Lidhja e njeriut me një të shkuar të gjatë dhe me një të ardhme që s'di të mbarojë, varet vetëm nga njohja e gradës jetësore të shpirtit e zemrës. Shpirtrat fatbardhë që çojnë një jetë në këtë nivel e që e kuptojnë atë, të shkuarën e shohin në formën e çadrave e të froneve të etërve tanë, kurse të ardhmen, në formën e rrugëve që zgjaten për në kopshtet parajsore dhe ikin të lumtur nga vendbanimi i kësaj bote që e lidhën me botën e vet ndjesore. Kurse fatkeqët që nuk munden ta përjetojnë jetën në këto përmasa, jeta që jetojnë u është më e keqe se vdekja, po ashtu edhe vdekja, krejt një skëterrë, errësirë mbi errësira.

* * *

Mes jetës së brendshme dhe sjelljeve e veprimeve të individit ekziston një marrëdhënie reciproke mbështetëse, rregulluese e maturuese. Këtë, si kundërvënie ndaj rrethit vicioz, mund ta emërtojmë "rreth i hapur". Sipas kësaj, ashtu siç do të ndodhë që sjelljet e njeriut si vendosmëria, këmbëngulja, qëndresa, duke u reflektuar në botën e brendshme të tij, ta ndriçojnë atë, do të ndodhë edhe që ndriçimi i ndërgjegjes, duke ia nxitur vendosmërinë dhe vullnetin, t'i tregojnë atij horizonte edhe më të larta...

* * *

Fatmirët, të cilët, me sjelljet e tyre, ndodhen nën urdhrin e shpirtit, marrin udhë gjithmonë drejt pëlqimit të Krijuesit, drejt virtytit dhe njerëzores; busullat e tyre shënojnë gjithmonë të njëjtën pikë orientuese, po ashtu edhe kahjet e lëvizjeve të tyre. Edhe nëse rrallë u ndodh ndonjë shmangie, me një pendesë të sinqertë e me një rënkim të thellë i tresin në shpirt mëkatet që ua rrethojnë zemrën dhe vazhdojnë në rrugën e vet...

* * *

Të lumturit, të cilët i çojnë në vend me një korrektesë të jashtëzakonshme e gjer në hollësitë më të imta të gjitha detyrimet e tyre, krahas rregullit, harmonisë dhe dashurisë për detyrën në botën e tyre të jashtme, e jetojnë edhe botën e tyre të brendshme dhe, duke marrë flatra disa herë në ditë, arrijnë në botën e engjëjve...

* * *

Një botëkuptim i cili duke u zierë dhe ngjizur me shekuj me idenë e pafundësisë, na pati tharmuar në zemra pasionin për pavdekësinë, me kohë ia la vendin prirjes për formula të pashpirt dhe një sofizmi bosh që sillte me vete drogimin e mendjeve. Dje e sot, këto mendime të mbrapshta që i njëvlerësojnë rrezet ndriçuese të zbulesës hyjnore me frymëzimet e tyre sa xixat e xixëllonjave, duke fryrë mjegull e tym në rrugën tonë të ndriçuar, janë duke e errësuar qiellin e njeriut tonë!

* * *

Pas të gjitha këtyre, njeriun e së vërtetës mund ta kornizojmë, sipas nesh, kështu: Për nga aspekti material, ai është një trup i bërë çelik saqë t'i vërë gjoksin çdo lloj fatkeqësie; për nga aspekti ideor, është një kokë konstruktive që e zien dhe e përzien deklaratën hyjnore me botëkuptimin e arritur nga shekulli dhe, ashtu si një kimist mjeshtër, arrin çdo çast në sinteza të reja; për nga aftësitë shpirtërore dhe ndjesore, është një shpirt i fërguar, i pjekur e i formësuar prej shekujsh në potën e Mevlanave e të Junusëve;⁴ më në fund, është një zemër e formuar që i beson filozofisë, “të jesh një njeri mes njerëzish” dhe një flijues, i cili, për hir të lumturisë së të tjerëve, ka harruar kënaqësitë e veta!..

Toleranca dhe mirëkuptimi

Hapja çdokujt zemrën sa mund t'ia hapësh, le të të jetë si oqean! Tërhiq me besim dhe për njeriun dashuri ndje. Të mos mbetet zemër e dëshpëruar që s'u interesove për të e s'ia zgjate dorën!

* * *

Brohoriti të mirët për të mirat dhe ndaj zemrave që kanë besuar, bëhu bujar! Mosbesuesve afroju aq butë, sa neveritë e urrejtjet t'u treten e shkojnë e ti, në frymëmarrjet e tua, gjithmonë bëju Mesih!..

* * *

Në marrëdhëniet me qiejt në më të shumëngjyrëshmen e rrugëve e me më të spikaturën e fjalëve, mos harro se ndodhesh pas Udhërrëfyesit të Lartë!⁵ Mos harro dhe, duke menduar për ata që nuk zotërojnë as edhe njëren prej këtyre veçorive, bëhu i matur!..

* * *

Përgjigjiu të keqes me të mirë, sjelljeve të pahijshme ndaj teje mos i kushto rëndësi! Çdo njeri, me sjelljet e veta reflekton karakterin e vet. Ti zgjidh rrugën e tolerancës e të mirëkuptimit dhe, përballë atyre që s'dinë se ç'është tradita dhe edukata, tregohu bujar!..

* * *

Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim. Kurse urrejtja për çdo njeri është ose lëshim i zemrës djallit, ose një vepër marrëzie. Ti duaje njeriun, mahnitu pas njerëzores!..

* * *

Duhet të ruhesh që qoftë edhe një herë të vetme të mos biesh nën pushtetin e egos sepse, sipas saj, të gjithë njerëzit veç teje janë mëkatarë dhe çdo individ është një i pafat! Dhe kjo, për

⁴ Është fjala për poetët e mëdhenj Mevlana Xhelaledin Rumi (1207-1273) dhe Junus Emre (1240-1321).

⁵ Profeti Muhamed, pqmT.

atë më fjalëdrejtin, do të thotë shkatërrim i personit. Ti ji mjaft i ashpër me egon tënde, kurse me të tjerët, më i buti i të butëve!...

* * *

Tregohu i vëmendshëm ndaj sjelljeve e veprimeve që të bëjnë t'i duash të tjerët e që i tregojnë ata të dashur para syve të tu! Mos harro se të njëjtat gjëra mund të bëhen pretekst që edhe ti të pëlqesh e të duash nga të tjerët. Sillu gjithmonë si njeri dhe i mëshirshëm ji!..

* * *

Duke pranuar si etalon trajtimin që të bën Zoti ty, edhe ti ashtu duhet të sillesh ndaj popullit. Atëherë ke për të qenë bashkë me Zotin mes njerëzve dhe për të shpëtuar nga egërsia e të dy vetmive...

* * *

Se ç'je para Zotit, mund ta vlerësosh me anë të vendit që i ke veçuar Atij në zemrën tënde, kurse se ç'pozitë ke mes popullit, duke e peshuar e matur me qëndrimet e tua. Mos u shkëput nga Zoti qoftë edhe për një çast dhe, mes njerëzve, njëri prej tyre bëhu!..

* * *

Në qoftë se në shpirt të ka zënë vend mirë ideja se njerëzit që besojnë mund të të bëjnë keq, dije se kjo është një mungesë aftësie gjykimi dhe e rrjedhur prej mangësisë së mendjes, prej dobësisë ndaj një egoje si dhe mjerimit shpirtëror! Dhe menjëherë drejtoju një prijësi shpirtëror që do të ta ngrinte zemrën peshë e do të ta përloste syrin!..

* * *

Shkurt, për ta mbrojtur dashurinë dhe konsideratën tënde mes njerëzve, duaj për hir të Zotit, urre për hir të Zotit dhe bëhu një njeri me zemrën të hapur ndaj Tij!..

Thjeshtësia

Njerëzit kokulur arrijnë shpërblime të pasosura si në lartësinë e Zotit, ashtu edhe mes njerëzve. Kurse e kundërta e këtyre, hundëpërpjetët, mendjemëdhenjtë dhe ata që e shohin çdokënd nga lart poshtë, në çdo kohë janë përzënë nga njerëzit dhe janë goditur nga ndëshkimi i Zotit!

* * *

Fakti që njeriu e pëlqen vetveten e mbahet me të madh, është provë e çalimit të mendjes dhe trashësisë së shpirtit. Njeriu që ka arritur pjekurinë e mendjes dhe shpirtit, çdo gjë që ka merituar e di prej Zotit dhe, me ndjenjën e falënderimit, përkulet gjithmonë më dysh para Tij!

* * *

Përballë vlerësimit të Zotit dhe poshtërimin të njerëzve, thjeshtësia i përfton zemrës së njeriut ndjenjën e prehjes dhe qetësisë. Sigurisht, dikush që qysh në krye, duke e ditur se sa vlen, është treguar kokulur, do të thotë se është futur nën mburojën më të sigurt ndaj çdo lloj përbuzjeje e poshtërimi që mund t'i vijë nga njerëzit si dhe ka marrë masën parambrojtëse më të shëndoshë ndaj tyre!

* * *

Thjeshtësia është tregues i pjekurisë dhe vlerës të individit, kurse mbajtja me të madh, i papjekurisë dhe mangësisë së vlerave të individit. Njerëzit më të formuar janë ata që rrinë më shumë mes njerëzve e bëhen gjithmonë me ta, kurse njerëzit më të mangët në vlera janë ca të pafatë me nam të keq të cilët e kanë për turp të rrinë mes njerëzve e t'i ndajnë gëzimet e hidhërimet me ta!

* * *

Ata të cilëve s'u dihet vlera nga shoqëria mes së cilës jetojnë, herët a vonë, në sajë të thjeshtësisë në karakter, lartësohen e arrijnë të fitojnë ndere të mëdha, kurse ata që vuajnë nga kompleksi i të mbajturit me të madh, me kalimin e kohës, lihen mënjane nga populli nga pak e përditë, duke u kthyer në elemente të huaja në mjedisin ku jetojnë!

* * *

Lartësimi i një njeriu në vlerat njerëzore del në dukje me anë të thjeshtësisë tek ai; edhe thjeshtësia vetë del në dukje kur atë nuk munden ta ndryshojnë gjërat që shoqëria u jep vlerë, si posti, detyra, pasuria dhe dituria. Për atë njeri, te i cili njëri prej elementëve të sipërpërmendur arrin të shkaktojë ndryshim në mendime e sjellje, nuk mund të bëhet fjalë as për thjeshtësi, as për lartësim në vlerat njerëzore!

* * *

Thjeshtësia ka vlerën e çelësit të pothuaj gjithë shprehive të mira; kush e shtie në dorë atë, mund të fitojë edhe shprehi të tjera të bukura, kurse kush nuk e ka, për rrjedhojë, mbetet i privuar edhe prej shprehive të tjera. Ndërsa kur Profeti Adem rrëshqiti dhe i humbi të gjitha gjërat me vlerë të trajtimit qiellor, i rifitoi ato me anë të thjeshtësisë, djalli i rënë në të njëjtën fatkeqësi, u bë kurban i krenarisë dhe mendjemadhësisë së vet!

* * *

Për shkak se madhështia është nga atributet e Individualitetit të Lartë, ata që janë mbajtur me të madh, e janë treguar tekanjozë, pothuaj gjithmonë janë përçarë nga dora "Ndëshkuese" e Tij duke u shkatërruar. Kurse ata që e kanë njohur veten se sa vlejnë e janë treguar të thjeshtë, janë lartësuar duke u ngjitur gjer në audiencën e Tij!

Njerëzorja

Duke e pranuar egon e vet si peshore për të gjitha sjelljet dhe qëndrimet e mira apo të këqija të tij ndaj të tjerëve, njeriu duhet ta peshojë çdo gjë me të: të dojë edhe për të tjerët ato gjëra që do për vete dhe kurrë të mos e nxjerrë nga mendja se sjellja apo veprimi që s'i pëlqen për vete, nuk u pëlqen as të tjerëve. Kështu, ai ka shpëtuar edhe nga sjelljet e këqija, edhe nga të bërit keq të tjerëve!

* * *

Duke menduar se të mirat që të janë bërë, ta kanë zbutur zemrën dhe se ndaj personave që të kanë bërë mirë, ndjen dashuri dhe interesim, mund të nxjerrësh si përfundim se edhe të tjerët do të tregojnë dashuri dhe interesim për ty nëse u bën mirë. Thonë se "njeriu është robi i të mirës që i është bërë"; e mira është strehimi më i sigurt ndaj njerëzve për të cilët ti dyshon se duan të të bëjnë keq.

* * *

Pjekuria dhe matura e njeriut del në dukje kur ai nuk heq dorë nga qëndrimi i drejtë edhe ndaj njerëzve prej të cilëve ka parë keq, për më tepër, vazhdon t'u bëjë mirë me ç'i vjen doresh! Sigurisht, njeriu duhet të vazhdojë të sillet njerëzisht dhe bujarisht edhe ndaj njerëzve që i kanë bërë keq, sepse keqbërja është një veprim shtazor; përgjigja ndaj të keqes me të keqe tregon për mangësi serioze të karakterit të njeriu, kurse përgjigja ndaj së keqes me të mirë flet për burrëri dhe dinjitet!

* * *

Në përpjekjet për t'u bërë i dobishëm nuk ka kufi. Njeriu me zell të lartë mund të bëhet altruist gjer aty sa të jetë i gatshëm për ta flijuar edhe jetën për të tjerët. Vetëm se, që kjo lloj burrërie të bëhet për njeriun virtyt, duhet që sinqeriteti, bujaria dhe kthjelltësia e qëllimit të jenë larg fanatizmit racor dhe fisnor të njeriut!

* * *

Njerëzorja dhe bujaria e një personi janë të mundura me anë të afërsisë ndaj miqve e shokëve si dhe me vazhdimësinë e kësaj afërsie. Bërtitja me të madhe për bujari pa treguar afërsi për ta, është një pretendim abstrakt, po kështu, kushtëzimi i të mirave tona ndaj tyre me të mirat e tyre ndaj nesh dhe, aty-këtu, ndëshkimi i tyre duke ua ndërprerë të mirat që jemi duke u bërë, janë shprehje e një vulgariteti shpirtëror dhe e mosnjohjes së të vërtetës...

* * *

Një tjetër prej të mirave të mëdha që mund t'i bëjë një njeri një tjetri, është të bëjë sikur s'ia sheh sjelljet e papërshtatshme e të mbyllë sytë ndaj të metave të tij. Të rrëmosh për të mësuar të metat e tjetrit, është paturpësi, ta përflasësh atë majtas e djathtas, ves i pafalshëm, kurse përplasja syve e të këqijave që ka bërë, një goditje e rëndë mbi zinxhirin vëllazëror në të cilin janë lidhur e jetojnë në unitet individët e një shoqërie. Eh, sikur egot e plagosura nga një goditje e tillë të mund të bashkoheshin sërish për të formuar një unitet!..

* * *

Ata që i quajnë të parëndësishme edhe të mirat më të mëdha që u bëjnë të tjerëve, ndërkaq që edhe të mirat më të parëndësishme që u bëjnë të tjerët, i vlerësojnë lart, janë njerëz të përsosur që kanë arritur në lartësitë e moralit hyjnor si dhe prehje në ndërgjegje. Njerëz të tillë as mburren me të mirat që kanë bërë, as ankohen për mosinteresimin që u bëhet...

Burrëria dhe bujaria veti të larta njerëzore

Trajtimi që ti pret prej njerëzve është trajtimi që presin njerëzit prej teje.

* * *

Të vraposh në ndihmë të të tjerëve është ftesa më shprehëse e ofruar bujarisë së Zotit!

* * *

Nuk duhet të mungosh ta gëzosh tët vëlla qoftë edhe me një buzëqeshje!

* * *

T'i duash njerëzit dhe t'i bësh ta ndiejnë se i do, është gjysma e mençurisë.

* * *

Vendi yt mes njerëzve është sa vendi i tyre tek ti!

* * *

Ata që vazhdimisht thërrasin e bërtasin përreth, në kundërshtim me dëshirën e vet, i humbin miqtë e i gëzojnë armiqtë!

* * *

Ai që fut hundët në çdo vend, kurrë nuk shpëton dot nga dyshimi i rënë mbi të!

* * *

Mos harro se gjërat që do të të lënë të kënaqur ty, do ta lënë të kënaqur edhe botën!

* * *

Njeriu i mençur është ai që di ta përdorë për llogari të vet edhe fuqinë e mjedisit të vet. Kurse të patrutë e të pasuksesshmit, jo vetëm që s'e përdorin, por duke sulmuar lart e poshtë, e kthejnë këtë fuqi kundër vetes!

* * *

Fqinjësi i tregohet fqinjit...

* * *

Provoje një herë me të mirë personin nga e keqja e të cilit ke frikë.

* * *

Fal kur duhet të ndëshkosh në mënyrë që falja të fitojë vlerë!

* * *

Kurrë mos harro se ke edhe shumë vëllezër që s'janë ulur në prehrin e nënës tënde!

* * *

Përrjashtuar ata që binden pa kushte, tipat fanatikë thyejnë e copëtojnë çdo gjë që u zë dora.

* * *

Aftësinë për t'i lënë të gjithë të kënaqur, nuk e ka çdo trim.

* * *

Rruga për të parë mirë kalon nga vendi ku bëhet mirë...

* * *

Marazi e lë njeriun pa sy, pa veshë e pa zemër.

* * *

Mirë a keq, ç'u kemi bërë të tjerëve, janë farërat e gjërave që kanë për të na dalë nesër përpara.

* * *

Në pasqyrën e shpirtit, pranë të mirave janë vendosur edhe të këqijat radhë-radhë.

* * *

Njeriu ideal digjet si qiri për t'u bërë dritë të tjerëve...

* * *

Edhe nëse gjuha e gjatë dhe dora e shkurtër i ka hije gjarprit, njeriut jo, se bëhet gjarpër.

* * *

Vlera e faljes është në raport të drejtë me pushtetin dhe mundësinë për të ndëshkuar.

Mëkati dhe pastrimi

Nëse mëkati është një shformim në krijim, pendimi dhe pendesa janë rikthim në origjinalin e krijimit.

* * *

Mëkati që ka lënë ndryshk në zemër, është si një virus që i ka rënë në qafë trupit; herët a vonë do ta tregojë veten.

* * *

Të mos mendosh për vdekjen, ndodh ngaqë zemra është e ndryshkur, kurse frika prej vdekjes, nga varfëria e dijes...

* * *

Keqpandehma është ose sëmundje trush, ose ndyrësi zemre. Shpëtimi prej saj është te vetëdijshmëria e njeriut për mëkatet e veta.

* * *

Nga gropa ku kemi rënë për shkak të nënvleftësimit të gjërave, mund të dalim vetëm duke i vënë në vend ato që kemi nënvleftësuar.

* * *

Nëse shtëpinë e ke prej kristali, mos i hidh gurë as qymezit të tjetrit, madje!

* * *

Kush merret me turpet e të tjerëve, gjithë jetën vetëm turpe bën...

* * *

Thonë se “s’ka trim që të mos ketë rënë prej kali e s’ka kalë që të mos ketë zënë në thumb!” Puna është që, pasi të jesh rrëzuar, të dish të ngrihesh e të vish sërish në vete!

* * *

Mendimi “e bëj nesër” është një shprehje tjetër e mungesës së vullnetit.

* * *

Mëkatet më të mëdha janë ato që hedhin shtat e zhvillohen në korijen e epshit. Pushteti mbi epshin është pushteti më i madh.

* * *

Nënvleftësimi i mëkatit është mëkati më i madh...

* * *

Nëse pema s'është tharë, e ndjen pranverën...

* * *

Kur sheh se Zoti nuk të ndëshkoi, mos merr krahë; mendo se të ka dhënë afat dhe rrëqethu!

* * *

Besimtar i vërtetë është ai që mban lidhje çdo çast me Zotin. Mëkatet janë shkëndija të dëmshme që e këpusin këtë lidhje...

E fshehta dhe ruajtja e saj

E fshehta është si një burim force e papërbalueshme e si një ushtri e pamposhtshme.

* * *

E fshehta është nder; ai që e mbron të fshehtë, qoftë ajo e vetja, qoftë e dikujt tjetër, ka mbrojtur nderin. Kurse ai që e nxjerr në shesh, do të thotë se i ka lënë zbuluar nderin dhe dinjitetin, duke mos treguar konsideratën e duhur për to!

* * *

Ka punë të tilla ku e fshehta i përngjet Hizrit⁶: ka vlerë kur mbetet e padukshme.

* * *

Edhe heshtja është urtësi, por të urtët e saj janë të paktë a mund të thuhet se nuk ka.

* * *

Personi të cilit dikush do t'ia besojë, do t'ia lërë amanet të fshehtë, duhet të jetë i besueshëm e i sigurt sa për t'ia lënë amanet edhe nderin dhe në mbrojtjen e të fshehtës, duhet të jetë aq pedant sa në mbrojtjen e nderit të vet. Amaneti nuk i duhet besuar atij që s'është i besueshëm e i sigurt, po ashtu edhe e fshehta nuk i duhet dhënë atij që s'njeh të fshehtë e nder!

* * *

Kush e burgos gjuhën, shpëton nga robëria e fjalëve të veta.

* * *

Mbajtja e të fshehtës dhe respektimi i të fshehtës së të tjerëve është një virtyt njerëzor i lidhur krejtësisht me vullnetin dhe njohjen. Ashtu siç nuk pritet që njerëzit e pavullnetshëm ta mbajnë të fshehtë, po ashtu nuk mund të mendohet që njerëzit naivë, të tillë që të mos jenë në gjendje ta parashikojnë përfundimin e punëve që bëjnë dhe fjalëve që flasin, të jenë gojëmbyllur...

* * *

Fakti që një njeri i beson sërish një të fshehtë dikujt që gjer atë ditë ia ka nxjerrë në shesh disa herë të fshehtë e besuar, tregon tek ai mungesë vullneti dhe paaftësi për të zgjedhur shok. Një

⁶ Hizri: Një ndër njerëzit e bekuar që sipas besimit islam ka gjasa të ketë qenë Profet. Njihet si simbol i mirësisë dhe i ndihmesës.

njeri që, në sajë të besimit, i janë hapur sytë dhe zemra i ka zënë vend, nuk duhet të gënjehet, nuk duhet të mashtrohet kaq shumë!

* * *

Njeriu duhet të ruhet jashtëzakonisht nga përhapja e të fshehtave të veta andej-këtej, sidomos nëse këto do të jenë gjëra të shëmtuara, të padëshiruara e si rezultat, të padobishme... Ndërsa do t'i turpërojë miqtë, kjo mund të bëhet shkak për lindjen e situatave të pakëndshme që do t'i gëzonin armiqtë...

* * *

Gjokset janë krijuar si nga një arkë e vogël për të fshehtat. Mendja është dryni i tyre, kurse vullneti, çelësi. Për sa kohë që në këtë dry dhe çelës të mos ketë prishje, askush s'ka mundësi të zbulojë se ç'fshihet në arkë...

* * *

Ai që bart të fshehtat e tjetrit për tek ti, mund t'i bartë edhe të fshehtat e tua për te tjetri. Prandaj kurrësi nuk duhet t'u japim rast njerëzve të tillë të njohin qoftë edhe gjërat tona personale më të parëndësishme!..

* * *

Zemra e kokëtrashit është në majë të gjuhës, kurse gjuha e të mençurit, në skajin më të fshehtë të zemrës...

* * *

Duhet ruajtur nga shoqërimi me kokëtrashët. Më e keqja është se, jo vetëm mund të kenë qëllime të këqija, por, edhe në s'paçin të tilla, mund të bëjnë keq pa qëllim...

* * *

Ka të fshehta që kanë të bëjnë me individin, ka të fshehta që kanë të bëjnë me familjen, por ka edhe të fshehta që kanë të bëjnë dhe prekin një shoqëri e një komb të tërë... Me zbulimin e të fshehtës së individit, i jepet rast vënies në lojë të dinjitetit të individit, me zbulimin e të fshehtës që i përket familjes, vënies në lojë të dinjitetit të familjes, kurse me nxjerrjen në shesh të të fshehtës që i intereson shoqërisë e kombit, vihet në lojë dinjiteti i shoqërisë e i kombit, sepse, ndërsa e fshehta është një forcë për sa kohë mbetet e tillë dhe në dorë të atij që i përket, kur zbulohet, kthehet në një armë të rrezikshme që mund të përdoret kundër të zot. Prandaj dhe të parët tanë kanë thënë: "E fshehta është robi yt, por, po e zbulove, ti bëhesh robi i saj!"

* * *

Është një parim që shumë punë me vlerë të madhe kërkojnë mbajtjen e të fshehtës; kur ka ndodhur që ata që i kanë pasur në dorë këto punë, nuk e kanë mbajtur të fshehtë, nuk ka qenë e mundur të hidhet qoftë edhe një hap përpara, madje, iniciativat janë rrezikuar seriozisht. Kjo gjë merr rëndësi dhe përmasa krejt të veçanta kur është fjala për çështje delikate që kanë lidhje me jetën dhe të ardhmen e një kombi!..

* * *

Nëse një shtet u ka lëshuar të fshehtat e shtetit armiqve, nëse një ushtri ia ka zbuluar strategjinë e lëvizjes forcave armike, nëse një afarist është zbuluar nga konkurrentët, s'ka më mundësi që ai shtet ta rimbledhë veten, që ajo ushtri të fitojë dhe që ai afarist të dalë me sukses...

E keqja e gjuhës

Të folurit e shumë është një sëmundje që shërben si provë e çekuilibrit mendor e shpirtëror. Fjalë e përshtatshme është ajo që, me rrugën më të shkurtër, i tregon diçka bashkëbiseduesit pa ia trazuar kokën. Për t'i treguar ca gjëra bashkëbiseduesit, nuk është nevoja të flasësh gjerë e gjatë, madje, e folura e gjatë shpesh sjell me vete një sërë dëmsh sepse krijon mundësi për kontradikta që nxjerrin në shesh pyetje të reja gjë që, për bashkëbiseduesin, përbën dëm e jo dobi!

* * *

Njeri i mençur është ai që, në vend që të flasë vetë, vë të flasin persona që do të ishin të dobishëm si për vete, ashtu edhe për të tjerët. Në fakt, fjala e dikujt tjetër në vend të personave, mendja e të cilëve është e mbushur dhe pjekur me shkencat e natyrës, kurse zemra, me kulturën hyjnore, është mungesë respekti dhe dëm për shoqërinë që i përkasin.

* * *

Të flasësh pak e të dëgjosh shumë është virtyt dhe shenjë lartësimi shpirtëror, kurse dëshira e vazhdueshme për t'u dëgjuar, edhe nëse s'quhet çdo radhë marrëzi, nuk ka dyshim se është çekuilibër absolut e paturpësi!

* * *

Çdo fjalë që do të thuhet, duhet të jetë e tillë që të sqarojë ndonjë çështje dhe t'i japë përgjigje ndonjë pyetjeje. Dhe, duke folur, duhet ruajtur me çdo kusht nga shkaktimi i mërzitjes si tek pyetësi, ashtu edhe tek dëgjuesit.

* * *

Është normale dhe e natyrshme që njeriu duhet të heshtë atje ku s'duhet të flasë dhe duhet të hapë gojën atje ku duhet të flasë. Ndërkaq, çdo herë duhet të parapëlqehet fjala e personave me më tepër përfitim. Dhe kjo, para së gjithash, është një çështje edukate dhe varet nga njohja e vlerës së heshtjes. Sa bukur kanë thënë etërit tanë: "Fjala është argjend, heshtja është flori!"

* * *

Njeriu e rrit vlerën e vet jo duke thënë shumë fjalë, por kur fjalët që thotë, janë me vend e me vlerë. Në të kundërt, personi që flet mbarë e prapë e kudo, sidomos nëse tema e bisedës ka të bëjë me koncepte të larta e që kërkon kompetencë, bie në shumë gabime dhe e rrëzon edhe vlerën e vet. Sa me vend është fjala që thotë se "ai që flet shumë, bën shumë gabime!"

* * *

Me fjalët që thotë, njeriu e tregon veten dhe me sjelljet reflekton lartësinë e shpirtit. Llafazanët që nuk ia lënë fjalën askujt tjetër sikur të ishte e nevojshme që çdo fjalë duhet ta thoshin ata vetë, me kohë nisin të ndjejnë neverinë dhe përbuzjen e të gjithë miqve. Dhe një situatë e tillë bën që të mos u vihet veshi fjalëve të bukura që herë-herë do t'u takojë atyre t'i thonë, për rrjedhojë, të nënvleftësohen të vërtetat e larta pikërisht pse i tha një llafazan, gjë që do të thotë mungesë respekti për ato të vërteta të larta.

* * *

Ashtu si e ngrëna e paktë dhe e fjetura e paktë, edhe e folura e paktë është bërë që në krye të herës tipar i njerëzve të pjekur. Porosia e parë e dhënë njeriut për zhvillimin e aftësive shpirtërore është sundimi i gjuhës dhe ruajtja prej fjalëve të pavend e të panevojshme. Kështu, gjuha e atyre që

kudo që të ndodhen, e hapin gojën e flasin mbarë e prapë, e cila u është më e madhe se koka dhe zemra, do të bëhet vazhdimisht shkak për humbje edhe këtu, edhe në botën tjetër...

* * *

Sidomos puna e atyre që thonë gjëra që s'i kanë bërë, është krejt e hidhur dhe të vë në mendime...

* * *

Njeriu bëhet i afërt e i dashur për Krijuesin dhe krijesat në atë masë sa të qëndrojnë larg sëmundjes së të folurit të shumtë, të pëlqimit të fjalës së vet dhe mosnjohjes të tjerëve të së drejtës së fjalës. Në të kundërt, nuk e gjen dot atë që shpreson as te Zoti e as te njerëzit!..

Premtimi

Është më mirë të premtosh një herë e ta çosh në vend, se sa të premtosh një mijë herë e mos të bësh asgjë!

* * *

Qëndrimi në fjalën e dhënë është domosdoshmëri e qenies njeri dhe e njohjes së vlerave njerëzore!

* * *

Ndjeshmëria për ta çuar në vend premtimin buron nga besimi, mosmbajtja e premtimit buron prej dyfytërsisë!

* * *

Një pjesë njerëzish gjatë gjithë jetës përpiqen për ta çuar në vend marrëveshjen e nënshkruar në zemra, kurse një pjesë tjetër jetojnë pa ditur gjë për një marrëveshje të tillë. Ja, në këtë pikë ndahen besimtari nga hipokriti!

* * *

Mos thuaj, “premtoi, por nuk e çoi në vend premtimin”! Mendo ato që u premtuan e s'u çuan në vend. Mos dëno kënd duke thënë se s'u tregua njeri! Kujto rastet që ti vetë i le të të ikin për t'u treguar njeri!

Kujdesi dhe matura

Edhe sikur të të ngjisin qiejve, mos harro se toka është më e sigurt. Kush bie nga avioni, copëtohet, kurse ai që i ka këmbët në tokë, mbetet ashtu siç është!

* * *

Kurrë nuk duhet të heqim dorë prej maturisë sepse nga ajo lindin mendime të shëndosha. Në të kundërt, hapen plagë që mbyllen me vështirësi dhe krijohen të thyera që duan shumë kohë e

mund për t' u ngjitur. Sjellja e përshtatshme pasi të bëhet e keqja, as mundet t' i mbyllë ato plagë, as mund t' i ngjisë ato thyerje...

Mirë - më mirë

Jeta është një dhunti hyjnore; dhunti më e madhe se jeta, është ta jetosh atë pa borxhe!

* * *

Njeriu më fatlum është ai me mëkatet më jetëshkurtra. Kurse më fatlum se ai është njeriu që mundet të jetë gjithmonë i mbyllur ndaj mëkateve.

* * *

Ka njeri që e gdhend kohën për llogari të vet; ka njeri që sa është gjallë, koha rri dhe e gdhend...

* * *

Brenga më e madhe që e shumëfishon pleqërinë brenda pleqërisë, është shqetësimi i pleqërisë...

* * *

Është mirë të mbash qëndrim ndaj errësirës, por më mirë është që, në vend që ta shash errësirën, të ndezësh një pishtar qoftë edhe të vogël për ta ndriçuar atë.

* * *

E mira e paktë por e vazhdueshme është më e begatshme se e mira e shumtë që ndërpritet herë pas here.

* * *

Një hap në profilaksi është më i dobishëm se njëqind hapa në mjekim.

* * *

Një dele e gjallë që jep qumësht është më e dobishme se një mijë dele të therura.

* * *

Nderi dhe respekti burojnë nga tipari muhamedan i myslimanit.

* * *

Trumcaku në dorë është më i mirë se pëllumbi në erë.

Sjellja dhe veprimi

Besimi fetar konkretizohet me veprim.

* * *

Gjërat që bën, besimtari i bën me mendimin se i nënshtrohen kontrollit të Allahut.

* * *

Shiu ndodhet në ajrin me re, kurse sjelljet e mira, në zemrat e lidhura pas Allahut!

* * *

Çdo gjë mund të vihet nën kontroll, por karakteri, vështirë...

* * *

Është turp për njeriun e moshuar që të pijë gjë, por edhe prerja prej gjirit, e vështirë.

* * *

Nxehja e njeriut që nuk nxehet kurrë, është e veçantë...

* * *

Ashtu si hija e shkopit të shtrembër nuk do të jetë e drejtë, ashtu edhe sjelljet e dikujt që nuk e ka balancuar mirë peshoren e zemrës, nuk mund të jenë të drejta.

* * *

Nëse njerëzit të kanë dhënë ty një vend sipas sjelljeve të tua, është e kotë të presësh një trajtim tjetër prej tyre pa e ndryshuar veten.

* * *

Nuk ka gjë më të ëmbël se kënaqësia, më të hidhur se nevojtaria ndaj të tjerëve dhe më të rëndë se besimi kur kushtet nuk e lejojnë.

* * *

Fjala pa punë, miqësia pa besë dhe jeta pa kënaqësi s'janë tjetër veçse nga një gënjeshtër më vete.

* * *

Afrohuni e shkrihuni me njëri-tjetrin si të dashurit, por në punë e veprime silluni sipas parimit të të qenit të huaj.

* * *

Lëre, mos fol ti për veten tënde, të flasin punët dhe sjelljet e tua për ty!..

Tërësia e ndjenjave të larta

Ata që tregojnë armiqësi të hapët ndaj nderit, janë të poshtër, kurse armiqësi të fshehtë, janë injorantë që nuk kanë turp prej Zotit dhe që s'e njohin veten. Në të vërtetë, ata që s'kanë ndjenjë nderi, s'kanë as ndjenjë kombi e atdheu.

Dhuntia dhe vetëdija e dhuntisë

Ka dhunti të panumërta të Zotit për njerëzit; më e madhja prej tyre është dhuntia për të qenë i vetëdijshëm për ekzistencën e këtyre dhuntive...

* * *

Shëndeti është një dhunti atlas në shpinë të njerëzve të shëndoshë, e tillë që vetëm të sëmurët ia dinë vlerën...

* * *

Dhuntia më e madhe e Zotit për njerëzit është besimi, kurse falënderimi i kësaj dhuntie të madhe është moskundërshtimi i Tij!..

* * *

Përgjigjja për çdo dhunti duke falënderuar me të njëjtën monedhë, është shprehje e dashurisë për vlerën!..

* * *

Jetesa në shumë raste e injorantit në mirëqenie e lumturi, kurse e të diturit dhe e të urtit në varfëri tregon se dhuntitë vijnë në botë jo sipas vlerës së personit...

* * *

Është e rëndësishme të dihet jo çmimi i gjësë, por vlera e saj...

* * *

Bamirësitë e Allahut janë në masën e madhësisë së Vet, kurse kërkesa për falenderim, sipas vendit të atij që i është bërë bamirësia.

* * *

Dhuntia që e largon njeriun nga Allahu, është fatkeqësia më e madhe!

Altruizmi

Kontributi i secilit është sipas vlerës së vendit që ka. Ai që mendon vetëm veten, ose s'është njeri, ose është një krijesë e metë. Rruga që shkon te njerëzorja e vërtetë, kalon nëpër mendimin për të tjerët gjëra të mohimi i vetes për ta nëse paraqitet e nevojshme!

* * *

Njeriu duhet të jetë përballë turpeve të veta hetues, kurse përballë të metave të të tjerëve, avokatmbrojtës i tyre.

* * *

Njeri i pjekur dhe mik i vërtetë është ai që si në të dalë nga ferri, ashtu edhe në të hyrë në parajsë, di të të lëshojë rrugë duke të thënë: "Urdhëro, kalo!"

* * *

Njeriu i vërtetë, pavarësisht nga kushtet, duke mjelë e mbushur kovën e vet, nuk i le zbrazët as kovat e të tjerëve...

* * *

Ti hidh farën e shko, kush të korrë, le të korrë!..

Besimi monoteist dhe dashuria për Allahun

Kur dikush thotë diçka, nuk do të shihni kah ai që flet, por kah ai që e bën të flasë dhe do të thoni: “Atë Allahu e bëri të flasë!” Kjo mënyrë të menduari është edhe e pagabuar, edhe e parrezikshme.

* * *

Ai që e kërkon nga Allahu atë që kërkon, kurrë s’mbetet pa gjë!..

* * *

Ai që mbështetet te Allahu, është gjithmonë i gjallë; edhe po të vdesë, meqë është mbështetur te Ai dhe e ka përcaktuar veten të Atij, quhet se jeton...

* * *

Më e bukura e dashurisë për Allahun është ajo e rrethuar nga njëra anë me respektin, nga ana tjetër, me frikën ndaj Tij!

* * *

Ç’fitim i madh për ne që Allahu na ka dhënë mundësi ta duam!..

* * *

Është e provuar një mijë herë se kur është thënë “qëllimi arrihet me këto e këto forca”, pa kaluar shumë, ato forca janë përmbysur e shkatërruar! Ajo që na takon neve, është të shtrëngojmë dhëmbët e të punojmë duke u mbështetur tek Allahu, duke e pasur Atë si dorëzanës!

* * *

Edhe nëse ti nuk e prek me dorë atë që me siguri ka për t’u ndëshkuar e shkatërruar, kur t’i vijë koha, Fuqia e Zotit e çon të drejtën në vend!

Pishtari i errësirës

Namazi i pasmesnatës, tehexhudi, është si një pishtar në duar të njeriut përballë errësirës së gjatë të natës. Në fakt, edhe secili prej namazeve të pesë kohëve është kah ndriçon një pikë të errësirës së njeriut, kah u lëshon dritë fragmenteve të caktuara të kohës. Po të mos jetë namazi, njeriu nuk mundet të ecë në vijën e fesë dhe nuk mund të bëhet i drejtë. Kur Profeti nuk e pati falur në kohë namazin e pasmesnatës, e pati plotësuar ditën. Me këtë, gjithsesi, pati dashur të na jepte mësim që të mos lemë zbrazëti në jetën tonë...

Bota e brendshme

Çdo mendim që na hyn në shpirt dhe lëshon rrënjë atje, herët a vonë e jep frytin e tij. Ky fryt mund të jetë edhe i ëmbël, parajzor, edhe helmues, skëterror... Zemra e një njeriu, në trutë e të cilit ndodhen embrionet e së mirës, së bukurës, mirëkuptimit e faljes, gjithmonë të kujton kopshtet e parajsës. Dhe kurrë nuk mund të mendohet që një njeri i tillë të ngrihet papritmas për të vjedhur e grabitur, për t'u përfshirë në imoralitete a për të vrarë, për të pirë alkool a drogë. Për të gjitha këto sjellje e veprime të këqija është kusht që në trutë e tij të ndodhen që më parë disa ide apo plane të këqija. Ndërkaq, gjërat e bëra nga njeriu, trutë e të cilit janë plot me ide të këqija e destruktive, janë krejtësisht reflektime të botës së tij të brendshme. Prandaj ndodh që çdo individ, kur ende s'ka arritur të vendosë në botën e tij të brendshme rregullin dhe orientimin, kurrsesi nuk mund të bëhet i bukur, nuk mund të duket i bukur në pamjen e tij të jashtme; edhe nëse duket, pa diskutim që kjo është kalimtare dhe pa diskutim që nuk mund të vazhdojë gjatë...

Mendimi për mirë

Njëra prej rrugëve më të rëndësishme që çojnë në ngadhënjimin e zemrës së njerëzve, është vazhdimisht ruajtja e rastit për t'u bërë mirë atyre dhe, sapo të jepet një rast i tillë, bërja e së mirës pa humbur kohë. Eh, sikur t'i akordonim zemrat sipas mendimit për të bërë gjithmonë mirë!..

Shoqëria dhe miqësia

Ai që i çmon shokët e miqtë duke i pritur e gostitur, fiton mbrojtës kundër armiqve dhe njerëz që kanë për t'i dalë për zot...

* * *

Nevoja e njeriut për shok besnik nuk është e dorës së dytë, si dhe më e parëndësishme se nevojat e tjera. Individit që ndodhet në prehje e siguri lidhur me shokët e miqtë, quhet se ndihet i sigurt edhe në shumë anë të tjera.

* * *

Njeri i mençur është njeriu që, kur i prishen marrëdhëniet me mjedisin, di ta fshijë shpejt e shpejt pakënaqësinë e krijuar me ta dhe ta rinojë miqësinë. Kurse më i mençuri se ky është njeriu që, duke u treguar i kujdesshëm e i vëmendshëm, kurrë nuk i prish marrëdhëniet me miqtë...

* * *

Ashtu siç ka armiq të fshehtë, ka edhe miq të fshehtë. Miku i fshehtë ose, më saktë, ai që s'do të duket, e quan hipokrizi të flasë për veten e ta tregojë me fjalë miqësinë. Atëherë duhet të themi se, ashtu siç bëjmë përpjekje për t'i njohur armiqtë, duhet të bëjmë edhe për të kërkuar miq, sepse miqtë e gjetur pa i kërkuar mund të mos jenë aq të sigurt sa mund të shpresohet...

* * *

Vazhdimësia e dashurisë dhe interesimit mes shokësh varet nga mirëkuptimi dhe ndjenja e gatishmërisë për sakrificë që do të tregojnë ndaj njëri-tjetrit në rrugë legale dhe punë të

pëlqyeshme. Miqësia e personave, të cilët në mendime, sjellje e veprime nuk tregohen vetëmohues ndaj njëri-tjetrit, është e shkurtër dhe kalimtare...

* * *

Besnikëria e një njeriu ndaj miqve është në po atë masë që të ndiejë në vetvete dhimbjet dhe kënaqësitë e tyre. Miku që nuk qan kur i qajnë miqtë e nuk qesh kur i qeshin miqtë, nuk mund të quhet mik besnik...

* * *

Miqësia dhe vëllazëria e vërtetë mes miqsh e vëllezërish del në pah në atë masë sa të jetë në gjendje ta vazhdojë marrëdhënien mes tyre edhe në ditë të vështira për ta. Ai që nuk ndodhet pranë miqve e vëllezërve në ditë të vështira e çaste rreziku, s'është mik, s'është vëlla!

* * *

Mik i vërtetë është ai që të zgjat dorën kur sheh se je duke u rrëzuar, jo ai që të tund kokën me miratim për çdo gjë...

* * *

Ata që herë pas here kapen e grinden me mjedisin, i kanë të paktë miqtë. Ai që dëshiron edhe të ketë shumë miq, edhe t'i ketë të besës, duhet të ruhet shumë nga debatet e panevojshme me ta...

* * *

Nëse ti e mban veten të çmuar, edhe të tjerët të mbajnë të tillë...

* * *

Miqësia është, para së gjithash, një çështje zemre. Ata që kanë pandehur se do ta fitojnë miqësinë me gënjeshtër e hipokrizi, gjithmonë kanë mbetur të gënjyer. Edhe nëse përreth tyre mblidhen përkohësisht katër a pesë naivë të gënjyer nga ca grimasa, nuk mund të ketë mundësi që këta ta shtynjë gjatë miqësinë e tyre!

Njerëz të shtrenjtë

Mes njerëzve, ashtu siç ka njerëz të lirë që mund të blihen fare lirë, ka edhe njerëz të shtrenjtë që nuk mund të blihen as me arin e tërë botës! Pikërisht këta janë njerëzit që i lartësojnë kombet. Njerëzit e shtrenjtë, ashtu si retë e ngarkuara me shi, janë të ngarkuar me ideale e virtyte të larta. Të njihen a të mos njihen, ku shkel këmba e tyre, mbin bar e lind jetë...

* * *

Omer Muhtari⁷ u thotë italianëve: "Unë po vdes, por do të ekzistoj pa fund, kurse ju, bashkë me vdekjen, do të merrni fund!" Myslimani e shet jetën shtrenjtë, e jep jetën e vdekshme dhe merr jetën e pavdekshme. Shëndeti që na mban lidhur ne pas kësaj bote, është si bukuria dhe freskia e fletës së trëndafilut. Fleta e trëndafilut është shumë tërheqëse kur është e gjallë, e freskët dhe e shëndetshme, por, kur vyshket, s'i mbetet asnjë vlerë!..

⁷ Heroi kombëtar i Libisë në luftën kundër italianëve.

Kapitali më i madh

Morali dhe ndërgjegjja, edukata dhe delikatesa janë si një monedhë që shkon në çdo vend dhe si një margaritar, vlera e të cilit nuk preket nga lëkundja e kursit të monedhës. Ai që i fiton ato, u ngjethet tregtarëve me kredi të lartë që, edhe sikur të mos kenë kapital tjetër, mund të bëjnë tregti në çdo vend!

Vdekshmëri

Tiktaket e zemrës janë mërmërimë e melodisë së vdekjes filluar me lindjen...

* * *

Pothuaj çdo njeri e di se kiameti është afër. Mirëpo sa vetë ka që t'i bien në të se ai shpërthen çdo ditë e nga pak?..

* * *

Po që se të rinjtë do ta parashikonin qysh më parë se sa të pavlerë do të bëheshin pasi t'u kalonte rinia dhe bukuria, gjithsesi do të kërkonin pa pushim rrugët e rinisë dhe bukurisë së përjetshme...

* * *

Ka shumë gjëra që njeriu u jep vlerë, të cilat vdesin e shkojnë së bashku me të, kurse idetë dhe veprat e dobishme të tij mbeten të gjalla edhe pasi ai vetë të varroset dhe jetojnë gjer në pafundësi...

Të qash e të qeshësh

Të qarët është përpjekja e shpirtit të ndjeshëm për t'u qetësuar si dhe akti i shuarjes me lot të zjarrit që digjet në ndërgjegje. Por ç'e do se shumica e njerëzve qeshin kur është për të qarë dhe qajnë kur është për të qeshur...

* * *

Kur shpirti merr flakë, ndërgjegjja nis të digjet dhe pikërisht atë kohë njeriu qan. Atëherë vijnë në ndihmë lotët dhe e shuajnë flakën e shpirtit. Sipas meje, lidhja mes fjalëve qeshm dhe qeshme prej këtu vjen...⁸

Mbi frikën dhe shpresën

⁸Këto dy fjalë persishte do të thonë, respektivisht, sy dhe burim uji.

Frika nga njerëzit e paralizon njeriun, kurse vështrimi lypsar në duar të njerëzve për të pritur diçka prej tyre, shpesh bëhet shkak për shuarjen e ëndrrave për jetën dhe humbjen e shpresës. Shpëtimi i vetëm nga frika prej njerëzve është frika ndaj Atij i cili duhet pasur frikë dhe rruga për të mos rënë kurrë në pesimizëm është mbështetja tek Ai që është gjithmonë i fuqishëm e i aftë për ta çuar në vend premtimin!

Dy ditë për çdokënd

Kemi besimin se për çdo njeri ka dy ditë: e para, dita e vet e çdo njeriu; e dyta, dita e brezave që do të vijjnë... Edhe nëse ne mund të qajmë për të sotmen, duke i besuar favorit të të Gjithëmëshirshmit, kemi shpresë se në ditën tjetër kemi për të qeshur...

Spektri i të qarit e i të qeshurit

Një shpirt që, me përparimin e moshës, nuk bëhet njësh me idenë e të qenit rob i Zotit, bie në fatkeqësinë e humbjes atje ku pret të fitojë... Po qe se do t'i binte dot në të kësaj, do të qante për çka sot po qesh dhe do të përthyej më dysh prej pendimit...

Ai me jetën të begatë

Më jetëgjatët nuk janë ata që jetojnë më gjatë, por ata që, duke u përpjekur, dinë të marrin më shumë prodhime nga jeta e vet. Sipas këtij kriteri, ashtu siç do të ketë njëqindvjeçarë jetëshkurtër, do të ketë edhe pesëmbëdhjetëvjeçarë që, me prodhimet e marra qysh në atë moshë -prodhime që njeriut të zakonshëm do t'i duheshin mijëra vite për t'i siguruar- u ka arritur kryet në qiej...

Jeta e vërtetë

Jeta është, në fëmijëri, një bulëzim dhe hare, në rini, tensionim metafizik dhe shpirt përpjekjeje e lufte, në pleqëri, emërtimi i të mbeturit gjallë me dëshirën për t'u takuar me miqtë. Por sa e hidhur është që syri mohues e pa jetën herë një komedi e, herë një tragjedi dhe e vrau mendimin e kënaqësisë dhe falënderimit të njeriut!..

Vetmi

Ndjenja e vetmisë është vuajtja e pashërim e njerëzve të mjerë e të paqëndrueshëm që nuk e kanë rregulluar zemrën sipas të përjetshmes, që nuk e kanë tharmuar mendimin e të përjetshmes në shpirt. Është e qartë se këta, gjersa ndjenjat t'u marrin hov me besimin, gjersa shpirtrat t'u shohin fytyrën e vërtetë të qenies, as do të mund të shpëtojnë nga atmosfera e mjegullt e pesimizmit, as do të mund të bashkëjetojnë me të gjithë qenien duke u bërë shok e mik me gjithçka!..

Thellësi

Struktura ndjesore te njeriu zhvillohet në përpjesëtim të drejtë me jetën që jetohej, me brengat dhe ankthet që përjetohej. Botët ndjesore të njerëzve që s'e kanë vrarë mendjen, që s'kanë ndjerë brengë e ankth, pra edhe që kanë mbetur gjithmonë jashtë jetës, ashtu si edhe aftësitë e tjera, kurrësi nuk u zhvillohen dhe ata kurrë nuk mund të bashkohen e të bëhen një me qenien...

E keqe

Edhe sikur atyre që bëjnë keq, askush të mos u bëjë gjë, është e pashmangshme që një ditë pa tjetër të kapen nga vetë e keqja e vet. Sigurisht, rruga e të këqijave që zgjatet e shkon, herët a vonë do të soset duke përfunduar në humnerën e asgjësimit!..

* * *

Të këqijat aksidentale, edhe nëse duken të vazhdueshme, janë të përkohshme. Kur t'u mbushet jetëgjatësia e natyrshme, edhe ato, si gjërat e tjera, vdesin e shkojnë. Ç'e do se, disa herë, na i rrëmbejnë edhe vlerat tona njerëzore...

Ca sëmundje zemre

Besimtar i vërtetë është ai që, në të njëjtën kohë, është edhe zotërues i një morali të lartë. Në adhurimin e tij nuk ka gjë për dukje, në punët e tij nuk ka gënjeshtër dhe në zemrën e tij nuk ka maraz dhe dyfytyrësi! Veprimi për dukje e largon njeriun nga Zoti, kurse gënjeshtria, edhe nga Zoti, edhe nga njerëzit. Marazi bëhet shkak që ai të kujtohet me urrejtje, kurse dyfytyrësia, me mallkim...

Pangopësia

Pangopësia është një ndjenjë rrëmbyese që e bën njeriun t'i duket luani mi. Kush bie në dorë të saj, nuk ka më shpëtim...

* * *

Pangopësia është një demon që i vë me shpatulla për tokë edhe trimat më të vështirë!..

* * *

Ai që s'vuan nga pangopësia, me kalimin e kohës bëhet njëri prej atyre me të cilin njerëzit s'kanë të ngopur...

* * *

Zilia te ziliqarët, pangopësia te të pangopurit është një skëterrë e përshtatur kësaj bote...

* * *

Pangopësia është një kular robërie në zverk të njeriut...

* * *

Nevoja është si një turjelë që shpon ndjenjën e turpit; pa le po ta shtyjë edhe pangopësia...

* * *

Njeriu jep shpirt në krahët e gjësë pas së cilës është i pasionuar...

Zhgënjim

Në kërkim të një Mehlika Sulltanës⁹, drejt sa e sa të panjohurave hapëm velat! Megjithatë, as Lejlën, pas dashurisë për të cilën ramë shkretëtirave, nuk e gjetëm, as në brigjet prej të cilëve u larguam, nuk mundëm të kthehemi...

* * *

Sapo një shoqëri të largohet nga rrënja shpirtërore e vet, këndvështrimi i ndryshon, po ashtu dhe konkluzionet mbi vlerat i përmbysen krejtësisht. Në një shoqëri të tillë, luftës për vetëmbrojtje i jepet nami i dhunës, dhunës, nami i drejtësisë, mbi historinë vërshojnë mallkime, shëmtitë e ditës ngrihen në qiell, edukata përbuzet, paturpësia duartrokitet, pafytyrësia konsiderohet e natyrshme; ndërsa besnikëria ndaj kombit dhe së kaluarës nxihen në mënyrën më të ulët, ideja e mohimit të së kaluarës, pra, e kombit pa histori dhe përkrahësit e saj pothuaj ngrihen në qiell!..

* * *

Dobësia për të qenë vazhdimisht bashkë me gjininë tjetër është ose dëmtim natyre ose shenjë e bartjes së karakterit të asaj gjinie.

Injoranca

⁹ Mehlika Sulltana, figurë mitologjike e letërsisë antike të Lindjes.

Injoranca është si një perçe e lëshuar mbi fytyrë të materies. Fatkeqët që nuk arrijnë ta largojnë këtë perçe nga fytyra, kurrë nuk mund t'i njohin të vërtetat e larta të gjithësisë. Injoranca më e madhe është të mos e njohësh Zotin dhe, kur kjo të bashkohet me egoizmin, kthehet në një lloj marrëzie më në fund të pamjekueshme.

Fytyra e vërtetë e kësaj bote

Disa e quajnë këtë botë ca para e ca kënaqësi. Edhe nëse kjo është e drejtë për ata që, duke e mbështetur çdo gjë te materia, e vlerësojnë botën siç e shohin e siç e dinë, në sy të njerëzve të mendimit, të aftë për ta rrokur të vërtetën, s'është gjë tjetër veçse vetëmashtrim.

* * *

Ata që sot përpiqen ta prishin botën, duken edhe më të shumtë, edhe më të pushtetshëm se ata që e ruajnë rregullsinë e saj. Po të mos jetë një fuqi shpirtërore që do të ndikonte mbi ekuilibrin e forcave, është e vështirë që, me gjendjen e sotme, të thuash se do të arrihet diçka për të mirë.

Shpirtrat mëkatarë

Shpesh njeriu i sheh të tjerët me dylbinë e ndjesive të veta dhe, për shkak të turbullirave në to, gjithkënd e gjithçka i sheh turbull. Për rrjedhojë, vendimet e marra prej tij në këto kushte, janë krejt të errëta e të pamëshirshme. Ç'është e drejta, egoisti i rënë në këtë situatë, e pandeh gjithçka përreth të shkatërruar, por është ai vetë që është shkatërruar.

Çiliminjtë

Duke e quajtur konsideratën e të mëdhenjve për ne, nevojën tonë dhe shenjë të madhërisë së tyre e, pastaj, duke i shfrytëzuar edukatën dhe respektin tonë si pretekst të vazhdimësisë së asaj konsiderate, duhet të ruhem nga sjelljet e padenja në mënyrë që të mos biem në pozitë rrugaçërie. Mjerë për ata që, si të ishin çiliminj tekanjozë, e shpërdorojnë konsideratën e të tjerëve për ta!..

PJESA E TRETË

ÇËSHTJE MORALE, ETIKE DHE SHOQËRORE

Kombi

Nëse individët të cilët kanë vendosur të jenë nga një shtyllë e mirë për kombin e vet, janë të singertë në këtë gjë, duhet t'i harrojnë interesat e veta ndërkohë që edhe interesin më të vogël që ka të bëjë me kombin, nuk duhet ta nxjerrin nga mendja qoftë edhe për një çast!

* * *

Kombi me nivel më të lartë është kombi që, duke i menduar të gjitha punët në unitet, i jep peshë vështirimit të shumicës. Natyrisht, është shumë e rëndësishme që individët e atij kombi, në veçanti të tilla jetësore si feja, gjuha, vetëdija historike, të kenë marrë të njëjtën edukatë!

* * *

Gjëja që do të na kënaqë më shumë, duhet të jenë kritikrat e ardhura nga njerëzit që duam, dhe për dashurinë e të cilëve jemi të sigurt. Në të kundërt, ashtu siç do të ndodhë që, si pasojë e disa të metave tona, të humbim shumë miq, nuk do të dimë edhe t'i rregullojmë shumë prej të metave e dobësive tona!

* * *

Njëra prej veçantive më të rëndësishme që na ka dobësuar ne, si komb, është naiviteti ynë ndaj hileqarëve me fytyrë miku që na kanë rrethuar gjithandej. Kurse njeriu s'duhet mashtruar nga çdo premtim, s'duhet t'i besojë çdo udhërrëfyesi.

* * *

Nëse mes individëve të një kombi vjen puna që dredhia, gënjeshtria dhe mashtrimi të quhen zgjuarsisë, do të thotë se atë komb e ka zënë një sëmundje, tashmë, e pashërueshme. Ndërkaq, gjërat që në një trup të tillë duken si shenja përmirësimi, s'janë veçse një vetëmashtrim sikurse pandehja se majmja e gungave në një trup që e ka zënë veremi, është shërim.

* * *

Në qoftë se mes të gjithë individëve të një kombi ka një lidhje si të ishte familjare, në saje të kësaj lidhjeje fati, pa diskutim, do të spërkatë ujë në rrugën e atij kombi drejt majave. Kurse kombet, individët e të cilëve nuk e duan njëri-tjetrin, të cilët punojnë kundër njëri-tjetrit e, që, për pasojë, nuk ndejnë besim dhe siguri te njëri-tjetri, jo vetëm që s'janë kombe në kuptimin e vërtetë të fjalës, por dhe as që bëhet fjalë të kenë të ardhme!

I riu

I riu është fidani i forcës dhe zgjuarsisë. Po që se edukohet e mësohet, mund të bëhet një Anté, një fuqi që u premtim zemrave ndriçim, e botës harmoni.

* * *

Shoqëria është një enë kristali, kurse të rinjtë, brenda saj si një lëng që merr formën dhe ngjyrën e enës dhe me atë duket. S'e di, apostujt e rregullit dhe harmonisë, të cilët u bëjnë thirrje atyre për përlulje dhe bindje, a janë në gjendje të kthehen e të hedhin një vështrim mbi veten e vet?

* * *

Dëshirat u përngjajnë të ngrënave të ëmbla, kurse virtytet, të ngrënave pak të tharta a të kripura. Po qe se i riu lihet i lirë të zgjedhë, a është e nevojshme të thuhet se cilat do t'i zgjedhë e cilat do t'i lërë? Kurse ne jemi të detyruar t'i përgatisim ata si miq të virtytit e si armiq të imoralitetit dhe fëlliqësisë...

* * *

Gjer në çastin kur t'i shkohet në ndihmë me anë të edukimit, i riu është satelit i dëshirave dhe kënaqësive boshe të mjedisit ku është rritur, një i marrë e i përgjakur që përsillet diku shumë larg personalitetit dhe logjikës. Edukata e mirë që, duke e lidhur atë me të kaluarën e vet, do ta përgatisë për të ardhmen, do ta shndërrojë atë në një hero të perspektivës!..

* * *

Lartësimi ose rënia poshtë e një kombi varen nga shpirti dhe vetëdija me të cilat do të pajisen brezat e tij, nga arsimi dhe edukata që do të marrin. Në kundërshtim me faktin që kombet me brezat e rinj të përgatitur mirë, janë të paracaktuar të përparojnë paprerë, regresi i kombeve që i nënvleftësojnë ata, është i pashmangshëm!..

* * *

Ata që kërkojnë të jenë orakujt e së ardhmes së një kombi, po t'i hedhin sytë edukatës së dhënë të rinjve, kanë për të qenë qindpërqind të saktë në parashikimin e tyre.

Rinia

Qasja me dhembshuri ndaj brezave të rinj është një hap me kuptim i hedhur në rrugën tonë për t'i dalë për zot kombit e vendit. Ndërkaq, nëse kjo ndjenjë dhembshurie bëhet e dobishme me aq sa t'i orientojë ata kah jeta shpirtërore; kur shërben për t'i nxitur për një jetë materiale, i shndërron në qenie thjesht fizike, madje i hibridizon ata!

* * *

Çdo komb që u ka dhënë vlerë brezave të rinj, është lartësuar, kurse kombet që i kanë braktisur të rinjtë në rrjedhën e dëshirave rinore, e kanë paguar shumë rëndë pasojën e këtij nënvleftësimi. Nëse mjedisi ynë sot vlon nga poshtërsia dhe brezat e rinj tërbohen çdo ditë e më shumë, kjo është krejtësisht rezultat i nënvleftësimit tonë! Sigurisht, ndërsa kryet na shëtisnin në qiej, nuk i ndjemë dot kobrat që po na kalonin nëpër këmbë, duke u zgjatur gjer në odat tona të gjumit, dhe të sotmen tonë të hidhur me duart tona e përgatitëm...

Martesa dhe foleja familjare

Martesa nuk është për kënaqësi e dëfrim. Martesa bëhet për të ndërtuar familjen, për të siguruar vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit, për t'i shpëtuar nga hallakatja mendimet dhe ndjenjat e individit, për t'i marrë nën kontroll dëshirat trupore. Ndërkaq, ashtu si edhe në shumë çështje të tjera të krijimit, dëshirat dhe kënaqësitë fizike janë një përparësi dhe element nxitës.

* * *

Personat që do të martohen, nuk duhet të vendosin sipas veshjes e mbathjes së njëri-tjetrit, madje as sipas pasurisë dhe bukurisë; në këtë çështje tepër serioze, duhet të vendosin sipas bukurisë shpirtërore, kuptimit të moralit dhe nderit, virtytit dhe lartësisë së karakterit.

* * *

Për ata që, duke u martuar, nuk kanë bërë dot analizën e nevojshme ose nuk kanë gjetur rastin për ta bërë, kur të vijë puna në prag të ndarjes, nuk kanë për t'u vlejtur as dhe kriteret më të mençura. Sigurisht, çështja nuk është të shpëtohet foleja familjare nga zjarri me sa më pak dëme; e rëndësishme është të mos futen në familje elementet me rrezik zjarri!

* * *

Nuk duhet t'u japim vajzë njerëzve që s'i njohim dhe nuk duhet të kërkojmë vajza që s'i njohim. Marrëveshja e bërë bazuar mbi të panjohura të tilla, ose finalizohet me një rezultat si ndarja që Allahu s'e pëlqen, ose bëhet për palët shkak torturash për gjithë jetën!

* * *

Ka fole familjare të bekuara, të ngritura mbi logjikën dhe gjykimin duke u mbështetur qysh në hapat e para te Zoti, që funksionojnë gjatë gjithë jetës si një shkollë, dhe me nxënësit që përgatisin, sigurojnë vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit që i përkasin!

* * *

Martestat e bëra për martesë pa u menduar e peshuar dhe bashkëjetesat e këtij lloji janë finalizuar me bashkëshortë që qajnë e zvarriten nëpër rrugë, me jetimë të braktisur në jetimore e me kriminelë që i plagosin familjet në zemër.

* * *

Nëse interesi dhe dobia e martesës për individin është një, interesat dhe dobitë e saj për kombin janë të shumta. Nisur nga kjo, si martesë e prishur, ashtu dhe ndenja pa u martuar fare janë një kolerë që i turpëron djemtë, i zhyt vajzat në mjerim dhe kombit i shkakton hemorragji.

* * *

Foleja familjare e themeluar qysh në krye mbi parime të shëndosha e ku sundon lumturia materiale-shpirtërore, është guri themelor më i shëndoshë i ekzistencës si komb dhe një shkollë e bekuar ku përgatiten individë të virtytshëm e të vlefshëm. Kombet që i bëjnë shtëpitë të begatshme sa dhe shkollat, dhe shkollat të ngrohta sa dhe shtëpitë, konsiderohet se kanë realizuar reformën më të madhe dhe kanë vënë nën garanci qetësinë dhe lumturinë e brezave të ardhshëm.

* * *

Kombi formohet prej pjesëtarëve të një familjeje. Kështu, nëse shtëpitë janë mirë, edhe kombi është mirë; nëse shtëpitë janë keq, edhe kombi është keq! Sikur ata që kërkojnë paqen e kombit, të përpiqeshin së pari për paqen e familjeve!

* * *

Shtëpisë i thuhet "shtëpi" sipas njerëzve që rrinë atje. Pjesëtarët e një shtëpie quhen të lumtur me aq sa ndajnë mes tyre vlera njerëzore. Po, mund të themi se njeriu rron si njeri në saje të shtëpisë; edhe shtëpia bëhet "shtëpi" kur ka brenda njerëz!

* * *

Familja është një komb i vogël, kurse kombi, një familje e madhe. Një person që ka mundur të arrijë me sukses ta qeverisë një familje të madhe a të vogël si dhe t'i ngrejë pjesëtarët e saj në nivele të larta njerëzore, mund të bëhet i suksesshëm me pak përpjekje edhe në organizime më të mëdha.

* * *

Çrregullimi dhe shpërbërja në një shtëpi tregon çorientimin dhe shkatërrimin shpirtëror të pjesëtarëve të asaj shtëpie; fëlliqësia, parregullsia dhe çrregullimi i shtëpive, dyqaneve dhe rrugëve të një vendbanimi, gjithashtu, është tregues i nivelit kulturor dhe të interesimit për punën e kuadrit të pushtetit vendor.

Divorci

Divorci është veprimi i largimit të individit nga kushtet e kurorës martesore. Edhe nëse ndarja mund të duket rrallë si qetësuese, shumë herë sjell me vete shqetësim dhe mjerim...

* * *

Sipas fesë, divorci është më e papëlqyera e akteve të lejuara. Ç'e do se aq sa lejueshmëria, edhe pengimi i saj janë të panatyrshëm e jonormalë!

* * *

Nënvleftësimi i domosdoshmërive që kërkojnë divorcin, buron nga mosnjohja e natyrës njerëzore dhe veçantive të kësaj. Të presësh që çdo çift që martohet, të arrijë një përputhje të plotë mes vedi, do të thotë të besosh në mënyrë naive se të gjithë njerëzit janë njëlloj, të një kallëpi, të një natyre, të një ndërtimi dhe karakteri...

* * *

Çdo divorc për qejf, e pajustificueshme, është për atë që kërkon të ndahet, një burim pendimi, për atë që detyrohet të divorcohet, një padrejtësi si dhe për pjesëtarët e familjes që shkatërrohet, një burim shqetësimi të tillë që disa herë, dhimbja e saj, si ajo e një plage që kullon gjak, vazhdon gjatë gjithë jetës...

* * *

Nëse divorci është një ndërhyrje kirurgjikale mbi një gjymtyrë të sëmurë, vazhdimësia e martesës në një linjë logjike e racionale lidhur me kushte të shëndosha, është një ndjeshmëri higjienike. Prandaj, para se të vritet familja me anë të divorcit si dhe ndërgjegjja me anë të ndalimit të divorcit, martesa duhet të trajtohet me kujdesin dhe harmoninë e ëndjes dhe nuk duhen bërë lëshime në kushtet që e sigurojnë këtë harmoni!

* * *

Për shumë shekuj me radhë, një botë u përpoq t'i mbante bashkë ata që s'dëshironin të bashkëjetonin, duke penguar divorcin ose duke vënë kushte të paretizueshme. Kurse një botë tjetër e pa femrën si një plaçkë, si një send që mund ta merrte kur të donte e ta hidhte kur të donte. E para s'qe tjetër veçse shprehje mundimi e ndëshkimi mbi mashkullin, kurse tjetra, shprehje e trajtimit çnjerëzor të femrës.

Prindërit

Prindërit janë të parat qenie që duhet t'i respektojë njeriu. Kush e le mangët respektin për ta, quhet se ka kundërshtuar Zotin. Kush i trajton keq ata, herët a vonë ka për t'iu nënshtruar vetë trajtimit të keq...

* * *

Nga dita kur njeriu fillon të ekzistojë si një qenie ende e vogël, zhvillohet vazhdimisht si një barrë në supet e prindërve. Lidhur me këtë, është krejt e pamundur të përcaktohet e vlerësohet thellësia e dhembshurisë qoftë e nënës, qoftë e babait ndaj fëmijës, si dhe kufiri i shqetësimeve që heqin ata. Nisur nga kjo, respekti për ta është jo vetëm një detyrim njerëzor, por edhe një detyrë që duhet kryer.

* * *

Ata që, duke e ditur vlerën e prindërve, i konsiderojnë ata si pretekst për të fituar mëshirën e Zotit, janë ndër më fatlumët si në këtë botë, ashtu edhe përtej. Kurse ata që duke ua përbuzur qenien, tregojnë bezdi ndaj jetës së tyre, janë ca fatkeqë të paracaktuar për t'u hequr zvarrë, pastaj, në këtë botë e përtej...

* * *

Njeriu quhet se e respekton Zotin po aq sa i respekton edhe prindërit. Kush s'ka respekt për ta, s'ka respekt as për Zotin. Sa çudi që, në ditët tona, tregohen krejt të parespektueshëm ndaj prindërve jo vetëm ata që s'kanë respekt për Zotin, por edhe ata që pretendojnë se e duan Atë!

* * *

Fëmija duhet të jetë jashtëzakonisht i respektueshëm e i bindur ndaj prindërve; edhe prindërit, duke i dhënë jetës shpirtërore të fëmijës po aq rëndësi sa edhe trupit dhe shëndetit të tij, duhet t'ia dorëzojnë atë sa më parë edukimit të të urtëve më të aftë. Ç'injorantë janë prindërit që e harrojnë shpirtin e fëmijës e ç'i pafat fëmija që shkon viktimë e një miopie të tillë!

* * *

Biri që i mohon të drejtat e prindërve e që ngre krye kundër tyre, është një lugat me fytyrë njeriu, kurse prindërit që s'bëjnë përpjekje për ta garantuar jetën shpirtërore të fëmijës së vet, janë ca mizorë të pamëshirshëm. Pa le ata prindër që, edhe pasi fëmija ta ketë gjetur vetë rrugën e vet e të ketë hapur krahët për fluturim, e paralizojnë...

* * *

Familja është elementi themelor i shoqërisë. Sa të respektohet të jenë pjesëtarët e familjes ndaj të drejtave dhe detyrave të njëri-tjetrit, aq e shëndoshë është shoqëria. Ndryshe, është e kotë t'i kërkosh në shoqëri dhembshurinë e respektin e humbur në familje.

Fëmija

Ç'vlerë të ketë fara për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të një peme, po atë vlerë ka edhe fëmija për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të njeriut. Kombet, që i lenë pas dore fëmijët, janë të dënuar të

shemben, kurse kombet që i braktisin ata në duar të huaja e në ndikimin e kulturave të huaja, janë të dënuar të humbin origjinën!..

* * *

Brezi që e përbën pjesën më aktive e më produktive të një kombi në çdo tridhjetë-dyzet vjet, janë fëmijët sot. Ata që i shohin fëmijët si të vegjël e të pavlerë, duhet ta kuptojnë dhe të rrëqethen se sa me mendjelehtësi e morën një element të rëndësishëm në jetën e një kombi!

* * *

Përgjegjësit e të keqes që duket në brezat e sotëm, paaftësinë e vëzhguar në një pjesë administratorësh dhe shqetësimeve të hequra si komb, janë elementët sundues të tridhjetë vjetëve më parë. Edhe fatkeqësitë apo vlerat e një çerek shekulli më vonë do t'u përkasin atyre që e kanë në dorë arsimimin dhe edukimin e brezave të sotëm.

* * *

Çdo komb që kërkon ta marrë nën garanci të ardhmen e vet, duhet t'i shpenzojë një pjesë mundësish, sa energjitë dhe koha që ka për të shpenzuar majtas e djathtas, për përgatitjen e fëmijëve, njerëzve të mëdhenj të së nesërme. Ndërsa një pjesë e madhe e gjërave të shpenzuara do të shkojë kot, gjërat e shpenzuara në drejtim të lartësimi njerëzor të brezave të rinj, do të ekzistojë përherë si një burim i pashtershëm të ardhurash.

* * *

Mjeranët, ngatërrestarët, sarhoshët, anarkistët, të droguarit, morfinomanët, të cilët konsiderohen sot si fytyra e zezë e shoqërisë, janë fëmijët, edukimin e të cilëve e lamë pas dore dje. S'e di, a jemi vënë të mendojmë ndonjëherë se ç'lloj njerëzish do të na i mbushin rrugët nesër si pasojë e indiferentizmit tonë të sotëm?

* * *

Fatin e të nesërme do ta kenë në dorë jo kombet që zotërojnë epërsinë e teknikës dhe teknologjisë, por kombet që e marrin seriozisht institucionin e martesës e që dinë se si t'i lartësojnë brezat e rinj në cilësitë njerëzore. Kombet që nuk e trajtojnë seriozisht çështjen e martesës dhe lindjes, që nuk u dalin për zot brezave të rinj me filozofinë e vet të edukimit, në mos sot, nesër, janë të dënuar të bluhën e shkrijnë mes dhëmbëve të pamëshirshëm të kohës.

Të drejtat e fëmijës

Duke u krijuar, njeriu është krijuar së bashku me shokun e jetës. Mund të thuhet se s'ka periudhë kur njeriu të ketë mbetur i vetëm. Kështu, krijimi i njeriut qysh në të parë së bashku me bashkëshortin/bashkëshorten e vet tregon se martesë për njeriun është e natyrshme, kurse qëllimi më i rëndësishëm në këtë karakteristikë është shumëzimi. Për rrjedhojë, martesë e bërë pa pasur si qëllim rritjen e brezave të rinj, është një dëfrim dhe aventurë, kurse fëmijët e lindur eventualisht nga një martesë e tillë, janë ca të pafat, viktimë të një çasti sentimental...

* * *

Brezi njerëzor vazhdon përsëri vetëm me njeriun, me njeriun me zemër dhe shpirt të ngritur në nivel njerëzor... Brezat e paedukuar, me aftësitë shpirtërore të pazhvilluara, për rrjedhojë, të

palartësuar në nivele njerëzore, edhe po të jenë vetë të bijtë e Ademit, madje, s'janë veçse ca krijesa të çuditshme, hibride njerëzore, kurse si nënë e baba, ca fatkeqë që rrisin në gji lugetër...

* * *

Nëse prindërit kanë të drejtë të thonë për fëmijët e vet, "bijtë tanë" me aq sa t'i kenë rritur e edukuar të virtytshëm, kurrësi s'kanë të drejtë të pretendojnë prindësi nëse i kanë lënë pas dore! Pa le sikur t'i kenë shtyrë ata në rrugë të këqija e të shëmtuara duke i larguar nga njerëzorja...

* * *

Vazhdimësia dhe pavdekshmëria e një kombi është e qenë me breza të përgatitur mirë, me breza me qenien kombëtare e me shpirtin kombëtar të përsosur... Nëse kombet nuk përgatisin një brez të mrekullueshëm për t'ia lënë amanet të ardhmen, do të thotë se perspektiva e tyre është e errët. Është jashtë çdo dyshimi se detyra e parë për përgatitjen e brezave të rinj, prindërve u bie!

* * *

Në qoftë se prindërit u dalin për zot fëmijëve dhe ua zhvillojnë mendimet dhe ndjenjat në një mënyrë që të bëhen të dobishëm edhe për vete edhe për shoqërinë, i përftojnë shoqërisë një shtyllë të re e të shëndoshë. Në të kundërt, nëse i kanë nënvleftësuar ata përsa u përket ndjenjave njerëzore, quhet se kanë lëshuar brejtës në gji të shoqërisë.

* * *

Kur një pemë krasitet e i bëhen shërbimet e duhura, po kështu, edhe kur një kafshë mirëtrajtohet, edhe fryte japin, edhe brezin e vazhdojnë. Në të kundërt, pema s'jep më, kafsha bëhet parazite. Po njeriu i dërguar në këtë botë me një mijë e një dhunti e mundësi? Mos vallë s'duhet kujdesur për të as dhe sa për një pemë?

* * *

O njeri, ti je ai që e sjell fëmijën në botë! Gjithashtu është detyra jote ta lartësosh atë përtej qiejve! Ashtu siç i jep rëndësi shëndetit të tij dhe dridhesh mbi të me dhembshuri e dashuri, ashtu dhe dridhu mbi të për shëndetin e tij shpirtëror, ki mëshirë për të, mos lejo të shkojë kot, për hir të Zotit, shpëtoje atë!

Morali dhe etika

Të jesh i ditur është tjetër, të jesh njeri, tjetër! Duke hyrë me diturinë e vet nën urdhrin e njerëzimit, dijetari shpëton nga hamallëku i kujtesës dhe arrin të bëhet një njeri i lartë në atë masë që, me moralin dhe virtytshmërinë e vet, ta përfaqësojë diturinë e vet. Në të kundërt, s'ka ndonjë ndryshim prej një të mjeri që e ka çuar jetën kot. Fundja, vetëm morali dhe virtyti janë ato që e bëjnë inorancën-hekur të çmuar e të dobishëm si floriri!..

* * *

Edhe sikur të të kenë gënjer, ti kurrë mos gënje njeri! Veçanërisht kurrë mos u ndaj nga besnikëria dhe orientimi i drejtë që janë një virtyt i lartë, edhe nëse, disa herë, mund të të shkaktojnë humbje!..

* * *

Në ditët tona, morali, më në fund, nuk kuptohet, ashtu siç e kuptonin të parët, një tërësi virtutesh. Njeriu i ditëve të sotme kërkon ta kuptojë atë më shumë në formën e etikës dhe edukatës shoqërore. Eh, sikur ta shihnim moralin të çdo njeri qoftë edhe në këtë formë!..

* * *

Morali përmban një sërë parimesh të larta lidhur me sjelljet e njeriut, të cilat, që të gjitha, burojnë prej nivelit të lartë shpirtëror. Duke u mbështetur në këtë mund të themi se personat që nuk kanë siguruar afrinë e duhur me shpirtin e vet, është mjaft e vështirë t'i përfaqësojnë rregullat morale për një kohë të gjatë...

* * *

Më parë thuhej se “morali mbeti në libra”. Tani, se “mbeti në librat e vjetër!” Edhe kështu në qoftë, sado “të reja” të flijohen për këtë gjë që kërkohet të vjetrohet, e vlen!..

* * *

Flijimi i interesit tënd për interesin e tjetrit është shpirtmadhësi dhe trimëri! Ata që bëjnë për herë punë të mira e të dobishme pa pritur ndonjë interes si shpërblim, kur të përballen papritmas me të gjitha veprat e mira e të dobishme që kanë kryer, do të derdhin buzëqeshje me habi dhe mahnitje mbi fatin e vet!..

Virtyti

Kërko për shpirtin që do të të jetojë gjer në pafundësi, gjithmonë ndere të reja, funksione e poste të reja! Dhe për të mos i humbur nderet e fituara, mbaje gishtin për herë në këmbëz!..

* * *

Nëse në një shoqëri nuk qëndrohet mbi rritjen dhe zhvillimin e shëmtive, po qe se bukuritë dhe të bukurit ndiqen si të ishin hajdutë, po qe se dashuruesit e të vërtetës dhe virtytit fyhen e shtypen dhe nëse imoraliteti mundet të hyjë ku të dojë, për ata që jetojnë për nder e virtyt, në atë vend, është më mirë nën dhé sesa mbi dhé!

* * *

“Virtyt” janë quajtur sjelljet që njerëzit i miratojnë por që kafshëve s’u pëlqejnë, kurse “fëlliqësi”, sjelljet që i bëjnë njerëzit të rrëqethen e të largohen prej tyre, por që kafshët i kryejnë si zakonisht sepse s’preken prej tyre dhe kështu është!

* * *

Dashuria dhe intimiteti i thellë që ndjehen për koncepte të tilla të larta si fe, komb, atdhe, nder dhe shtet, është punë e shpirttrave trima e bujarë. Ata nuk i shkelin këto koncepte dhe as lejojnë të shkelen; po të duhet, e flijojnë jetën për ta me gjithë dëshirë. Kurse fatkeqët të privuar nga një cilësi e tillë shpirtërore, i thonë kësaj “marrëzi”!?

* * *

Edhe nëse virtyti mund të shkaktojë dëm në disa raste e kushte të caktuara, prapë virtyt mbetet. Vështrimi i virtytit si gjë e pavlerë dhe pendimi për të, janë gjithmonë padrejtësi. Dëmet e shkaktuara për shkak të virtytit, prapë me virtyt duhet përpjekur të mënjanojnë!

* * *

Virtyti është situata shpirtërore e mosdhënies rëndësi respektit të merituar, kurse krenaria, pritja e respektit edhe atje ku s'është merituar. Kur flet virtyti, krenaria strehohet në gji të egoizmit dhe rri e dëgjon tërë ankth.

* * *

Përmendja për të mirë e të parëve është një e drejtë e tyre, kurse për ne, shprehje e njohjes së vlerës. Sepse ata qenë si nga një rrënjë më vete që i përfatuan kombit fisnikëri. Përpjekja për t'i hedhur poshtë ata do të thotë shkaktim të kombi i pështirosjes për të kaluarën e shquar për ta larguar prej saj.

* * *

Ata që e vërtetojnë famën e merituar të të parëve dhe i kujtojnë ata me respekt, s'ka aspak dyshim se një ditë do të përmenden edhe vetë me respekt. Kurse ata që duan t'u dalë emri duke e kritikuar dhe rrëzuar famën e të parëve, fitojnë për vete një famë mjaft të keqe.

* * *

Njohja e vetes është zgjuarsia, kurse vështrimi i vetes, verbëri! Kush e njeh veten, bëhet i afërt edhe për Zotin, edhe për njerëzit, kurse ai që e vështron veten, duke u larguar prej gjithkujt e gjithçkaje, mbetet i afërt vetëm me egon e vet!

* * *

Vlerësimi i gabimeve të së kaluarës dhe përfitimi prej tyre si dhe falja në një farë mase e njerëzve të së kaluarës duke mos u marrë me ta, është një qëndrim me mend, kurse nxirja pa vend e pa qenë nevoja e së kaluarës dhe e njerëzve të saj është mendjetrashësi!

Edukata

Tek ne është një fjalë e urtë që thotë: "Nëse fëmija është i çmuar, edukimi i tij është më i çmuar!" Sa me vend!

* * *

Në edukimin e fëmijës prindërit duhet të sillen si njeriu me pehriz, andaj duhet ta respektojnë shumë masën në edukim!

* * *

Nëse themi që periudha më e theksuar e gjendjes së nënvetëdijshe të fëmijëve është mosha 0-5 vjeç, çdo gjë që mund të bëhet në këtë moshë për t'u dhënë fëmijëve shembuj të mirë, është e vyer.

* * *

E ardhmja e çdo njeriu është e lidhur tepër ngushtë me ndikimet dhe mbresat e periudhave të fëmijërisë dhe rinisë. Po që se fëmijët dhe të rinjtë rriten në një klimë ku t'u zhvillohen ndjenjat e larta, janë kandidatë për t'u bërë të gjallë në mendje dhe ide, shembull në moral dhe virtyt!

* * *

Njeriu është njeri në atë masë që ndjenjat e tij të jenë larg gjërave të ulëta. Edhe sikur njerëzit me zemrën nën presionin e ndjenjave të këqija dhe me shpirtin të kapur në mengenenë e egoizmit, të duken në pamje si njerëz, të lenë për të menduar. Pothuajse çdo njeri e njeh pjesën e edukatës që ka të bëjë me trupin, por janë shumë të paktë ata që kuptojnë nga edukata mendore e ndjesore që i shërben, në fakt, punës. Me formën e parë të edukatës përgatiten më shumë njerëz të shquar për nga muskujt, kurse me formën e dytë, njerëz të shpirtit dhe mendimit.

* * *

Përmirësimit të një kombi i shërbehet jo duke i asgjësuar të këqijat, por duke i lartësuar brezat në vlerat njerëzore me anë të kulturës dhe edukatës kombëtare. Pasi të mos hedhësh në të katër anët e vendit farë të zgjedhur nga përzierja e përbërë prej fesë, vetëdijes historike dhe traditave, për ta bleruar gjithkrahjen me të, në vend të çdo të keqeje të asgjësuar, kanë për të mbirë ca të tjera të reja si bar helmues për ta zhbërë çdo gjë të mirë të mbetur ende pa u zhbërë.

* * *

Librat që u duhen dhënë fëmijëve për t'i lexuar, qoftë poezi apo prozë, duhet të jenë të asaj cilësie që t'u japin mendimit forcë, shpirtit qëndrueshmëri, shpresës dhe zellit dritë, në mënyrë që të përgatiten breza me vullnet të fortë e mendime të shëndosha.

* * *

Megjithëse është parim që vajzat, të cilat nesër do të bëhen nëna e do të marrin përsipër të rrisin dhe edukojnë fëmijë, duhet t'i përgatisim, sipas këtij qëllimi, delikate si lule dhe të dhembshura, duhet të kihet kujdes, njëkohësisht, që të jenë të forta si çeliku në kuptim që të jenë në gjendje t'i dalin për zot mendimit të vërtetë, ndryshe, për hir të delikatesës dhe brishtësisë, nxjerrim në shesh ca krijesa mediokre, mizantrope e të dobëta që s'vlejnë për gjë! Të mos harrojmë: edhe luanesha luan është!..

* * *

Edukata është një bukuri më vete dhe, te kushdo që të ndodhet, imitohet. Sigurisht, edhe nëse dikush është i paditur, po që i edukuar, duket. Kombet të mangët në kulturën kombëtare e në edukatën kombëtare u ngjasin individëve injorantë, të trashë e rrugaçë, të cilët as besë nuk kanë në miqësi, as seriozitet në armiqësi! Ata që u besojnë të tillëve, gjithmonë pësojnë zhgënjim, ata që mbështeten në ta, herët a vonë mbeten pa mbështetje!

* * *

Edukatorët që s'kanë punuar si çirakë pranë një mjeshtri dhe s'kanë marrë edukatë nga një burim i shëndoshë, janë si shërbëtorë që u mbajnë pishën rrugës së të tjerëve. Paturpësia dhe përkëdhelia e dukur në fëmijët është pasojë e turbullirës së burimit ku ai është zhvilluar e zhvillohet. Parregullsia ndjesore, ideore dhe e veprimit në familje reflektohet e përforcuar në shpirtin e fëmijës. Dhe, natyrisht, nga ai në shoqëri...

* * *

Në shkolla, të paktën po aq sa në mësimet e tjera, duhet qëndruar mbi edukatën dhe kulturën kombëtare në mënyrë që të përgatiten breza me shpirt e karakter të shëndoshë, të cilët do ta kthejnë vendin në parajsë. Arsimit është tjetër gjë, edukimi, tjetër gjë. Shumica e njerëzve mund të bëhen arsimtarë, por janë të paktë ata që mund të bëhen me plot kuptimin e fjalës edukatorë!

* * *

Mësimet që u jepet më pak rëndësi, në një kohë që janë më të rëndësishëm, janë kultura kombëtare dhe edukata kombëtare. Po qe se një ditë do të kthehemi për ta vënë në shfrytëzim këtë rrugë, do të kemi marrë vendimin më të qëlluar për përparimin e kombit.

* * *

Poeti është poet që në lindje. Imrul Kajsi nuk pati bërë shkollë. Ajnshtajni ikte nga shkolla, sepse mendimet i kishte të tjera. Njutoni pati marrë notë të dobët në matematikë, por teoria e tij është matematike. Kurse ne përpiqemi të trazojmë në kazanin e të tjerëve me qepshen tonë...

* * *

Shkolla e parë e fëmijëve, që e kanë shpirtin të shkëlqyer si pasqyrë e që regjistron shpejt sikur aparatet fotografike, janë shtëpitë e veta, kurse edukatoret e para, nënat. Përgatitja e nënave si edukatore dhe jo konsumimi i tyre majtas-djathtas është baza më e rëndësishme për ekzistencën dhe vazhdimësinë e një kombi.

Këshilla

Këshilla është shtylla qendrore e jetës besimore.

* * *

Po të ishte këshilla e padobishme, a kishte për të dërguar Zoti profetë?

* * *

Këshilla është një pretekst i rëndësishëm që çon në dobi; preteksti i dobisë është dobi, dhe i mirëbërësisë, mirëbërësi.

* * *

Kush këshillon, para së gjithash duhet t'i jetojë para të tjerëve gjërat që këshillon, që të bëhet i besueshëm. Sipas meje, shkaqet e ndikueshmërisë së djeshme e të pandikueshmërisë së sotme pikërisht këtu duhen kërkuar!

* * *

Kush mbetet ta prijnë qorrat, do të ishte më afër qëllimit të vet sikur të qëndronte atje ku ndodhet sesa të ecte nga ta çojnë ata!

* * *

Çelësi i zemrave është karakteri i butë dhe fjala e butë.

* * *

Predikues është ai që mund ta kontrollojë auditorin me një të parë.

* * *

Gjithmonë, tregimi me vepra ka qenë më i besueshëm se tregimi me fjalë.

* * *

Fol butë që të të hapen portat e zemrave, bëhu zemërngrohtë që ndërgjegjjet t'u thonë mendimeve të tua, "urdhëroni!", sillu me sinqeritet që të kesh ndikim të vazhdueshëm!

* * *

Kur të gjitha fjalët të të kenë mbetur në ajër, mund të jetë e dobishme të provosh t'u drejtohesh bashkëbiseduesve me të mirë...

* * *

Ka të mirë e të mirë, ka të keqe e të keqe... Të mençurit e dinë se cila prej tyre dhe në ç'kohë duhet zgjedhur.

Këshillimi

"Pyet atë që di! Dy të ditura janë më të dobishme se një e ditur!"

Këshillimi është kushti i parë që vendimet që do të merren, të jenë të qëlluara. Vendimet e marra mbi një çështje pa u menduar mirë e mirë, dhe pa iu parashtruar më parë mendimeve dhe kritikave të të tjerëve, shpesh herë përfundojnë me disfatë. Është parë se dikush me karakter të mbyllur, që mendon më kokë të vet pa i respektuar mendimet e të tjerëve, gënjehet më shumë se dikush tjetër që edhe në qoftë një natyrë eprore apo edhe gjeni, këshillohet për çdo mendim të vet.

* * *

Njeriu më i mençur është ai që respekton më shumë këshillimin dhe ai që përfiton më shumë prej mendimeve të të tjerëve. Shpirtrat vulgarë që mjaftohen me mendimet e veta, madje që kërkojnë t'u detyrojnë edhe të tjerëve, shihen gjithmonë me përbuzje dhe bezdi nga mjedisi.

* * *

Ashtu siç është këshillimi kusht i parë për të arritur rezultate të mira, ashtu edhe përfitimi prej mendimeve të larta të miqve, është një pretekst i rëndësishëm për t'u ruajtur prej fundit të keq dhe disfatës.

* * *

Para fillimit të një pune duhet bërë çdo lloj këshillimi i nevojshëm dhe duhen marrë të gjitha masat në mënyrë që pastaj të mos bihet në pozita të tilla si fajësimi i të tjerëve dhe kritika ndaj fatit, gjë që e dyfishon fatkeqësinë. Sigurisht, nëse para se t'i hyhet një pune, nuk mendohet mirë fundi i saj dhe nuk kërkohet mendimi i personave me përvojë, zhgënjimi në rezultat dhe pendimi janë të pashmangshëm!

* * *

Sa e sa raste ka kur i është hyrë një pune pa u menduar mirë fundi i saj, asisoj që, jo vetëm nuk është hedhur dot asnjë hap para, por është mbyllur me humbjen e kredisë së iniciatorëve të saj. Sigurisht, dikush që ngrihet për të bërë çdo gjë që i shkon nëpër mend, për shkak të zhgënjimit që do të pësojë nga hyrja në rrugë të gabuara, herët a vonë do ta humbë besimin në vetvete edhe për gjërat që mundet t'i bëjë!

* * *

Njeriu kurrsesi s'duhet t'i hapë portat që s'do të mund t'i mbyllë dot më vonë. Ndryshe, të këqijat e hyra nga të çarat, nga dyert e dritaret e hapura, edhe të tjerët i dëmtojnë, edhe dinjitetin e tij e rrëmbejnë e shkojnë! Sa e sa njerëz ka që janë zënë pas një sërë sevdash duke shitur mend, e pa u këshilluar me të tjerët, që edhe kanë rënë nën dhembët e kobrave që i kanë zgjuar vetë, edhe janë lënë jashtë radhe. Eh, sikur të kishin mbetur vetëm vetë jashtë radhe!..

E drejta

Ai që ka të drejtë, është i gëzuar e i kënaqur edhe në qoftë se mundet; ai që s'ka të drejtë, është i mërzhitur e i brengosur, edhe në daltë fitues!..

* * *

E drejta është, në vetvete, e bukur, ashtu edhe ai që ka të drejtë, është i këndshëm. Edhe sikur të bjerë në baltë, ai që ka të drejtë mbetet i pastër; ai që s'ka të drejtë, edhe me erëra të mira sikur të lahet, mbetet i pistë e i ndyrë...

* * *

Edhe sikur ngjyra dhe forma të ndërrojnë, rrënja nuk ndryshon, edhe sikur titulli e fama të ndërrojnë, personi nuk ndryshon. Këto kanë qenë dhe gjërat që e kanë mashtruar më shumë njeriun: ngjyra, trajta, titulli dhe fama...

* * *

Ai që e shtyp të dobëtin, është i mundur dhe në qoftë fitues; ai që ka të drejtë, është fitues edhe në qoftë i mundur!

E drejta dhe drejtësia

Drejtësia është më e fuqishme se njësitë e mekanizuara që duken si më të fuqishmet...

* * *

Edhe sikur e drejta të jetë një shpatë që po të zbret në zverk, mos u druaj t'i zgjasësh qafën!..

* * *

Drejtësia është një kapital që përdoret në çdo vend.

* * *

Drejtësia është një nga rrugët për të qenë pranë Zotit, mirëpo ja që shumica e njerëzve parapëlqejnë të rrinë larg saj!

* * *

Muret rrethuese të fortesës së Islamit janë e drejta; porta, drejtësia dhe brendia e kalasë, lumturia!

* * *

Gërmadhat ku sundon drejtësia, janë më të vlefshme se sarajet; sarajet e mbytura në dhunë e padrejtësi, janë më gërmadhë se gërmadhat...

* * *

Provë e fuqishme lidhur me botën përtej do të thotë ide drejtësie e saktë dhe e fuqishme...

* * *

Kush përplasat me të drejtën, herët a vonë bie i mundur!

* * *

Kur të shtypësh të tjerët, kurrësi mos e nxirr nga mendja se ekziston një forcë që ka për të të shtypur edhe ty!

E mira dhe e keqja

Të bësh mirë është, sipas fesë dhe urtësisë, detyrë, kurse, sipas ndërgjegjes, një sjellje e denjë për miratim; të mos bësh mirë, sipas fesë, është mëkat, sipas urtësisë, nivel i ulët moral, sipas ndërgjegjes, moskokëçarje. Disa herë, e mira mund të jetë e padobishme, madje, në një farë mase, e dëmshme, por kurrësi s'mund të jetë e keqe. Kurse e keqja është krejt e kundërta e së mirës!

Republika

Republikë do të thotë qeverisje ku populli ka të drejtë të zgjedhë e të japë këshillë; ndërkaq, Kurani është i pari që ka treguar se si praktikohet kjo lloj qeverisjeje. Nëse shenjimi i qeverisjes republikane si antagonist e Kuranit nuk është i qëllimshëm, atëherë është krejtësisht vepër e një mosnjohjeje; anësia ndaj republikës duke mos e treguar se kush është burimi i saj, s'është gjë tjetër veçse shfaqje e mllefrit.

* * *

Jo vetëm që Profeti nuk pretendoi për të qenë mbret, por as kalifët e tij të zgjedhur nuk lejuan të quheshin sundimtar ose sulltan. Mbretërimi doli në shesh si pasojë e largimit nga shpirti i Islamit dhe u bë mjet despotizmi e padrejtësie në atë masë sa ç'u largua nga shpirti i Islamit!

* * *

Republika, e cila mbështetet në botëkuptimin e lirisë dhe drejtësisë së vërtetë, krahas të qenit një formë qeverisjeje e lartë dhe e sigurt, është dhe një sistem jashtëzakonisht delikat. Nëse nuk i dilet për zot duke u kujdesur veçanërisht për këtë aspekt të saj, mbirja dhe rritja e ateizmit dhe, për pasojë, e anarkisë në gji të saj, mund të bëhet e pashmangshme.

* * *

Republika e vërtetë është forma qeverisëse e shpirtit të lartësuar dhe më e përshtatshme për njeriun si qenie e nderuar. Kurse për shpirtitrat vulgarë ende të pamaturuar, ose që nuk i kanë dalluar dot ende rrugët e përsosjes njerëzore, është një iluzion në shkretëtirë e si një çardak i varur gati në të rënë ku s'mund të dilet...

* * *

Republika është nëna e lirisë ose edukatorja e saj. Brezat e dashuruar pas lirisë ajo i ushqen, ajo i rrit. Ajo i ushqen, ajo i rrit, mirëpo republika kurrësi s'është një qeverisje lirie rrugaçësh, por lirie virtyti dhe morali.

* * *

Me vlerat e saj që e lartësojnë njeriun, republika përgatit bazën për lartësimin e njeriut, duke e lenë sakaq atë kokë më kokë me moralin e tij të lartë dhe ndërgjegjen e zgjuar. Pas kësaj, çdo individ, në punë e në shtëpi, si një njeri i vullnetit, mendon vetëm për mirë, duke ndjekur vlerat e larta njerëzore!

* * *

Në saje të dëshirës për liri në esencën e vet, shpirti nuk pranon mbi vete kurrfarë force sunduese. Për rrjedhojë, kundërvepron ndaj kufizimeve që mund të kërkohet t'u vihen mendimeve, sjelljeve e shprehjeve të veta. Prandaj ndodh, që ata që i dalin për zot republikës, nga njëra anë u njohin individëve liri dhe të drejta të gjera, nga ana tjetër, i lartësojnë ata për t'u bërë njerëz të moralit, virtytit, idesë dhe vullnetit!

* * *

Mbrojtja e idesë dhe ndjenjës fetare është domosdoshmëri e republikës dhe nevojë për të. Nisur nga kjo, poshtërimi i njerëzve, në një lloj qeverisjeje të tillë, për shkak të ideve e ndjenjave fetare, ushtrimi i dhunës mbi ta dhe nxirja e figurës së tyre do të thotë poshtërim i republikës si sistem qeverisjeje dhe dhunim i saj!

* * *

Republika ka nevojë për njerëz që ta ndjejnë dhe kuptojnë plotësisht atë. Kuvendi i saj duhet të jetë, ashtu si një kuvend të urtësh, serioz e hijerëndë, kurse veprimtaria, vërtetësi e drejtësidashëse!

Politika

Politika është arti i administrimit në vijën e lënies të kënaqur të popullit dhe Zotit. Qeveritë konsiderohen të suksesshme dhe premtuese me aq sa e mbrojnë popullin nga çdo e keqe me anë të pushtetit që kanë, kurse me anë të organeve të drejtësisë, nga padrejtësitë. Në të kundërt, qirinjtë e mbarësisë shuhen menjëherë, pastaj ikin e mbarojnë duke lënë pas vedit një rrëmujë të madhe veç me thirrje sharjesh e mallkimesh...

* * *

Qysh në krye të herës, masat i kanë drejtuar politikanë, njerëz të aksionit, të ditur e të zgjuar, kurse ata vetë, më të shquarit mes tyre. Edhe sundimi ynë botëror i përket periudhave kur patëm një kuadër të tillë...

* * *

Për një administrator dhe politikan të mirë, janë shumë të rëndësishme këto veçori: ideja e Zotit, epërsia e drejtësisë, vetëdija e detyrës, ndjenja e përgjegjësisë në punët e rënda e të vështira, mjeshtëria dhe kompetenca në punët delikate...

* * *

Qeveri do të thotë drejtësi dhe qetësi. Atje ku s'ekzistojnë këto, s'mund të bëhet fjalë se ka qeveri. Në qoftë se qeveria do të përngjasohej me një mulli, mielli i saj janë rregulli, qetësia dhe siguria. Kurse mulliri që s'nxjerr të tillë miell, s'bën gjë tjetër veçse zhurmë duke bluar në erë...

* * *

Më shumë se të thotë qeveria “populli im”, ka rëndësi të shprehet populli për të, duke e quajtur “qeveria ime”, dhe pandeh se kjo është ajo që kërkohet gjithmonë! Ndryshe, po qe se populli e sheh qeverinë që ka në krye si egjër që i ka rënë në qafë, duke iu përdredhur nga të katër anët, qeveria i ngjet një koke të këputur nga trupi qëkuri.

* * *

Respekti në zemrën e popullit ndaj shtetit, respekti i tij ndaj qeverisë duhet përpjekur të fitohen jo me dhunën e nëpunësit të qeverisë, por me seriozitetin e qeveritarëve në sjelljet dhe veprimet e tyre, me sinqeritetin në punët dhe shërbimet e tyre. Gjer tani, me despotizmin e nëpunësve mizorë a me mashtrimin e masave askush nuk ka dalë i fituar!

* * *

Nëse nëpunësit që qeverisin një shtet të mirë e të virtytshëm, mund të zgjidhen sipas fisnikërisë së origjinës, fisnikërisë së mendimit dhe fisnikërisë së ndjenjave, ai shtet mbetet i mirë e i fuqishëm. Kurse qeveria e cila, duke emëruar nëpunës persona të mangët në këta tregues të lartë, ka rënë në fatkeqësinë për të pritur shërbim prej tyre, s’është një qeveri e mirë dhe kurrësi nuk mund të jetë jetëgjatë! Sjelljet e këqija të nëpunësve të pafismë, herët a vonë do të reflektohen si njolla të zeza edhe në çehren e saj, e për rrjedhojë, edhe në ndërgjegjen e popullit do të nxihet!

* * *

Në detyrë, nëpunësit duhet të veprojnë brenda kuadrit të ligjeve, por duhet edhe të jenë të butë sipas butësisë së ndërgjegjeve të veta. Kështu ata do të ruajnë edhe respektin mbi veten, edhe respektin mbi ligjet, edhe respektin mbi shtetin! Nuk duhet nxjerrë nga mendja se ashpërsia e skajshme shkakton shpërthime të papritura, kurse butësia e skajshme, sjelljen e shoqërisë në gjendjen e një fidanishteje barërash të këqija.

* * *

Ligjet duhet të jenë të vlefshme për të gjithë, në çdo kohë e në çdo vend, kurse zbatuesit e tyre, edhe të guximshëm, edhe të drejtë në mënyrë që masat, po aq sa të kenë frikë para tyre, po aq edhe të ndjehen të sigurt saje tyre!

* * *

Një shtet është i fuqishëm dhe i qëndrueshëm, për pasojë, edhe me fat, me aq sa të përfaqësohet me individë besimtarë, të zgjuar, të fuqishëm e dinamikë.

* * *

Kopshtari i ushqen fidanët e i rrit, i mbron ata nga dëmtuesit dhe fatkeqësitë, pastaj, në kohën e të vjelave, mbledh frytet e tyre. Edhe marrëdhënia midis shtetit dhe popullit është po marrëdhënia midis kopshtarit dhe fidanëve...

* * *

Shtetet e shkëlqyera lindin nga kombet e shkëlqyera, kurse kombet e shkëlqyera, me pushtetin e tyre dituror, mundësitë materiale dhe njohjen e gjerë, nga brezat me shpirt, si dhe nga individët e zgjedhur që luftojnë për të qenë “identitet i vetvetes”!

* * *

Qeverisja në një komb që nuk e ka vërtetuar ende pjekurinë e vet në çdo individ, duhet t’u dorëzohet personave më të informuar, më të aftë e më largpamës. Për një komb, nuk mund të përfytyrohet një fatkeqësi më e madhe se dorëzimi i punëve të shtetit njerëzve të paditur, të paafte e miopë!

* * *

Nëse të pafismët, të mangët nga kultura dhe soji, e të paditur në punët e shtetit, janë sjellë gabimisht në krye të një detyre, nuk do të rrinë pa e përdorur fuqinë e shtetit për vete, pa e shpërdoruar pushtetin e tij, pa kërkuar në çdo gjë interesat e veta dhe pa sunduar si nga një mbret despot më vete. Në një vend ku në pushtet janë njerëz të tillë, do të dëgjohen vetëm bërtitjet e mizorëve dhe rënkimet e viktimave, për pasojë, fundi i dhimbshëm i atij vendi do të jetë i pashmangshëm.

* * *

Një shtet duhet të përpiket të rregullojë jo vetëm punën, veprimtarinë dhe sjelljet e kombit, por edhe mendimin dhe botëkuptimin e tij. Parimi më i rëndësishëm në këtë rregullim është uniteti i mendimit, i ndjenjës, i arsimit dhe edukimit. Nëse individët që përbëjnë kombin, ushqehen me kultura e mendime të ndryshme, bien në antagonizëm me njëri-tjetrin dhe luftojnë në interes të botëkuptimeve të ndryshme, ai komb është i dënuar me asgjësimin e vetvetes!

* * *

Që një komb të jetë i fuqishëm, sa ç'është i rëndësishëm uniteti i kulturës, ndjenjës e mendimit, po aq me ndikim është edhe prishja e unitetit moralo-fetar në copëtimin dhe shpërndarjen e kombit!

* * *

Në çdo gjë ka politikë, ndërkaq, politika e atyre që përgatisin rilindjen e një kombi, duhet të jetë politika e njerëzve, të cilët, pa menduar asgjë, madje dhe kënaqësitë e veta, marrin forcë vetëm e vetëm me kënaqësitë e kombit dhe vuajnë vetëm me dhimbjet e tij!..

* * *

Administrimi i mirë dhe politika me nivel nuk duhen kërkuar as në mjekra, as në flokë të bardhë, as në servilizëm dhe postet e fituara me hipokrizi dhe as në popullaritetin artificial të shtënë në dorë me shtytjen e një sërë strukturash të dyshimta, por duhen kërkuar mes njerëzve shpirtlartë, mes truve që heqin e vuajnë dhe mes sklevërve të së vërtetës që nuk kërkojnë lirim...

* * *

Në qoftë se çdo shtëpi shërben si një shkollë për mësimin dhe edukimin e pjesëtarëve të saj, çdo shkollë shërben si një garnizon i vogël që zhvillon shpirtin ushtarak, çdo garnizon shërben si një kuvend ku diskutohen qenia, vazhdimësia dhe qetësia e kombit dhe çdo kuvend shërben si një laborator shoqëror që vlerëson, duke e kaluar çdo çështje të përcjellë atij kuvendi, nëpër prizmin e shpirtit dhe mendimit kombëtar, sipas detyrës dhe kompetencave të tij, do të thotë se ai komb zotëron kuadrin administrativ dhe politik më ideal!

* * *

Zotërimi i mendimeve të ndryshme dhe i konsideratave të ndryshme është punë e njerëzve të pjekur. Ndërkaq, askush s'ka të drejtë të tregohet liberal e lëshues ndaj mendimeve e konsideratave të ndryshme që e përcajnë kombin duke e ndarë në kampe, sepse një liberalizëm dhe lëshim i tillë do të thotë të mbyllësh sytë para shembjes dhe asgjësimit të kombit!

* * *

Sado mirë të mendoni e sado optimistë të jeni për njerëz që u përkasin mendimeve e ndjenjave kombëtare të tjera, nuk duhet të mbani larg syve se mund t'ju sjellin dëm. Dhe në asnjë mënyrë të mos u jepni rast të shtien në dorë pikat që vlerësohen si aortë e kombit dhe shoqërisë, sepse njeriu

mund të bëjë lëshime që mund ta hedhin atë personalisht në rreziqe, por kurrësi s'ka të drejtë të sillet kështu në emër të kombit e të shtetit!

* * *

Duke u nisur nga konsiderata se ka edhe njerëz shumë të sinqertë e të dobishëm, megjithëse kanë një botëkuptim të ndryshëm e mendojnë ndryshe nga ju, nuk duhet t'i dilni me nxitim kundër çdo mendimi të kundërt, duke humbur edhe ata që mendojnë ashtu. Për më tepër, duke kërkuar rrugët për të përfituar nga mendimet dhe konsideratat e tyre, duhet hyrë në dialog me ta. Ndryshe, këta të pakënaqur, të larguar nga ana jonë me mendimin se nuk mendojnë si ne, ose të larguar vetë, ju dalin para me turma gjigante dhe ju shtrijnë për tokë. Edhe nëse gjatë gjithë historisë së njerëzimit nuk mund të tregohet ndonjë vepër pozitive e kryer prej të pakënaqurve, shtetet që kanë shembur janë të panumërueshëm!

* * *

Nga kushdo që të vijë, le të vijë, njeriu duhet të dijë të përfitojë nga informacionet dhe konsideratat e dobishme për sistemin e vet, për mendimin e vet, për botën e vet dhe sidomos kurrë nuk duhet ta nënvleftësojë përfitimin nga përvoja e njerëzve me përvojë!

* * *

Duke marrë parasysh veçorinë e saj bashkuese e njësuere, feja është një institucion jetësor, të cilin duhet ta kenë parasysh ata që drejtojnë kombet, dhe në fuqinë e pamposhtur të së cilës duhet mbështetur vazhdimisht!

* * *

Lidhur me sigurimin e qetësisë dhe garancisë për kombet dhe shtetet, është e pamundur të gjesësh një forcë të dytë krah fesë. Ashtu siç është fuqia më ndikuese mbi ndërgjegjëjt e njerëzve, feja është edhe elementi më vendimtar për të marrë nën kontroll sjelljet dhe veprimet e individëve. Është për këtë arsye që drejtuesit, duke e njohur jetën fetare si jetë të kombit, janë përpjekur vazhdimisht ta mbajnë gjallë atë në ndërgjegjen publike.

* * *

Lartësimi i kombit varet nga aftësimi i të rinjve për ta kuptuar kohën që jetojnë, brenda kuadrit të besimit dhe mendimit tonë, nga mbrojtja e besueshmërisë para masave duke bërë përpjekje të vetëdijshme për të kapërcyer varfërinë dhe nevojat si dhe nga mbajtja e industrisë dhe tregtisë gjithmonë pas dijes dhe aftësisë.

* * *

Tri janë elementet më të rëndësishme që e mbajnë gjallë një komb: feja, urtësia dhe armët. Urtësinë mund ta interpretojmë si përvetësim të filozofisë, duke e lidhur atë ngushtë me jetën.

* * *

Bota është një vend prove dhe çdo gjë këtu zë vend sipas kuptimit të marrë me anë të përvojës dhe vlerave të fituara. Për mua, duke u dhënë, nga një anë, rëndësi gjërave të kaluara nëpër prova, nga ana tjetër nuk duhet lënë gjë mangët në provat dhe vlerësimet e reja që informacionit t'i ruhet edhe saktësia, edhe pjelloria.

* * *

Në qeveritarët e lartë janë parim ndjeshmëria, dhembshuria dhe ndjenja e përgjegjësisë, në drejtuesit lokalë, sigurimi i rregullit në jetën e përditshme, i sigurisë dhe qetësisë, në gjykatësit, ideja e së drejtës, paanshmëria dhe guximi qytetar.

* * *

Është e natyrshme që mes kombeve e shteteve të ketë fërkime. Nisur nga kjo, politika mes tyre vërtitet ose rreth miqësisë së singertë, ose rreth interesit. Që të dyja mënyrat janë të justifikueshme me kusht që të mos dëmtohet tjetri, si dhe të mos dëmtohesh vetë. Ndërkaq, edhe nëse s'mendohet që ne ta mashtrojmë dikë, është një aspekt i politikës që të rrihet vazhdimisht zgjuar për të mos u mashtruar nga të tjerët!

* * *

Bëjnë gabim ata që e kuptojnë politikën vetëm në formën e partisë, propagandës, zgjedhjeve dhe luftës për pushtet. Politika është art i administrimit me perspektivë të gjerë, si mendimi në të njëjtën kohë i të sotmes me të nesërmen dhe i të nesërmes me të pasnesërmen si dhe i trajtimit të kënaqësisë së popullit, së bashku me pëlqimin e Zotit.

* * *

E kaluara është një shkollë e mbushur plot me shembuj nga jeta dhe tablo mësimdhënëse. Ata që janë të aftë ta njohin dhe vlerësojnë shumë mirë këtë shkollë me gjërat që jep dhe që të përfton, do ta zotërojnë edhe të nesërmen me sukses. Sepse e sotmja është identikja e së djeshmes e kështu me radhë; çka ndryshon, janë vetëm ngjyrat...

* * *

Sundimi i forcës është kalimtar. I përjetshëm është sundimi i të drejtës dhe drejtësisë. Edhe nëse jo sot, është jashtë çdo diskutimi se në një të ardhme të afërt, këta do të dalin fitues! Prandaj, politika më e madhe duhet kërkuar në anësinë ndaj të drejtës e drejtësisë!..

* * *

Sipas kriterëve të pranuar, të thuash “nuk përzihem në politikë, mos u përzje në politikë”, do të thotë “nuk përzihem, mos u përzje në punën e atdheut dhe kombit, në jetën dhe të ardhmen e kombit”!

* * *

Në ditët tona, një pjesë e madhe e njerëzve, ndryshe nga ata që i konsiderojnë politikë lojrat politike ditore, mashttrimin e masave popullore, luftën për interesa dhe pushtet dhe, për hir të kësaj, tregimin si legale të të gjitha veprimtarive e akteve jolegale, e shohin si të detyrueshme që, në emër të jetës së tyre ndjesore, të drejtimit të tyre ideor dhe të marrëdhënieve me Zotin, të rrinë larg çdo lëvizjeje politike. Eh, ku politika e njësuar me idenë e së drejtës dhe drejtësisë, e ku sharlatanizmi i rrugëve!..

Xhamitë dhe funksionet e tyre

Edhe në ditët më të këqija, xhamitë kanë qenë e do të jenë mjediset më të shndritshme ku diskutohen çështjet që i përkasin Kuranit.

* * *

Xhamitë janë vatra arsimit e kulture, që në çdo nivel, veprojnë sikur shkolla.

* * *

Xhamitë janë struktura qiellore ku, krahas adhurimit, dhikri dhe meditimi realizohen në formën më të gjallë.

* * *

Në një periudhë të caktuar, xhamitë kanë qenë kuvende këshillimi ku këshilloheshin burrat e shtetit.

* * *

Kryerja edhe e punëve të kësaj bote në vende të hapura ndaj botës hyjnore siç janë faltoret, me ato çka u përftojnë shpirttrave, qëndrojnë përtej çdo lloj shprehjeje!

* * *

Për nga disiplinimi i jetës së besimtarëve, xhamitë janë pothuajse si nga një vendstërvitjeje më vete.

Tregtia

Me gjuhën e parave e të mallrave që shiten e blihen, tregtia është lutje për furnizim drejtuar Individualitetit që mban në duar frerët e çdo gjëje. Kjo lutje a kërkesë duhet bërë, por, njëkohësisht, nuk duhet harruar që plotësimi i kërkesave i përket Atij. Le të përparojnë sa të duan teknika dhe teknologjia, roli i tregtisë dhe i gjërave të premtuara prej saj në emër të së ardhmes do të jetë më i madh se ky i sotmi dhe mbi parashikimet. Për më tepër, qeveritë dhe pushtetet do të dalin në dritë sipas këshillave të saj, dhe do të mund ta vazhdojnë ekzistencën e tyre veçse me mbështetjen e saj!

* * *

Krahas faktit që rëndësia e dijes dhe specialitetit është e madhe, si në çdo gjë tjetër, edhe në tregti dhe zeje, nuk duhet hequr kurrë nga mendja se veçanërisht këto dy profesione mbështeten në parimin e çirakllëkut, domethënë të nxënësit në profesion. Ka aq shumë çështje që trajtohen në libra, të cilat as që mund të japin atë që pritet prej tyre pa kaluar nëpër prizmin e mjeshtërisë së një ustai të ardhur nga shërbimi si çirak dhe kallfë i përgatitur.

* * *

Një tregtar që bën shitblerje në përputhje me trajtimin hallall-haram të gjërave, koha e kaluar në krye të punës quhet adhurim.

* * *

Meqë pastërtia dhe rregulli, apo papastërtia dhe parregullsia e vendeve të punës, apo të tregtisë, shpesh janë reflektime të cilësive shpirtërore të shitësit, a në përgjithësi të të zotit të vendit të punës, nuk duhet harruar ndikimi pozitiv apo negativ i kësaj mbi klientët apo kërkesat.

* * *

Tregtari hileqar apo afaristi hileqar, me këtë sjellje, së pari, vihen në kundërshtim me Zotin, pastaj edhe me ndërgjegjëjet e veta. Pas kësaj, pasi hileja e tyre të merret vesh, e humbin kredinë në popull dhe shkojnë drejt humbjes...

* * *

Fryma e tregtisë është drejtësia, siguria, besnikëria, njohja e kohës, sjellja jashtëzakonisht delikate dhe me edukatë ndaj klientit. Ai që le mangët njërrën prej këtyre veçantive, ka dëmtuar frymën e tregtisë, duke bllokuar kësisoj të gjitha rrugët e fitimit.

* * *

Tregtarët dhe artizanët duhet të jenë gjuhëmbël, fytyrëqeshur, mjaft të thjeshtë, të qëndrueshëm në fjalë dhe që s'përtojnë e s'mërziten kurrë. Këto veçanti që janë shumë të domosdoshme pothuajse për çdo profesionist, për këto dy klasa, për shkak të marrëdhënieve të ngushta me popullin dhe të interesimit për humbjen dhe fitimin, janë më të rëndësishme.

* * *

Për ata që janë mësuar t'i hapin vendet e punës çdo ditë një orë më parë e t'i mbyllin një orë më pas, muaji u bëhet tridhjetë e pesë ditë, viti, katërqind e njëzet ditë; natyrisht, me kusht që, me aq sa ta lejojnë mundësitë, të mos e lënë shërbimin mangët.

Mbi gjuhën

Gjuha është një nga dhuratat më të mëdha që i Gjithëmëshirshmi i ka favorizuar njeriut. Me të e demonstroi njeriu që është njeri, me të hapet drejt diturive dhe me anë të saj vazhdon të jetojë edhe mes brezave të ardhshëm. S'e di, ata që e prishin gjuhën njerëzore duke e kthyer atë në gjuhë zogjsh, a i bien dot në të përmasave të tradhtisë që bëjnë?

Mendimi makiavelist

Rruga e paraqitjes dhe njohjes së vetes duke i nxirë të tjerët, në krye të herës njihej vetëm në Lindje si puna e një grupi hipokritësh. Mirëpo, për fat të keq, kjo u përhap kaq shumë sa që edhe një pjesë e madhe e atyre që luftojnë në emër të së drejtës, i lidhin përpjekjet e veta me makiavelizmin. Turp të kenë ata që kërkojnë të drejtën me rrugë të shtrembra! Turp e faqja e zezë u qoftë tërë makiavelistëve!

Fitorja e së mirës dhe e së bukurës

E mira, e bukura, drejtësia dhe virtyti janë tharmi esencial i kësaj bote. Sido që të bëhet, herët a vonë, bota do të hyjë në udhë dhe askush s'do të ketë fuqi ta pengojë!

PJESA E KATËRT

PERSPEKTIVA TË VEPRIMIT

Pikat e përbashkëta

Në ditët tona ka rryma të ndryshme ideore dhe do të ketë. Para së gjithash, njeriu ynë ndodhet në një krizë të thellë shpirtërore. Ndërkaq, siç janë dyshimet që çojnë në kërkim, baza e shkencave, ashtu edhe krizat ideo-shpirtërore janë, në një kuptim, burimi i rrymave ideore.

Në shoqëritë që i kanë siguruar plotësisht sipas kohës nevojat e tyre, dhe që janë në vazhdim të zhvillimit të tyre të natyrshëm, shqetësimet shoqërore janë pothuajse të papërfillshme. Kurse në shoqëritë që nuk i kanë plotësuar nevojat materiale-shpirtërore dhe nuk kanë mundur ta përshpejtojnë zhvillimin e tyre të natyrshëm, me shtimin në vazhdim të presioneve të brendshme e të jashtme, shtohen edhe turbullimet.

Krizat dhe turbullitë shoqërore u përngjajnë shtrëngatave, furtunave e cikloneve, andaj shpesh herë, nisur nga përfundimi, janë të mira, sepse, e shtrënguar prej turbullirave, shoqëria detyrohet të ndryshojë, e kësaj, arrin të përshtatet me kohën e të ecë me hapin e saj. Po që se një shoqëri nuk e njej periudhën që po jeton, po që se me aksionet dhe reaksionet e saj nuk merr pjesë aktive në ndodhitë e asaj periudhe, është e pamundur të pranosh se ajo shoqëri jeton, sepse ajo ecën në rrugën e një shembjeje të detyruar.

Sot, në shpinë të lëkundjeve e turbullirave që kanë përfshirë të gjithë shoqërinë, pa asnjë dyshim, janë pikërisht këto lloj krizash dhe, me presionin e jashtëm e të brendshëm mbi muret e statukuosë, ka nisma për struktura dhe sendërtime të reja. Kombet që arrijnë të dalin nga kjo lëkundje e trazirë e përgjithshme si dhe nga ky ristrukturim pa u shembur, e marrin pjesën që u takon nga historia duke ngritur një botë krejt të repër vetel!

Gjithsesi, nuk mund të mendohet që edhe kombi ynë së bashku me bashkësinë e popujve e kombeve me të cilët jemi të lidhur, të mbeten jashtë kësaj. Dhe kështu do të ndodhë: do të kalojë nga kriza në krizë, do të bjerë nga shqetësimi në shqetësim dhe do të heqë një mijë lloje dhimbjesh, por, më në fund, pa dyshim, do të rilindë ai që është!

Ndërkaq, thelbësore është që, pas gjithë këtyre ndodhive, struktura e re të mund të përgatitet në mënyrë të përsosur, me themel dhe në përputhje me parime të pavjetërsueshme e të palëkundura. Në të kundërt, po që se ligjet shoqërore nuk njihen dhe mjekimi nuk bëhet mbi baza shkencore, qëndrimet negative e me kahje të kundërt mund ta përmbysin çdo gjë.

Ja, pra, sot, ne, para një gjendjeje të tillë ndodhemi: të jemi apo të mos jemi! Ose, pas gjithë kësaj vorbulle, me një arsye e vetëdije të thellë, do ta themelojmë botën e projektuar të gjithë së bashku si komb e do t'ia arrijmë paqes e qetësisë, ose, për hir të një sërë llogarish dhe interesash të vogla, me një kuptim dhe qëndrim që do t'i bënte të pafrytshme të gjitha vuajtjet e mundimet e hequra, Zoti na ruajtë, do të kthehemi pas e më pas...

Ç'është e vërteta, tema e unitetit dhe e përçarjes është, në ditët tona, njëra prej çështjeve më aktuale që vazhdon ta ruajë rëndësinë e vet. Përtej ruajtjes së rëndësisë në çdo periudhë, kjo temë, në periudhën kur përgatitja sipas një bote të re është e domosdoshme, madje shumë e domosdoshme, është shndërruar në një temë, serioziteti i të cilës vjen duke u shtuar dhe e cila del para të gjitha çështjeve shoqërore. Një antagonizëm dhe përçarje e pakuptimtë, faturën e së cilës populli po e paguan që prej shekujsh, në ditët tona, kur sensibiliteti ka dalë në ballë, ka arritur në përmasa të rrezikshme. Mund të them me shumë lehtësi që, për rilindjen tonë, është e pamundur të përfytyrohet një rrezik më i madh se ky!

Me një strukturë ideo-shkencore mjaft të cekët, me një jetë ndjesore e shpirtërore mjaft të varfër, me një përbërje kuadri e udhëheqjeje të paqenë, shoqëria jonë sot ndodhet në një gjendje për të

ardhur keq. Pa asgjësuar një mjedis si ky të ushqyer prej fanatizmit dhe intolerancës, duhet të jetë mjaft e vështirë të mendohet për bashkim dhe unitet.

Sigurisht, sepse mirëkuptimi dhe marrëveshja janë, para së gjithash, një punë arsyeje e logjike. Është një unitet dhe bashkim zemrash mbështetur mbi arsyen dhe logjikën që mund të qëndrojë e të bëhet jetëgjatë. Mirëpo ç'e do se sot bëhet fjalë për një bashkim dhe vëllazërim më shumë sentimental, i cili është i dobët, i pamjaftueshëm dhe jetëshkurtër. Grumbullimet kundër një grupi të caktuar ose bashkimet mbi bazën e ndjenjave armiqësore, strukturimet e përshkuara nga një gjendje shpirtërore agresive ose viktime janë dallgëzime kalimtare të bashkimeve sentimentale. Një unitet i tillë brenda përmasave tona sasiore-cilësore është, pa asnjë diskutim, i pamjaftueshëm për një komb dhe vend të rrethuar nga të katër anët prej armiqve si dhe, sidomos, i tillë që kurrsesi s'mund të quhet i lejueshëm për nga këndvështrimi i parimeve tona të shenjta, dhe që për më tepër nuk shpreh asgjë për të ardhmen tonë kombëtare.

Atëherë, është jashtëzakonisht e nevojshme që, duke llogaritur edhe faktorët përçarës të jashtëm e të brendshëm, të shtrohen për diskutim pikat tona të përbashkëta që do të përbënin bazë për bashkimin kombëtar, si dhe të ritrajtohet çështja e unitetit në mënyrë të arsyeshme e të logjikshme. Sigurisht, ne kemi nevojë që, duke e rishikuar përcaktueshmërinë e shkaqeve, preteksteve, qëllimeve dhe synimeve, t'i kushtohemi me gjithë zemër një marrëveshjeje të ndërgjegjshme. Ndihet nevoja e ngutshme, madje tejet e ngutshme që uniteti ynë, i cili është gur themeli i lumturisë sonë materiale e shpirtërore dhe tokësore e të amshueshme, të jetë, më e pakta, një bashkim si aleanca anglo-saksone dhe uellsiane.

Edhe nëse nuk arrijmë të realizojmë gjëra të tilla që kërkojnë mendje, gjykim e urtësi, si t'i pengojmë armiqët, t'i bëjmë ata që t'i vënë gishtin kokës e të druhen, të paktën të tregojmë aftësi për të mos rënë në lojën e tyre e për të mos e përgatitur fundin tonë me duart tona! Dhe, në të vërtetë, për këtë jemi të detyruar...

Mendimi dhe botëkuptimi i ndryshëm është rezultat i të qenit i krijuar ndryshe. Kështu ka dashur Krijuesi dhe në këtë ka urtësi dhe mëshirë. Ndërkaq, njeriu është i detyruar që rregullin dhe harmoninë në ligjshmërinë e krijimit, ta sigurojë me anë të vullnetit të vet. Ndërsa në makrobotë sundon imponimi, në botën njerëzore sundon vullneti i lirë në kuadrin e "kushtit elementar". Edhe nëse krijimi i parë është një favor, çdo krijim tjetër pas tij mbështetet në një shkak. Rruga e meritimit të favorit të bashkimit dhe unitetit social kalon nëpër bashkëshoqërimin e ndërgjegjeve dhe tharmimin ndër zemra të bujarisë dhe dashurisë njerëzore. Prandaj, pa u shkullur dhe hedhur nga ndërgjegjjet egocentrizmi si shprehje e dashurisë pasionante dhe adhurimit të vetvetes, politeizmi i tillë si zëvendësimi i synimeve e qëllimeve me pretekstet, mosnjohja e të drejtës në formën e idesë "kur s'kam unë, të mos kenë as të tjerët", brutaliteti i njohjes së të drejtës vetëm tek vetja duke i paragjykuar të gjithë të tjerët si mohues, perversë e mëkatarë, pra, pa u shkullur e hedhur nga ndërgjegjjet të gjitha këto, unë, personalisht, marrëveshjen dhe mirëkuptimin i shoh të pamundura!

Para së gjithash, pranimi si gjë normale e ekzistencës së mendimeve të ndryshme jothemelore, si dhe njohja për të gjithë individët e shoqërisë e të drejtës mbi to, qoftë kjo njohje edhe sa delikatesa artificiale që tregohet ndaj një të huaji, janë të nevojshme e të domosdoshme në vetvete si dhe të detyrueshme për unitetin dhe ekzistencën tonë të shenjtë.

Mbetet të themi se ekzistojnë një sërë faktorësh përçarës që nuk duhen nënvleftësuar aspak, të cilët na e kërcënojnë këtë lloj uniteti të domosdoshëm e të detyrueshëm, pranimi i ekzistencës së të cilëve është shprehje realizmi:

1. Fakti që shërbimet fetare kanë mbetur për një kohë të gjatë pa zot, që pas kësaj kjo detyrë është marrë përsipër dhe kryer nga individë dhe grupe të ndryshme e të ndarë nga njëri-tjetri e

sidomos që ka munguar një lider dhe udhërrëfyes që t'i shkonte fjala te këta individë dhe grupe separatiste, është bërë shkak që çdo grup të zërë e të ndjekë një rrugë të veçantë. Një pjesë e këtyre kanë menduar t'i shërbejnë popullit duke hapur kurse Kurani në çdo fshat, një pjesë duke lexuar libra të përgatitur për rigjallërimin e fesë, një pjesë duke përgatitur kuadro në nivel intelektual, kurse një pjesë tjetër, duke zhvilluar veprimtari politike. Kështu, ata janë në rrugën e shërbimit për fenë dhe atdheun, vetëm se të ndarë e veç e veç...

2. Fakti që secili nga këto grupe e sheh udhëheqësin dhe prijësin e vet si novator, i jep shkak përçarjes edhe nëse ky vështrim është naiv. Sepse, përsa kohë që në ndërgjegjjet e myslimanëve do të ekzistojë konsiderata e novacionit dhe novatorit -dhe kjo do të ekzistojë gjer në kiamet- në periudhat e shtimit të të këqijave kundër fesë gjithmonë do të ketë persona që kanë për të dalë në plan të parë si njerëz të dijes e veprimit, si dhe pasues të tyre. Këta persona të pranishëm në përgatitjen e konstruktit ideo-shpirtëror të masave dhe në fryrjen jetë aspekteve të vdekura të shoqërisë do të quhen novatorë, gjë që, shumë herë, edhe në qoftë e padëmshme për ndjekësit e tyre, ka për t'u shndërruar, në duar të mediokërve e naivëve, në element përçarjeje! Dhe kjo është e pashmangshme!

3. Edhe në institucionin e mehdiizmit mund të bëhet fjalë për të njëjtat specifika që janë të vlefshme për novatorizmin. Besimi mehdiist në kushtet e intrigës së frikshme të kohës së fundit është, si për bashkësinë, ashtu edhe për individin, si një gomë shpëtimi. Sigurisht, në periudhën kur lidhjet besimore të dobësohen dhe praktika të eliminohet plotësisht, ndihet nevoja e një individi të tillë që të gjitha gjërave që ne na duken të pamundura, t'u vërë në çast emrin e duhur! T'i lëmë mënjanë aspektet e saj utopike, kjo nuk është një specifike e kritikueshme as për mendimin naiv. Ndërkaq, nisur nga madhështia e atribuar individit dhe fanatizmi i grupit, bashkësisë, edhe sjellja e përçarjes është fuqimisht e mundur.

4. Veç këtyre, jemi të detyruar të shtojmë në llogari edhe nxitjen nga jashtë të kontradiktave mes nesh. Është fakt se, si një komb që kemi ngritur perandori e që kemi përcaktuar për shekuj të tërë fatin e njerëzimit, kurrë nuk jemi honepsur dot nga fqinjët dhe bashkëkohësit tanë. Të gjitha sulmet dhe luftërat e zhvilluara pothuaj qysh prej një mijë vjetësh, janë shprehje e një armiqësie të ndjekur kundër kombit tonë. Embargot tregtare të identifikuara me embargot e armëve, qëndrimi indiferent i përcaktuar nga aleatët tanë, madje, përballë disa çështjeve tona ndërkombëtare, për më tepër, fakti që vendet perëndimore e shohin shtetin tonë si një shtet të dorës së tretë edhe mes grupimeve, anëtarë të të cilëve jemi, tregon se vendi dhe kombi ynë ende nuk trajtohen miqësisht. Duhet të jesh i verbër të mos dallosh se në shpinë të këtyre qëndrimeve e trajtimeve të dala mbi ujë, janë të pranishme disa paragjykime negative e keqdashëse.

Këto gjëra aspak pozitive, edhe në u dukshin, nga një këndvështrim, normale në marrëdhëniet ndërkombëtare të bazuara në interesa reciproke, janë një fakt historik. Ky fakt, në shpinë të të cilit qëndron, pa dyshim, një mendësi e caktuar, ka ardhur gjer më sot si një fushë preokupimi të vazhdueshëm të shërbimeve informative të të gjitha ngjyrave.

I njëjti rrezik është i dukshëm edhe sot e kësaj dite, i cili vazhdon të veprojë duke ndryshuar cilësi në krahasim me të shkuarën. Po, në të shkuarën rreziku vinte nga jashtë, pra dhe rezistenca ndaj tij dhe përballimi i tij ishin të lehtë. Kurse tani është shtuar edhe rreziku nga brenda. Për rrjedhojë, edhe përballimi është vështirësuar proporcionalisht. Brezat e sjellë, me anë të marrëzive të tilla si morali afetar, morali nihilist dhe morali masiv, në emër të moralit, në një gjendje të tillë që të mos kenë më respekt për vlerat e shenjta pasi imoraliteti, i cili, si një epidemi që e ka përfshirë tërë shoqërinë, t'i shembë të gjitha parimet që e mbajnë në këmbë një shoqëri, u bënë, me shprehjen më të turpshme, viktima të turpërimit ideor dhe shpirtëror. Dhe sot, këta breza as nuk i bien në të, madje, se brenda ç'rremuje rrëqethëse ndodhen!

Është mjaft e vështirë të pretendosh se kjo rrëmuje nuk është reflektuar edhe në pjesën e njerëzve të besimit. Sigurisht, vlerësimi, diku, i botëkuptimit fraksionist, vënia në punë, diku, e natyrave dhe karaktereve, si dhe rrethimi, diku tjetër, i atmosferës etnike, është një specifikë që i duhet kushtuar kujdes po të mos harrojmë se janë momentet të cilave u drejtohen objektivat e jashtëm. Në fakt, nuk ka ndonjë tregues serioz se grupimet që i shërbejnë fesë, kanë rënë nën ndikimin e këtyre faktorëve përçarës, se ushqehen prej tyre e u shërbejnë atyre. Edhe nëse për disa grupe ka pretendime dhe thashetheme të tilla, shenjat se bashkësia e besimit dhe e Kuranit nuk ka për të marrë direktiva nga jashtë, duken të fuqishme. Ndërkaq, është, gjithashtu, evidente se, si rrjedhojë e papjekurisë relative ideo-shpirtërore të grupimeve e bashkësive, mund të ndodhin qëndrime fanatike, gjë që mund t'u hapë rrugën fërkimeve të brendshme. Dhe ky fërkim do të thotë që, pa e kuptuar, t'u bësh shërbim qëllimeve të shëmtuara të armikut!

Qoftë për Turqinë, qoftë për botën islame, për çdo lëvizje që formohet me qëllim shërbimi, rreziqet e mëposhtme janë gjithmonë të pranishme:

1. Vënia në lëvizje e pasioneve materialo-shpirtërore (post dhe popullaritet) të disa individëve të mëdhenj dhe shtytja e tyre në konkurrencë ndaj grupeve të tjera.

2. Ecja dhe veprimi në disa përpjekje të vëna në shesh në emër të Islamit, sipas parimit të shembjes së bashkësive apo grupimeve të tjera simotra.

3. Pritja e fryteve të dijes dhe të virtytit këtu, menjëherë pas përpjekjes apo mundit më të vogël, ndërkohë që vendi dhe koha ku do të arrihen këto fryte, është jeta tjetër e cila konsiderohet një perspektivë e largët.

4. Për ta thyer ndikimin e një kuadri të fuqishëm që pëlqehet e ndiqet me dëshirë, nxjerrja e një grupi të ri kuadrosh si kundërvënie dhe, duke krijuar fërkime të brendshme me anë të kësaj alternative të re, shkrirja dhe konsumimi i një grupimi me anë të copëtimit të brendshëm.

5. Ndërsa ata që i shërbejnë kombit, kanë për parim jetese dashurinë për profesionin dhe punën e tyre, zëvendësimi i kësaj me preokupimin me armiqtësinë ndaj të tjerëve duke eliminuar, kështu, një pretekst të rëndësishëm të orientimit hyjnor.

Si shtesë për këto mund të përmendim edhe faktin që masat, duke u kapur pas ca mendimeve e sistemeve fantastike të cilat nuk kanë mundur ta kënaqnin njeriun tonë, prej të cilave njeriu ynë ka mbetur në një boshllëk ideo-shpirtëror, janë larguar në përmasa të mëdha nga jeta ideo-shpirtërore...

Po, ndërsa njeriu ynë, nga njëra anë, lihej i privuar prej mbështetjes dhe rregullave të botës së brendshme, edhe fakti që, nga ana tjetër, ndodhet i larguar prej linjës së vet kombëtare me anë të motiveve dhe faktorëve nxitës të brendshëm, që një pakicë e lumtur e shkujdesur dhe çakërrqejfe i nxori në skenë për llogari të ndjenjave kafshërore, është një çështje më vete mbi të cilën ia vlen të qëndrohet.

Specialistët sociologë dhe antropologë janë të një mendjeje, se s'njihet të ketë jetuar mbi tokë ndonjë fis i pafe. Gjer tani, në asnjë periudhë të historisë e në asnjë pikë të sipërfaqes së tokës nuk është takuar ndonjë shoqëri e pafe! Ndjenja fetare është e natyrshme dhe e bashkëlindur. Është e qartë se privimi i njeriut nga kjo ndjenjë u hap rrugë një sërë depresionesh individuale e shoqërore. Njerëzimi me zemrën dhe ndërgjegjen të lëna në uri, me siguri që do të kërkojë, sistematikisht apo josistematikisht, sipas vetes, rrugët që do ta kënaqnin këtë uri, duke u përpjekur ta shuajë këtë nevojë të natyrshme. Kurse çështja se për ç'konfuzion do të bëhet shkak një shumëllojshmëri rrugësh të tilla brenda së cilës çdo natyrë do të ketë formuar rrugën e vet, është e hapur për çdo interpretim: anarkia sociale e vlerave dhe, si rezultat i kësaj, një konfrontim i përgjakshëm... Ja, pra,

filozofia e jetës e hedhur në shesh me një natyrë të pambrojtur, dhe ja pra, vatani i shkatërruar ku sundojnë një mijë e një ngatërresa!..

Veçanërisht, krahas gjithë këtij konfuzioni të madh, edhe gjendja e të çoroditurve është një çështje më vete dhe serioze, e vlefshme për t'u përqendruar mbi të. Ka nja dy shekuj që është mjaft e vështirë të kuptosh se ç'thonë e ç'shkruajnë të dashuruarit pas Mehlika Sulltanit, të cilët kur thuhet "vatan", kuptojnë "turanizëm", kur thuhet "komb", kuptojnë "fashizëm" dhe, kur thuhet "fe", kuptojnë "reaksion" dhe "prapambetje"! Karbonarët tanë të çuditshëm e pa pasur asnjë llogari serioze, të cilët një herë e një kohë i patën lidhur të gjitha rrugët me Perëndimin, të cilët qenë ngjitur për pushime në zonat klimatike të Perëndimit dhe patën organizuar udhëtime për në brigjet perëndimore, më pas, me të gjitha fuqitë, nisën ta qëllonjë me breshëri Perëndimin në cilësitë e tij si kapitalizëm dhe imperializëm. Kjo do të thoshte se as oksidentalizimi tek ne nuk ishte si rezultat i një llogarie të caktuar, as dhe kthimi i shpinës ndaj sistemit të tij duke u dhënë pas sevdave të tjera ishte sipas një plani dhe llogarie çfarëdo, por vetëm një dashuri pa shpirt dhe një hap aventuresk...

Si përfundim, mund të themi se, ndërsa shkatërrimi i vlerave fetare e kombëtare në këtë periudhë, nga njëra anë i hapte rrugë përgatitjes së një grupimi ateist e mohues, nga ana tjetër, veprimtaria e disa grupimeve të veçanta të paorganizuara dhe të painformuara për njëra-tjetrën, të cilat, në përpjekjet për plotësimin e një sërë nevojash legjitime, përcaktonin për vete nga një fushë fetare e shoqërore ku kryenin shërbime, i hapi rrugën shfaqjes së shumë bashkësive fetare. Ndërkaq, fakti se herë-herë mes këtyre grupimeve u zhvilluan polemika të ashpra, grindje të rrezikshme dhe konfrontime serioze, është një e vërtetë. Sidomos kur pastërtia shpirtërore dhe singëriteti si esencë e veprimtarisë nuk qenë kuptuar dhe në mes patën hyrë egoizmi dhe pretendimi për monopol të mendimit, konfrontimi pati arritur përmasa të patejkalueshme.

Falënderuar qoftë dora bujare që, në këto kohëra shqetësimesh të mëdha, kur është e vështirë të ruhet edhe ajo që ekziston, na bëri të shohim zhvillime të mëdha e fryte të reja, iu bëfshin fli shpirtrat Zotit tonë që na solli gjer këtu!

Ndjenja e grupimit ekziston në natyrën e njeriut dhe është e natyrshme që të kërkojë të realizohet. Çështja është që këtë ndjenjë ta bëjmë të padëmshme, madje, të dobishme! Kjo ndjenjë e paorientuar kah e mira, shpesh herë zhvillohet në një drejtim të kundërt me interesat e njeriut, me natyrën e tij, duke u bërë e dëmshme si për të, ashtu edhe për të tjerët. Për sa kohë që kjo ndjenjë mbështetet me aspektet e ulëta të njeriut si injoranca, verbëria, fanatizmi, mund të kthehet në çdo çast në një grindje e përleshje të përgjakshme. Nga ana tjetër, gjithmonë ekziston mundësia që, në raport të drejtë me përhapjen e dijes dhe kulturës, mirëkuptimit dhe tolerancës, të sendërtohet një mjedis afrimi e marrëveshjeje, dhe mes grupeve të përvijohet një linjë paqeje. Pandeh se, kështu, brenda krijimit dhe ligjeve të tij, reaksionet tona frenohen pjesërisht, egërsia dhe zemërimi vihen nën zotërim.

Sajimi i kontradiktave me pretekste të parëndësishme pasi drejtësia e kauzës dhe uniteti i qëllimit e i parimeve themelore të jenë të forta, me rrënjë e të palëkundshme, aq sa ta bëjnë dallimin metodik të pandikueshëm, është shprehje e një fraksionizmi fëminor, e mosnjohjes së të drejtës dhe e mungesës së prirjes për të mirë. Duke i mbetur besnik të vërtetës se rrugët që të çojnë te Allahu, janë sa numri i krijesave të Tij, çdo përpjekje në këtë drejtim duhet miratuar, çdo udhëtar i një rruge të tillë duhet konsideruar i çmuar dhe çdo shërbim duhet duartrokatur.

T'i shohësh të tjerët si të zhytur në mohim dhe perversitet ose t'i quash mëkatarë, është një mendësi edhe e padobishme, edhe e rrezikshme. Për mua, çdo njeri duhet të tregojë se cila është rruga e tij, ta bëjë të njohur dhe ta këshillojë atë dhe të jetojë me dashurinë për të. Ky qëndrim, siç është i mençur dhe logjik, është edhe kërkesë e besimit dhe Kuranit. Kështu, çdokush vepron me

dashurinë për rrugën e tij pa ushqyer zili për grupet e tjera. Kritikën e drejtuar atyre nuk janë destruktive, thyese e zemëra. Fitimin e konsideratës nga grupi i vet nuk e sheh në kundërvënien dhe mohimin ndaj një grupi tjetër. Atë e sheh si vëlla dhe nuk ia rrëmon të metat. Kur ia vë re vlerat dhe sukseset, e miraton dhe gëzohet. Shkurt, nuk e heq nga mendja për asnjë çast se bashkë me të gjithë ndodhet në një garë për të mirë dhe se është i detyruar së bashku me ta të bartë një thesar të vyer. Kur të ndodhë kështu, çdokënd që ecën në të njëjtin drejtim, e quan si ndihmës, nderon çdo sukses, duartroket çdo arritje dhe puth çdo dorë ndihme.

Kështu patën menduar njerëzit në Periudhën e Profetësisë të Profetit Muhamed dhe jeta praktike në këtë linjë mendësie pati përparuar. Megjithatë faktorët afrues qenë shndërruar në vetëdije, megjithatë mendësia e vëllazërisë që ngjitur në një nivel shumë të përparuar, nuk qenë prekur aspak dhuntitë e veçanta që përfaqësonin lulet dhe frytet e veçanta!

Konsideratat e veçanta aspak të nënvleftësueshme të një Ebu Dheri dhe Abdurrahman b. Avfi, të një Bilali dhe Osmani (r.a) si dhe pikëpamjet e tyre të ndryshme për hollësitat kurrë nuk qenë paragjykuar.

Mendësia e fisit dhe e gjakut nuk është prekur gjer në atë masë ku diskutohej uniteti social. Po, ashtu si nuk u prek titulli i nderuar i muhaxhirit dhe i ensarit, ashtu dhe fama e fiseve Evs dhe Hazrexh ka mbetur e gjallë përjetë. Duke i thënë, “Ngrihiuni në këmbë Profetit tuaj” fisit të Sa’d b. Muadhrit, është mbështetur tradita njerëzore dhe, duke u çuar në luftë çdo fis nën flamurë të ndryshëm, oxhakët mbrojtës janë djegur për llogari të fitores dhe triumfit të kauzës së përbashkët. Madje, janë mbyllur sytë para krenimeve mes tyre me kusht që të mos kalohet në grindje. Çdo gjë e shfaqur në formën “ata që e mësojnë Kuranin, janë tanët, këta janë tanët, ata janë tanët”, është pritur pothuajse gjithmonë me mirëkuptim dhe, në një kuptim, këto trajtime, për grupin në fjalë që lartësohej me shpejtësi, kanë përbërë një projektim lartësimi.

... Po, që të gjitha këto ekzistojnë, por edhe marrëveshja dhe harmonia ekzistonte. Ashtu si në harmoninë e zërave në një simfoni, çdo njeri që përpigëj të fitonte pëlqimin hyjnor, “këndonte” në përputhje me ritmin e përgjithshëm sepse çdokush ishte i pjekur shpirtërisht, kërkues i së drejtës, i pasionuari i shkëlqimit të gjërave që njihje si të shenjta dhe që kërkonte që traditat të lartësoheshin. Për atë s’kishte aspak rëndësi se kush e bënte a e drejtonte këtë punë. E ç’rëndësi kishte për të, nëse pasi lindte dielli e bëhej mëngjes, i jepej mbretërim a lypësi!..

Ndihmëtarët dhe apostujt e Lindjes së Re kanë për të qenë altruistë të mëdhenj që e kanë harruar lumturinë e vet për hir të të tjerëve dhe ata që, me kënaqësinë dhe lumturinë e mjedisit përreth, do të kenë ngritur në zemra parajsë.

Njëri prej grupeve të kohës sonë dhe, ndoshta, më i rrezikshmi, është grupimi i mbështetur në racën dhe gjakun. Ky është me burim të jashtëm dhe kjo është një e vërtetë kategorike sa asnjë intelektual s’mund ta vërë në dyshim!

Në një periudhë kur grindjet, më në fund, zhvillohen mes blloqesh, kur ideologjitë përplasen me njëra-tjetrën duke përfshirë brenda tërë njerëzimin, dhe kur në botën e kthyer në një fshat të madh, kombet kanë formuar njësi dhe grupe të caktuara, një mendësi e tillë raciste është mjaft e çuditshme. Sidomos trajtimi i njerëzve që ndodhen në të njëjtën zonë e që kanë të njëjtën strukturë sociologjike, në formën e grupeve të ndryshme etnike, është mjaft qesharak dhe, po kaq sa është qesharak, është edhe jashtëzakonisht i rrezikshëm për sa i përket përgatitjes së heterogjenitetit të së nesërme. Është qesharak sepse, në vendin tonë i cili është bërë skenë e afrimit dhe shkrirjes me njëri-tjetrin të fiseve si përfundim i jetesës së përbashkët prej shekujsh, të kërkosh gjënë që i themi “gjak i kulluar”, është si të kërkosh të dish ç’ka në “Levhi Mahfudh”!¹⁰ Mbetet të themi se në veri,

¹⁰Visari i Ruajtur, ku është shënuar gjithçka, që nga fillimi i krijimit e deri në Ditën e Kiametit.

në jug, në lindje e në perëndim, shkurt, në çdo anë të Anadollit tonë ka të vendosur formacione sociale mjaft të dallueshme, dhe brenda secilit prej tyre, grupe të formuara me pretendime racore. Gjithashtu dihet me siguri se secili prej këtyre grupeve ka rënë, me dashje a pa dashje, në këtë situatë qesharake. Atëherë, me thirrjen se përveç përgjigjes pozitive ndaj ftesës gjithëpërfshirëse të zbulesës hyjnore, nuk ka mbetur as zgjidhje e as një mbështetje e përshtatshme tjetër, mund t'i bëjmë zë kështu njeriut tonë: "Lidhuni fort të gjithë pas litarit të Allahut dhe kurrresi mos u përçani dhe të ndaheni!" Ashtu si dje, është e mundur që edhe sot të arrijmë të realizojmë një vëllazërim të tillë! Mjafton që kjo çështje shumë serioze të trajtohet nën objektivin e shprehjes hyjnore dhe sipas parimeve të mendjes e logjikës!

Më në fund, jemi të detyruar që të gjitha çështjet tona t'i trajtojmë, jo mes një euforie ndjenjash dhe emocionesh, por në kuadrin e parimeve tona të shenjta si dhe në formën e një kontrate sociale. Sepse, shfaqja e alternativave të ndryshme të prodhuara nga qendrat e jashtme dhe e një pjese grupesh interesash nga mesi ynë, përveç kësaj, edhe lëkundja e ndjenjës së respektit ndaj qëllimeve e idealeve të shenjta, po kështu, fakti që vendin e çështjes së madhe kombëtare e, lidhur me të, të koncepteve të larta e kanë zënë një sërë llogarish dhe interesash të vogla, e bën të domosdoshme forcimin e lidhjes mes njëri-tjetrit. Dhe kjo bëhet duke hedhur në shesh të gjitha aspektet e përbashkëta e duke bërë drejtpeshimin e tyre me faktorët ndarës. Aspektet e përbashkëta si parimet e njëjta të besimit, uniteti në akt dhe adhurim, pastaj vatani dhe kultura e njëjtë, i njëjti fat i përbashkët, i ëmbël a i hidhur që i kapërcen shekujt, i njëjti armik i jashtëm. Sigurisht, kur të gjitha këto janë elementë më bashkues e unifikues se edhe gjërat më të larta, është e qartë se, para këtyre, elementet që do të kërkonin ndarjen, janë gjëra që s'ia vlen të shënohen!

Në esencë, kjo çështje është trajtuar kështu edhe nga ana e Profetit. Ashtu siç është pranuar dhe përcaktuar Fjala e Dëshmisë, shehadeti, si parimi më i madh, është bërë edhe simboli i paprekshmërisë së çdo individi që e shpreh. Ka shumë ndodhi si zemërimi i rëndë ndaj Usames dhe qortimi i ashpër i tij, përzënia e Muhallemit për të mos e parë më me sy, të cilat e nxjerrin krejt sheshit se ç'është parimi dhe lidhja përparësore sipas Përfaqësuesit të Sheriatit.

Kur çështja parashtrohet në këtë mënyrë, si mund të interpretohet me anë të besimit dhe bindjes pamundësia për t'u marrë vesh e për të mos u afruar me ata që besojnë, që bien në sexhde e që drejtohen kah kibra; akoma më keq, fajësimi i tyre si mohues, perversë e mëkatarë? Më tej, kur ata që veprojnë kështu, të jenë njerëz me ndikim mbi masat, a nuk kemi të bëjmë sa me shkatërrim, aq dhe me mëkat dhe krim? Po, më fatkeqët në çështjen e këtij çekuilibri të përgjithshëm janë imamët, liderët dhe udhëheqësit, një gabim i të cilëve reflektohet në mijëra njerëz për shkak të pozitës së tyre shoqërore.

Mendojmë se është me dobi t'ua kujtojmë edhe një herë të gjithë prijësve, liderëve e udhëheqësve çështjen e riparimit të ndërgjegjes së përgjithshme!

Dashuria t'ju jetë për hir të Allahut, urrejtja, për hir të Allahut, zemërimi, për hir të Allahut! Ejani t'i japim fund, më në fund, egoizmit, sepse ai që e jep veten pas egos, e ka të pamundur t'i bëjë të kënaqur si Zotin ashtu edhe popullin e tij! Ejani t'i duam miqtë brenda përmasave të së drejtës dhe të mos heqim dorë nga bujaria ndaj tyre! Të jemi syçelët ndaj intrigave të armiqve dhe të mos biem në lojën e tyre! Të mos i bëjmë ndryshimet në mendim dhe gjykim, pretekste armiqësie! Në të kundërt, t'i përdorim ato si një pretekst pasurie!..

Duke kujtuar edhe një herë se zemërimi dhe urrejtja nuk kanë zgjidhur gjer tani asnjë çështje, duke besuar se fitorja mbi individët do të vijë vetëm me anë të bindjes, le të betohemi edhe një herë për bashkim dhe unitet!

Thirrja çdo personi që takoni, "Ejani të bashkohemi", sikur të ishit ndonjë apostull bashkimi, është një propozim pa vend. Më tej, sikur duke e bërë këtë ftesë, ta bëni me formën sikur po e ftoni

në grupin tuaj, s' do të shfaqni gjë tjetër veçse një mungesë respekti të tërë, sepse një qëndrim i tillë gjer më sot nuk ka vlejtur për gjë tjetër, veçse për ta ngacmuar edhe te përkrahësit e të drejtës, madje, përparësinë e grupit mbi të tjerët. Përkundrazi, po qe se, kur takohemi me të tjerët, i ngremë lart shërbimet e tyre dhe tregohemi të respektueshëm ndaj udhëheqësve dhe të mëdhenjve të tyre, arrijmë të zbusim edhe tipat më të ashpër!

Është shumë e rëndësishme që, duke e parë gjithësinë me syrin e djepit të vëllazërisë, të kërkojmë rrugën e krijimit të lidhjes me çdo qenie, sidomos të tregohemi ndaj besimtarëve absolutisht të butë e të hapur ndaj difuzionit.

Duhet, gjithashtu, të mos kritikojmë as urtësitë e zbatuara nga dora bujare që na ka drejtuar dhe sjellë gjer këtu. Kush e di, ndoshta do të duhet që tërë bashkësia e cila s'e ka kuptuar ende orientimin, të mbetet edhe për një kohë të caktuar në gjendjen ekzistuese!

Dhe që të gjithë ne, duke e hedhur kritikën mënjanë, të jetojmë pak edhe duke thënë fjalë të mira, miratuese e vlerësuese që edhe Allahu të na ndihmojë!..

Njeriu i shërbimit

Njeriu i shërbimit duhet të jetë i gatshëm e i vendosur që, për hir të çështjes së zemrës, të kalojë edhe lumenj gjaku, dhe kur t'ia arrijë qëllimit, të jetë aq i pjekur sa t'ia japë çdo gjë të zotit, kurse para Krijuesit të Lartë të jetë i respektueshëm e me edukatë!.. Duke përmendur dhe miratuar çdo zë të kushtuar shërbimit për kauzën, duke e vlerësuar çdo individ të çmuar e të lartë, duhet të jetë i ekuilibruar duke i besuar vullnetit të Zotit për të mos i idhujtarizuar personat që do t'i duartrokasë për sukseset e tyre!.. Duke e caktuar para të tjerëve veten me përgjegjësi dhe detyrë për të marrë përsipër një punë të mbetur përgjysmë, ndaj kujt do që vrapon në ndihmë për kapjen dhe ngritjen në këmbë të së vërtetës, duhet të tregohet i matur e i respektueshëm!.. Kur institucionet t'i jenë shembur, planet t'i jenë prishur, bashkimi t'i jetë shpërbërë dhe forcat t'i jenë shkatërruar, duhet të jetë jashtëzakonisht besimtar dhe optimist, kurse kur të jetë ngritur përsëri në këmbë dhe të ketë arritur majat, duhet të jetë i thjeshtë e tolerant!.. Duhet të jetë racional dhe parashikues që ta pranojë qysh në fillim se kjo rrugë është me të përpjeta e tatëpjeta; edhe sikur t'ia presin rrugën humnera skëterrore, madje, duhet të ketë bindjen dhe vendosmërinë se ka për t'i kapërcyer!.. Si dashnori i marrë i çështjes për të cilën ka lënë peng kokën, duhet të jetë aq besnik sa ta flijojë jetën për të dhe të jetë burrë dhe bujar sa të mos i përmendë e të mos kërkojë shpërblim për ato që ka bërë!..

Burrave të këshillës

Profeti ynë ka bërë haxh vetëm një herë, por e gjithë jeta i ka kaluar me kumtesë e këshilla!

* * *

Ata që nuk bëjnë punë shpërblyese për të mirat e dhuruara nga Allahu, thajnë çezmat e veta.

* * *

Disa herë lotët mund të bëhen pretekst për fitimin e shumë zemrave!

* * *

Madhështia duhet kërkuar jo në punët e mëdha e në planet e mëdha, por në synimin nga njeriu të pëlqimit hyjnor dhe në thënien nga Allahu, “Unë jam i kënaqur me ty!”

* * *

Kurrsesi mos e lër ta hedhësh farën kur mblidhen prodhimet se të shkon dëm përpjekja e dy stinëve!

* * *

Është kusht që, kush beson, ta bazojë besimin në veprim. Kur besimi dhe veprimi t’i vënë ndjenjat e personit nën kontroll, te ai fillon të shfaqet orientimi...

* * *

Bëmat tona në arën e Zotit janë si bëmat e personave në arën e shtetit.

* * *

Nëse gabimet që bën njeriu, i krijojnë shqetësim atij, do të thotë se ai njeri është në gjendje ta ndajë të mirën nga e keqja!

* * *

Armiku i suksesit është rehatia, luksi. Suksesi i myslimanëve është vetëm te jetesa e thjeshtë, si komando.

* * *

Nëse keni shumë vezë dhe zogj, mos i fusni të gjithë në një shportë!

* * *

Edhe nëse masat paraprake nuk e ndërrojnë fatin, fundja, e shpëtojnë njeriun së hedhurit gurë fatit!

* * *

Pandehma e mirë është tjetër, pandehma e mirë dhe mosbesimi, tjetër. Përcaktimi i vendit të këtyre është punë e burrave trima!

* * *

E rëndësishmja në kumtesë është që çështja e kumtuar t’i afrohet sinqeritetit dhe të pritët mirë. Askush nuk duhet të përpiqet t’u kumtojë diçka atyre me nivel më të lartë se vetja, sepse mund të bëjë të kundërtën e asaj që synon. Nuk duhet t’i tregojë fëmija të atit, nxënësi mësuesit, çiraku ustait. Fakti që Ebu Talibi nuk e dëgjoi Profetin është një çështje e denjë për të qëndruar mbi të!

* * *

Nëna dhe babai nuk flijohen për asgjë. Por, nëse ata thonë, “Mos i shërbe Islamit!”, nuk u dëgjohej fjala. Por ai që u bindet prindërve me përjashtim të këtij rasti, gjen begati në jetë!

* * *

Besimtari është përfaqësuesi i besimit dhe sigurisë mbi tokë!

* * *

Edhe sikur të ketë të drejtë, njeriu nuk duhet të debatojë me të atin. Ndjenja e madhështisë është e pranishme, pjesërisht a plotësisht, te çdokush. Zemërimi nuk është i pëlqyeshëm, por, nëse

njeriu pajiset me edukatën muhamedane, e mban veten rëndë para armiqve dhe modest para besimtarëve.

* * *

Nëse një botim që është armik i Islamit dhe e sulmon atë duhet lexuar modeomos, të paktën duhet lexuar me vëmendje!

* * *

I keqi që është dhënë pas të keqes, duke u sjellë ndaj njerëzve njerëzisht, mund t'i parandalojë të këqijat e veta. Duhet kujtuar fjala e urtë që thotë "Njeriu është robi i së mirës..."!

* * *

Njerëzit e vegjël për nga vlerat personale mbajnë përreth vetes gjithmonë njerëz të vegjël e pa personalitet, duke menduar se, kështu, do të duken pak më me vlerë.

* * *

Shpesh herë djalli nxjerr nga rruga njerëz që jetojnë pa ndonjë orientim. Personat që nuk këshillojnë për të mirë dhe nuk ndalojnë të keqen, mbeten të privuar prej zbulesës hyjnore. Tek këta, kurrsesi nuk mund të ketë frymëzim. Mund të shkruajnë libra, por gjërat që shkruajnë, janë të errëta, pa bereqet. Janë ata që këshillojnë për mirë dhe pengojnë të keqen, të cilët përfitojnë gjithmonë prej frymëzimeve hyjnore. Prandaj ne do të lexojmë, do të mendojmë dhe do të përpiqemi t'i tregojmë çdokujt diçka në mënyrë që të mbetemi shpirtërisht të gjallë!..

* * *

Shqetësimi i çdo udhërrëfyesi në këto kohë duhet të jetë vetëm pëlqimi i Allahut; asnjë mendim dhe ndjenjë materiale nuk duhet të përbëjë synim për të. Ai duhet të mendojë kështu: "Po qe se një ditë rruga ime do të arrijte në Xhenet, do të desha që edhe atje të gjeja një fytyrë të njohur që t'i flisja për të drejtën dhe të vërtetën!" Ja, pra, portreti ideor i njeriut ideal të kauzës për të cilin ndjejmë nevojë në kohën tonë!

Besimi i më të lartëve

Ta mbajmë idealin tonë të shërbimit për njerëzimin për hir të Allahut mbi çdo lloj dëshire materiale e egoiste, ta vëmë atë para çdo kërkesë, të jemi të vendosur, pas gjetjes dhe mësimi të së vërtetës, për të sakrifikuar të dashurit dhe çdo gjë që na e do zemra, t'i hapim rrugët që çojnë në lumturinë e brezave të ardhshëm duke u vënë gjoksin, në emër të idealit tonë të lartë, ngjarjeve më të papërballueshme, të jetojmë për lumturinë e të tjerëve duke u zhveshur prej të gjitha kënaqësive materiale e shpirtërore, të rrimë larg prej luftës për pozitë dhe dëshirës për përfitim duke u nisur nga filozofia "të parët në shërbim e të fundit në shpërblim", janë synimet e ekzistencës sime nga të cilat nuk do të heq dorë kurrë!

* * *

Ashtu siç ndodh që, për shkak të pozitës, çdo lloj vetie e shprehie e mirë e atyre që ndodhen në krye të një aksioni apo lëvizjeje, duke u shumëfishuar, do t'u reflektohet atyre që ndodhen pas a u shkojnë pas, ashtu edhe ndodh që shprehitë dhe sjelljet e papërshtatshme, duke i larguar pasuesit nga origjina, mund t'i kthejnë ata në shpirtra të mjerë dhe imitues të zvetënuar të një bote tjetër...

Therorët e dashurisë

Botët e ndriçuara e të lumtura të së ardhmes do t'i ngrenë vetëm heronjtë e dashurisë, me zemrat ngritur peshë nga dashuria. Heronjtë e dashurisë me buzë të qeshura nga dashuria, me zemrat të gatuara me dashuri, me vështirimet të mbushura me dashuri për njeriun, heronjtë që marrin mesazhe dashurie nga diejt që lindin e perëndojnë, nga yjet që ndizen e shuhën...

* * *

Edhe zemërimi dhe tërbimi madje i therorëve të dashurisë të cilët e kanë përshtatur veten ndaj mjedisit duke marrë si masë dashurinë, meqë paraqesin seriozitet dhe dashuri sepse kanë veprim rregullues e drejtues, konsiderohen gjithmonë sendërtues e të dobishëm.

Qëllimi dhe mjeti

Në çdo hap dhe në çdo punë në fillim duhet përcaktuar qëllimi dhe synimi në mënyrë që njeriu të mos kapet e pengohet nga pretekstet. Po që se në shërbimet për kombin nuk i jepet shpirtit orientim, e nuk i tregohet synimi, mendimet kthehen në vorbull, kurse ata që shërbejnë, bien viktimë e tyre...

* * *

Në platformën e mendimit, qëllimi dhe synimi duhet të zënë gjithmonë vendin e parë, vendin e shquar, ndryshe, shkohet në një shumëllojshmëri çështjesh të barazvlerësuar dhe bihet në hutim. Sa e sa nisma tërheqëse ka që kanë mbetur shterpë për shkak të konfuzionit të qëllimeve e mjeteve, që jo vetëm nuk kanë arritur asnjë rezultat të dobishëm, por kanë lënë pas veç urrejtje e neveri.

* * *

Në perspektivën e çdo njeriu të lëvizjes e aksionit, Krijuesi i Lartë dhe pëlqimi i Tij duhet të zënë vend para çdo gjëje tjetër! Ndryshe, mund të shkohet në hyrjen në mes të idhujve të ndryshëm, në dukjen e gënjeshtërs si e vërtetë, në maskimin e dëshirave e pasioneve si ide dhe në kryerjen e krimeve në emër të fitores...

* * *

Grimca e punëve të bëra orientuar kah pëlqimi i Zotit ka vlerën e një dielli, pika, vlerën e një deti dhe çasti, vlerën e përjetësisë... Në është kështu, edhe sikur botët, në një rrugë të papëlqyeshme për Të, të kthehen në parajsë, e kanë vlerën zero dhe janë një mundim në kurriz të të zot. Vlera e preteksteve dhe mjeteve është në përpjesëtim të drejtë me atë se sa afrojnë ato në qëllimin e caktuar dhe me saktësinë dhe mungesën e defekteve në këtë afrim. Prandaj, pretekstet që nuk afrojnë apo çojnë në qëllimin e përcaktuar, për më keq, që bëhen pengesë në këtë rrugë, janë konsideruar të mallkuara, të mangëta në mëshirën hyjnore. Edhe mallkimi i rënë mbi botën për këtë është, sepse bota në vetvete, si pasqyrë e mijëra shfaqjeve të Emrave Hyjnorë e si një ekspozitë e shkëlqyer, e vlen edhe të duhet, edhe të duartrokitet!

* * *

Ekzistojnë lloj-lloj rrugësh dhe pretekstesh e mjetesh për ta kapur e ngritur në këmbë të vërtetën. Këto rrugë janë të vlefshme me aq sa e zhvillojnë më tej idenë e së vërtetës dhe respektin për të. Nëse një shtëpi siguron harmoninë mes atyre që strehohen në të, nëse në një faltore të bashkësia që mbledhet nën kubën e sajtharmohet ideja e pafundësisë, dhe nëse një shkollë u jep krahë nxënësve të saj duke u ushqyer besim dhe shpresë, do të thotë se e kryen detyrën e saj si pretekst dhe mjet, për rrjedhojë, është e shenjtë. Në të kundërt, të gjitha këto janë nga një kurth shtrigan më vete që ia kanë prerë rrugën njeriut. Po kështu edhe shoqatat, fondacionet apo partitë politike!..

* * *

Çdo themelues institucioni të vogël a të madh duhet ta kujtojë shpesh qëllimin e themelimit të atij institucioni në mënyrë që puna të mos shmanget nga qëllimi i vet dhe të jetë e frytshme. Në të kundërt, çerdhet, shkollat, konviktet me qëllimin dhe synimin e themelimit të harruar, krejt ashtu si njeriu që ka harruar qëllimin e krijimit të vet, ecin në një vijë me kahje të kundërt me synimin e vet, pra pse jo, në dëm të vet...

* * *

Monopolizimi i idesë dhe vështrimi i së vërtetës vetëm në anën e vet, janë shprehje pretekstualiteti dhe mungese synimi. Nëse neveria dhe urrejtja e ndjerë për njerëzit që kanë të njëjtat ide dhe ndjenja, s'janë si pasojë e mungesës së kuptimit mbi synimin dhe qëllimin, ç'janë? Eh, ata që mendojnë ta qeverisin gjithësinë sipas gjeometrisë së tyre të prishur, s'janë veçse krijesa të mjera, skllevër të egos që ai s'pranon t'i çlirojë...

Këshillimi

Këshillimi është një rrugë e rëndësishme për t'i përfutur pakufishmëri mendjes së kufizuar dhe mendimit të kufizuar!

* * *

Nuk ka shtet të pasur dhe ushtri të fortë sa këshillimi!

* * *

Për sahabët, shokët e Profetit, thuhet: "Punët e tyre ata i kanë kryer duke u këshilluar mes tyre!" Kështu, për lavdërim, ata përmenden jo për attribute të tjera, por për këshillimin!

* * *

Ai që është edhe disa hapa më tej më i mençur se i mençuri, është ai që u jep vlerë edhe mendimit të të tjerëve!

* * *

Këshillimi është pastruesi më i dobishëm për ta kthyer ndryshkun në mendim!..

* * *

Nëse dy mendje janë më të dobishme se një mendje, qindra mendje janë më të tepërta se një mendje. Ja, pra, këshillim do të thotë të bëhen bashkë shumë mendje.

* * *

Ata që nuk u drejtohen mendjeve të të tjerëve se u besojnë mendjeve të veta, edhe sikur gjeni të jenë, konsiderohen jo të mençur sepse kanë hequr dorë prej këshillimit që i përfton gjykimit një thellësi të rëndësishme!

Maturia

Maturia është një qëndrim me rëndësi përballë mundësive të dëmtimit në një punë ose hap, një qëndrim me vlerë për të mos rënë në qarje e rënkime prej fatkeqi. Ka sa e sa nismëtarë që, për shkak të mospërgatitjeve paraprake të duhura, në fund ose rrahin gjuhën, ose i hedhin gurë fatit. Kështu, ata bëjnë dy gabime: e para se nuk marrin masat e duhura, e dyta, se, pastaj, kritikojnë fatin!

* * *

Sa i madh të jetë rezultati i vënë si synim në një nismë apo hap, po aq i rëndësishëm është edhe respektimi i masave që duken të domosdoshme për atë qëllim. Për rrjedhojë, po qe se një person nuk e rregullon punën duke llogaritur edhe fitimet me humbjet në atë masë sa ç'është përgjegjësia që ka marrë përsipër, ai është ose një aventurier, ose një trashaman naiv. Hapi i bërë prej kokëtrashëve të tillë është më i dëmshëm se pasiviteti i tyre!

* * *

Masat dhe maturia janë një kapital i madh për njeriun në përpjekjet për të arritur atë që shpreson. Kurse plogështia ose nënvleftësimi më i vogël që tregohet në këtë drejtim, është një nga gabimet e mëdha që në përfundim bëhet shkak për fajësime. Njeriu i mençur është ai që pa dalë ende në shesh të metat e mundshme, gjen zgjidhje për t'i mënjeluar ato, duke i vënë gjërat nëpër vendet e veta. Të parët tanë kanë thënë: "Duhet ta kapësh hajdutin para se të të kapë ai ty!" Ndryshe, do të rrish e të fajësosh sa hajdutin, sa fatin!..

* * *

Çdo punë njeriu duhet ta nisë me një plan dhe masa paraprake. Kurse, si përfundim, duhet pa tjetër të ruhet prej gjërave që nuk premtojnë ndonjë vlerë dhe dobi materiale-shpirtërore. Çdo nismë e marrë pa i pasur parasysh të gjitha këto, është një kotësi, dhe preokupimi me kotësira është provë e papjekurisë mendore dhe fëmijërisë së personit.

* * *

Forcën dhe vlerën e vet, njeriu e provon dhe e vë në shesh me anë të sukseseve të arritura përmes provash të vështira dhe kushtesh të papërshtatshme. Kurse suksesi në shërbimin e kryer në kushte të rënda varet para së gjithash prej hartimit të një plani dhe, pastaj, veprimit sipas tij. Sipas kësaj, forca dhe vlera e një njeriu është në përpjesëtim të drejtë me sukseset e tij, kurse sukseset, me vendimet e marra para këtyre nismave.

* * *

Ashtu si maturia është krejt e ndryshme prej frikës dhe ngurrimit për të vepruar, ashtu edhe veprimet e pakontrolluara s'kanë asnjë lloj lidhjeje me guximin dhe trimërinë. Ndërkaq, teprimi në maturi mund të sjellë disa dëme, por këto pa diskutim që janë lokale dhe të riparueshme. Kurse veprimet spontane dhe sjelljet donkishoteske të atyre që e quajnë mungesën e maturisë dhe kontrollit, trimëri, janë kurdoherë të rrezikshme e të dëmshme në mënyrë të riparueshme!

* * *

Ashtu si çdo shprehi e keqe, edhe dalja për gjuetinë e masave po me shpirtin e masës që është thjesht një gënjeshtër e mashtrim, është ndër gjërat që na ka lënë si dhuratë Perëndimi. Edhe nëse sipas atyre që e kanë bërë të vetën këtë ide të çalë e të pafisme, çukitjet mbi lëvizshmëri e vezës duken normale, sipas nesh, çdo çështje kombëtare duhet të lëvizë përmes durimit dhe heshtjes së një midhjeje margaritari, nëpër një linjë të përshtatshme me gjendjen e mundimshme por të pazë të midhjeve të margaritarëve të fshehura në skajet më të heshtura të fundit të detit.

* * *

Vlera e lartë e njeriut para Zotit matet me vlerën e përpjekjeve të tij, kurse shenja më e qartë e vlerës së lartë të përpjekjes është te flijimi i kënaqësive dhe i lumturisë personale në emër të lumturisë dhe kënaqësive të të tjerëve. S'e di, a mund të përfytyrohet për njeriun sakrificë më e madhe se nëpërkëmbja e dinjitetit dhe nderit personal për hir të të mirës së shoqërisë, se aftësia për të duruar duke gëlltitur zemërimin edhe atje ku duhet bërë titull me të madhe, dhe se prangosja i dëshirave vetjake gjithkund ku bëhet fjalë për lumturinë personale?

* * *

Ashtu siç është mungesë mençurie t'i shohësh të gjitha sukseset e ushtrive fitimtare te guximi për të sulmuar dhe të mos u kushtosh rëndësi planeve ushtarake, po ashtu është mendjetrashësi t'i lidhësh të gjitha fitoret me guximin për guxim duke mos u dhënë vlerë masave paraprake.

* * *

Edhe nismat, ashtu si masat e marra për to, janë nga një ftesë paraqitur favorit hyjnor dhe, në të njëjtën kohë, identiteti i dy fytyrave të një të vërtete. E meta e shfaqur në njërin prej këtyre mund t'i japë shkas shpesh ndërprerjes së favorit dhe, për rrjedhojë, mospërfundimit. Kurse rruga dhe ecja pa të meta e defekte është e mundur kurdoherë me anë të parashikimit. Lum për ata që e kuptojnë këtë!

Durimi

Durimi është si një bar që i pushon dhimbjet: edhe të djeg, edhe të kuron.

* * *

Çdo shqetësim është i mbarsur me një lehtësim, vetëm se duhet bërë durim në barrë.

* * *

Suksesi, nga njëra anë dhe durimi me qëndrueshmëri, nga ana tjetër, janë binjakë edhe nëse kanë pamje të ndryshme!

* * *

Detet formohen prej pikash dhe askush nuk ka fuqi ta rrudhë kohën kur pika shndërrohet në det!..

* * *

Maturia është rruga më ideale e realizimit të dëshirës.

* * *

Gabimi është gjëja që gjendet më tepër në përbërjen e ngutjes.

* * *

Rruga për t' u ngjitur në maja nis nga lugina... Sigurisht, për ata që bëjnë durim.

* * *

Nëse ka një gjë që ta ketë fillimin të hidhur e fundin, mjaltë, ajo është durimi.

* * *

Emri i qëndrimit pozitiv para ndodhive është durim. Prandaj njerëzit e Zotit e kanë quajtur të justifikuar kërkimin e durimit pa i ardhur koha!

Jo zemërim, por qëndresë!

Ndërsa përreth ishte ende gjysmerrësirë, ti ishe i pari që lajmërove përreth mesazhet e Zotit! Edhe sikur ata që nuk e njohin vlerën, të mos e dinë këtë, qielli e dheu janë dëshmitarë! Kujdes, mos u bëj kritikues duke parë si veprojnë ata që s' dinë si duhet sjellë! Edhe sikur të mos ta vlerësojë populli shërbimin që bëre, a e di Zoti? Ç' të duhet më?..

* * *

Ti e bëre atë që ta kërkonte karakteri dhe tashmë rreth teje lule ka... Kur ke përreth kaq trëndafila që hedhin shtat e rriten, e pse ankoresh për një tre a katër gjemba? Dhe sidomos nëse kjo mungesë mirëndjellsie është reaksion ndaj një të mete dhe mangësie në përgatitje?..

* * *

Për një zemër të dashuruar pas të Vërtetit, kërkimi në këtë botë i shpërblimit të shërbimeve të bëra a nuk është një sjellje foshnjake? Dhe, a nuk janë kjo botë dhe gjërat e saj të vdekshme e të përkohshme, kurse ahireti, me atë bukuri dhe shkëlqim marramendës, i përhershëm? Atëherë, në është kështu, eja! Dhe hiq dorë nga kërkesa për shpërblimin e përpjekjes sate në rrugën e të Zotit! Jeta përtej dhe përtej saj e vlejë të shkëmbehen me këtë botë!

* * *

Edhe sikur të jetë e drejtë, nuk duhet ta quash shenjë madhështie vetjake konsideratën e popullit ndaj teje, pra, të mos mbahesh pas pozitave që jep opinioni i mirë! Për më tepër, në asnjë mënyrë të mos biesh në naivitetin për t' i parë të tjerët më të vegjël se veten! Sepse vlera para Zotit matet me pastërtinë e shpirtit dhe lartësinë e zemrës. Ç'fatkeqësi e hidhur është vlerësimi i gjërave materiale, shtypja dhe dërrmimi i mishit të mbetur nën gërmadhat e kockave!..

* * *

Edhe pse ndjenja e respektit ndaj të mëdhenjve është parim, nuk duhet kërkuar vetë. Ndërsa respekti i të tjerëve ndaj teje është i padëmshëm kur vjen vetë, pa e kërkuar dhe pa e pritur, bëhet si një e dashur e paarritshme kur dëshirohet dhe i shkohet pas, duke e lënë njeriun në vuajtje e mjerim!..

* * *

Nuk duhet të mbështetesh te fakti që populli të shohë të madh duke e shfaqur një gjë të tillë, nuk duhet t' i besosh kësaj! Edhe nëse një konsideratë e tillë quhet e mirë duke e menduar si një reflektim të "mirëtrajtimit" të të përtejquajve, nuk është diçka që duhet dëshiruar. Edhe nëse për një

çast i jep kënaqësi njeriut, shpesh e bën të qajë e të rënkojë. Pra, nuk duhet ta nxish zemrën duke u mashtruar nga komplimente të tilla kalimtare!..

* * *

A ke menduar ndopak se, krahas zgjerimit të shërbimit tënd dhe në po atë masë, do të viresh në provë si nga armiqtë, ashtu dhe nga mjedisi yt? Mendo! Dhe tregohu bujar ndaj miqve, të cilët përdoren si elemente prove në dorën e Zotit!

* * *

Kujdes, mos e bëj veten të neveritshëm për mjedisin duke pretenduar për shërbimet që i ke bërë kombit, si dhe duke ua përplasur sysh atyre që ke nën vete shërbimet që u ke bërë! Mos harro se ç'ke bërë, janë një detyrë, kurse ti, një i ngarkuar me përgjegjësinë e saj!

* * *

Nëse nuk je i përkorë e i përlur si dhe në linjën e “njohjes së ndëshkimit dhe favorit si një e vetme” në raport me librat që ke lexuar, me çështjet mbi të cilat ke menduar dhe analizuar dhe me përpjekjet në rrugën e Zotit, mendo se në çdo hap ke për t'u shtrënguar nën kthetrat ngjyrëgjaku të egos, prandaj rrëqethu!

* * *

Kurrë mos më hap mua diskutime për madhësinë e shërbimeve që ke bërë, për sakrificat e mëdha që ke treguar! Po qe se mundesh t'i shohësh veprat e tua si pasuri të përbashkët, si një favor hyjnor caktuar për zellin e shokëve të tu, po qe se mundesh të jesh i pari në sakrifica e i fundit në pretendime, të lutem, për këtë më fol! Për këtë më fol që fjala jote sheqer-sherbet të ma zbukurojë zemrën!

* * *

Me fjalët “dituria ime, nderi im” të këngës së egos mos i kënaq armiqtë e mos i mërzit miqtë! Po pate meritë, lëre të çelë lule për botën tjetër, të hapë sythe! Heroizmat e jetës sate, po pate, le të mbeten si këngë të përjetshme në buzë të engjëjve!

Kthimi dhe qëndresa

Sa ç'është e rëndësishme ta gjesh të vërtetën e t'ia japësh zemrën asaj, po aq e rëndësishme është t'i mbetesh besnik, pastaj, dhe të tregosh qëndresë në rrugën e saj e të gjitha këto janë një çështje mbi të cilën ia vlen të qëndrohet. Kështu, nuk mendohet që dikush, shpirti i të cilit është ndriçuar nga e vërteta, të ndërrojë aq lehtë rrugë dhe drejtim! Sa për ata që ndërrojnë altar mëngjes e mbrëmje, pa pushim, janë ca të pafat që nuk kanë mundur ta gjejnë të vërtetën ose ca të pamend që s'kanë mundur ta rrokin vlerën e saj!

* * *

Fatmirët që i kanë bërë zemrat breg për oqeanin e të vërtetës, i tresin në gjoks dallgët e ardhura nga ai oqean me një dëshirë dhe etje që s'di të shuar dhe thonë: “A ka më”? Këta janë njerëz që kanë mbaruar së kërkuari, që e kanë gjetur altarin e vet dhe që i kanë qetësuar shpirtrat. Sa për ata që lëkundën pa pushim si dallgë sa andej-këtej, ose janë një sërë foshnjarakësh që nuk e njohin mënyrën e kërkimit, ose ca të patru që i ngatërrojnë kërkimin me gjetjen. Gjejnë vetëm ata që

kërkojnë, kurse ata që s'kërkojnë, bëjnë vendnumëro. Kurse të hutuarit që kujtojnë se kanë gjetur diçka, vërtiten tërë jetën rreth një gjëje pa mundur të kuptojnë, më në fund, diçka prej saj!

* * *

Mbrojtja e pozicionit është shkak më i parë i përmbysjes së armikut dhe i arritjes së objektivit. Kurse ata që e braktisin frontin dhe ndahen, quhet se kanë hyrë në rrugën e humbjes qysh në çastin kur janë ndarë!

* * *

Çdo dezertor e ka dënuar veten së pari para ndërgjegjes së vet, pastaj para historisë dhe brezave të ardhshëm, për rrjedhojë, quhet se ka ngrënë një pëllëmbë në kundërshtim me qëllimin e vet. Në çdo kauzë të lartë, qëndresa në ruajtjen e frontit është shenjë burrërie. Edhe nëse robërit e papenduar të egos, të cilët kthehen nga fryn era, nuk e kuptojnë dot këtë ose nuk duan ta kuptojnë, njeriu që është njeri, pasi ta ketë kuptuar një herë të vërtetën, interesi nuk arrin ta lidhë dot me zinxhirë, frika nuk mund t'ia presë udhën e ta pengojë, epshi nuk mund t'i dalë përpara! Ai i kapërcen të gjitha këto!

* * *

Në një shërbim, ata që ndërrojnë mendim dhe vend pa prà, jo vetëm që e trondisin ndjenjën e besimit dhe sigurisë karshi vetes, por edhe janë bërë, për shokët e kauzës, gjithmonë zhgënjyes. Ashtu siç ndodh që dalja nga radha e një anëtari të një njësi që ecën me radhë të shtrënguara e me gëzim, e prish ritmin duke shkaktuar çrregullim, ashtu edhe shkëputja dhe largimi i ndokujt prej kuadrit të lidhur me një qëllim, shkakton ndër shokë e miq lëkundje, thyerje e pesimizëm, kurse ndër armiq, gëzim!

* * *

Ata që, duke e prishur shpesh betimin, bien në pavendosmëri, vjen dita që, duke e humbur ndjenjën e besimit të të tjerëve ndaj vetes, hyjnë, dalëngadalë, në ndikimin e një pale tjetër. Këta shpirtra paralitikë, që e humbin me kohë tërë personalitetin e vet, kthehen, më në fund, në elementë të dëmshëm si për vete, ashtu dhe për bashkësinë ku marrin pjesë!

* * *

Ata që sot ndodhen të shtypur nën peshën e llogarive të vogla dhe që janë kapur pas gjërave të tilla si posti, pozita, popullariteti, epshi, etj., nuk e di, ç'kanë për të bërë ato ditë kur interesat do të na e rrethojnë horizontin si ylber, kur frika dhe ndrojtja do të na i pranojnë vullnetet?..

* * *

Historia e njerëzimit është e mbushur plot me ngjarje që tregojnë se kalatë dhe qytetet janë marrë me gjakun e mijëra trimave e heronjve, kurse, shpesh herë, janë humbur përgjithmonë vetëm nga sjellja laramane e një tradhtari apo burracaku...

* * *

Ah, ti famë kriminele, ti epsh i pabesë, ti pangopësi burracake!.. Sa e sa shpirtra u zvetënuan vetëm me një takim me ju! Sa e sa zemra u thanë në klimën tuaj, porsi drurët që u bien gjetet në vjeshtë! Dhe sa e sa të tjerë, të hutuar prej gajasjeve tuaja të neveritshme, ikën prej falthesë për të ndjekur rrugën e pijetores!.. Po, trimat e rënë në atmosferën tuaj, u qullojnë kokat e mëdha humbën në botën tuaj të vockël!..

Besimtarinjë herë gënjehet

Çdo ideal sublim dhe ide e lartë marrin jetë në një mendim sistematik dhe në një plan të shëndoshë, gjejnë përkrahës dhe disa herë në ditë kthehen në një altar që i buzëqesh fatit të të zotërve të tyre. Kurse mendimet dhe kauzat që nuk e gjejnë dot këtë mbështetje dhe konditë, vdesin e shkojnë ende pa lindur mirë...

* * *

Kurrsesi nuk duhet ngritur ndonjë konkluzion ose çështje mbi baza, fuqi dhe alternativa të paqëndrueshme, ekzistenca apo mosekzistenca, sendërtimi apo shkatërrimi i të cilave nuk na përkasin neve. Ata që e kanë lidhur pas këtyre realizimit të idealeve të veta, gjithmonë janë gënijer, ata që e kanë ngritur të ardhmen mbi to, kanë mbetur nën gërmadhat e gjërave të ngritura me dorën e vet, janë shtypur e kanë shkuar...

* * *

Në një kauzë, lartësia e idealit, saktësia e mendimit dhe planit, singëriteti dhe qashtërsia e individëve që e përfaqësojnë atë kauzë janë elemente shumë të rëndësishme. Ndërkaq, edhe zgjedhja e shkaqeve për një çfarëdo punë të projektuar dhe funksionimi i tyre sipas rezultatit të pritur, janë të rëndësishëm po në të njëjtin nivel. Ata që nisen për udhë me shkaqe të paprovuara se çojnë në përfundimin e kërkuar e të papërcaktuara nga një organ i lartë, jo vetëm do t'i lënë të zhgënjyer ata që janë lidhur pas tyre, por edhe vetes do t'i bëjnë dëm!

* * *

E vërteta duhet mbështetur prapë në të vërtetën dhe duhet kërkuar në rrugët më të drejta. Kërkimi i të vërtetës në kushte ku nuk njihet mendimi mbi të vërtetën, është padituri, kurse ndjekja në atmosferën e shkaqeve të shtrembra është vetëmashttrim!..

* * *

Mbi mendimin dhe mekanizmat negative nuk mund të ngrihen gjëra pozitive. Vendi i pozitivës brenda negativiteteve duhet të jetë si ecja mes boshllëkut të dyerve rrotulluese. Ecja nuk duhet të ndërpritet, duhet ecur e kaluar pa ngecur gjëkund!..

* * *

Të vërtetat e përgjeshme nuk lidhen pas gjërave kalimtare e të ndërrueshme. Ç'të jetë ndërtimi i ngrehinave më jetësore mbi një ishull që noton e ikën, e njëjta gjë është edhe shërbimi duke u lidhur pas sistemeve, administrimi dhe drejtimi i të cilave është në duar të forcave të ndryshme!

Antagonizmat

Ti mendon të arrish esencën tënde duke u purifikuar në ndjenjë dhe mendim, të përsosesh duke u dhënë zhvillim aftësive të tua njerëzore; po si mund të bëhen këto pa u zhveshur nga kënaqësitë trupore-materiale, pa ngritur krye ndaj dëshirave shtazore?

* * *

Ti dëshiron të arrish "njësimin" në jetën tënde ndjesore dhe të zhytesh e të përumbesh në kënaqësitë shpirtërore; po si do të bëhet kjo, kur brenda teje vërtiten një mijë e një të këqija e kur ti, në çdo kthesë, u thua "po" kënaqësive trupore?

* * *

Ti përfytyron të marrësh krahë për t'u ngjitur e për të arritur në botët përtejqiellore; po si do të bëhet kjo nëse ti, si një fëmijë që luan me baltë, mbetesh i mbërthyer në baltovinën e kësaj bote?

* * *

Ti pret pa prà shfaqjen e agimeve të reja në horizont; po si do t'i shohësh ti agimet e reja pa e pajisur zemrën me ideale të larta, pa u vërsulur e marrë sërish vendin tënd të vjetër e pa u bërë një klithmë mu në zemër të botës?

* * *

Ti kërkon t'u japësh zgjidhje problemeve të grumbulluara një mbi një prej shekujsh; po si do të bëhet kjo nëse nuk ke shpresë e qëndresë për të luftuar e pritur në këtë rrugë për shekuj të tërë?

* * *

Ti bën fjalë për lartësimin e vatanit, për lumturinë e njerëzve tanë; po si do të bëhet kjo pa u dhënë krahë brezave me besim, arsim e kulturë, në mënyrë që t'u hidhen sipër e t'i përmbysin të gjithë djajtë?

* * *

Ti ke mall për të ekzistuar si ta do zemra dhe për të marrë kënaqësi nga jeta sipas botës sate ndjesore; po si do të bëhet kjo nëse ti nuk ngul këmbë për këtë pa e prishur agjërimitin gjer në perëndim të diellit?

* * *

Ti dëshiron të jetosh i lirë, i pavarur e krenar në krah të të gjithë popujve të tjerë; po si do të bëhet kjo nëse s'e hedh tutje mediokritetin që të ka mbuluar?

* * *

Ti shpreson dhe pret të ndodhesh pa pra në sy të të tjerëve, në zemrat e të tjerëve, që të të duartrokas in e të të ngjitin në qiej; po si do të bëhet kjo kur ti njëqind herë në ditë e prish betimin që ke bërë?

* * *

Ti e sheh veten të patëmetë dhe kërkon që çdokush kështu të të shohë; po si do të bëhet kjo me gjendjen tënde mes shoqërisë që ngarkon mbi supe çdo ditë një mijë e një mëkate të reja ndërsa ti s'bën dot asgjë?..

Mendimi për të shërbyer

Ç'ndryshim ka jeta e jetuar pa pasur si objektiv shërbimin ndaj njeriut tonë, nga jeta e egër ku vërtiten një mijë e një pasione të verbra?

* * *

Duartrokitja e çdo lëvizjeje në kahun e së drejtës e të së vërtetës, është shprehje respekti ndaj së vërtetës. Ata që e shohin të vërtetën të posaçme vetëm për vijën e tyre, më besoni se, jo vetëm që, pa shkuar shumë, do të izoloohen me duart e veta, por edhe në konceptimin e së vërtetës do të lëkunden vazhdimisht pa arritur dot një konkluzion përfundimtar!

Përfaqësuesi i çdo niveli

Në çdo nivel qoftë, për përfaqësuesin e saj janë kusht drejtësia, garancia, vetëdija e detyrës, aftësia njohëse e lartë sipas nivelit, vetia për ta parë dhe parashikuar të ardhmen të lidhur me të sotmen dhe jetesa e virtytshme pavarësisht nga çdo gjë. Humbja e njërës prej këtyre karakteristikave është, për një administrues e drejtues, një e metë serioze si dhe fatkeqësi për ata që përfaqëson!

Uniteti brenda-jashtë

Ata që ngrihen të shtrojnë botën, së pari duhet të shtrojnë veten. Sigurisht, në fillim duhet ta mbajnë pastër botën e tyre të brendshme nga urrejtja, neveria dhe zilia, kurse botën e tyre të jashtme, nga të gjitha llojet e sjelljeve të këqija në mënyrë që të bëhen shembull për të tjerët! Sado të shkëlqyera të jenë mesazhet e ofruara nga njerëz që nuk kanë mundur ta kontrollojnë botën e tyre të brendshme, nuk kanë mundur të luftojnë me egon e vet dhe nuk kanë mundur të fitojnë mbi botën e tyre ndjesore, nuk do të mundin të zgjojnë emocione në shpirtrat; edhe në zgjofshin, nuk do të mund të lenë mbresë të gjatë.

Shpirti ideal

Ata që vrapojnë në rrugën për t'i ndriçuar njerëzit, ata që përpiqen vazhdimisht për lumturinë e njerëzve, ata që u zgjasin dorën njerëzve të rënë në greminat e ndryshme të jetës, janë shpirtra të lartë që e kanë njohur veten, të cilët, si engjëj mbrojtës të shoqërisë mes së cilës jetojnë, përfyten me fatkeqësitë që u bien sipër shoqërisë, u venë gjoksin furtunave, hidhen në flakë dhe rrinë vazhdimisht me gishtin në shënjestër para tronditjeve të mundshme.

* * *

Në zgjedhjen e profesionit, pranimi si njësi mase të dorës së parë i cilësisë së atij profesioni, për të qenë apo jo i përshtatshëm për shërbimin ndaj shoqërisë, për orientimin e drejtë të saj është shprehje e respektit ndaj së vërtetës dhe e kërkimit të vlerës. Ata që ecin në këtë rrugë pa u lëkundur nga thirrjet e “nimfave”, do të jenë arkitektët fatlumë të së ardhmes!..

Vullnetet e larta

Vullnetet dhe karakteret e larta, edhe sikur të shkrihen dhjetëra herë nëpër kazanë e të futen dhjetëra herë nëpër kallëpe të ndryshme, prapë s'kanë për të humbur gjë nga vetvetja dhe kanë për

ta mbrojtur qenësinë e vet. Po ç' duhet t' u themi atyre krijesave të pavullnet që ndërrojnë disa herë në ditë rrugë dhe mendim?

Të vetmuarit

I vetmuar nuk është ai që ka mbetur larg atdheut e familjes, që është ndarë prej miqve e shokëve. I vetmuar është ai të cilin shoqëria mes së cilës jeton, nuk e kupton, ai që me idealet e larta, me mendimet për botën përtej, me flijimin e kënaqësive personale për hir të të tjerëve dhe me këmbënguljen dhe vendosmërinë e jashtëzakonshme, bie shpesh në kundërshtim me grupet që ndjekin interesa të ngushta dhe përplasjet me to, ai që mjedisi e gjykon për të keq dhe e dëmton dhe që, me të gjitha qëndrimet, mbetet si i huaj!

Rruga e popullit

Rruga jonë është rruga e duartrokitjes së çdo lloj nisme dhe pune të dobishme në të mirë të atdheut dhe popullit dhe e mbështetjes së ushtrisë së të lumturve që u shërbejnë atyre. Nuk kemi për t'iu përgjigjur akuzave që na bëjnë për mohim dhe devijim, nuk kemi për t'i thënë mallkimit "amin, ashtu qoftë"!

Mendimi për t' u marrë vesh

Secili kërkon bindje në emër të frontit të vet, nuk kërkon paqe. Mirëpo Allahu thotë: "Hyni bashkërisht në paqe!"

* * *

Ejani, edhe në mos rënçim në marrëveshje, të paktën të mos biem në kontradikta ose çështjet dhe dallimet mes nesh të mos i zmadhojmë!

* * *

Është një favor i posaçëm i Allahut për bashkësinë, të cilin edhe personat që s'kanë shoq, madje, nuk mund ta arrijnë sado që të përpiqen!

Në fillim plan

Duke planifikuar një nismë apo punë çfarëdo, krahas shkaqeve shtytëse për te qëllimi, duhen kaluar një për një në sy edhe pengesat e mundshme në mënyrë që më pas as të kritikohen mangësitë që do të shfaqen, as dhe besimi i të tjerëve ndaj nesh të lëkundet!

Plani

Kur një punishte ose fabrikë ngrihet mbi një plan të mirë, premtori vazhdimësi dhe perspektivë, në të kundërt, kur në themel të saj nuk ka një mendim të shëndoshë e një llogari të bazuar, dështimi i saj është i pashmangshëm. Atëherë, ç'mund të thuhet për kombin, këtë qenie vështirë të kuptueshme, çdo aspekt i së cilës, si punët e shtetit dhe njeriu, është një fjalëkryq më vete?

Fundi dhe rezultati

Nuk është e rëndësishme zhurma dhe tërheqja në fillim, por dega me fruta në fund!

* * *

Rezultati i punëve të nisura pa menduar fundin, shpesh finalizohet me pendim.

* * *

Nuk mund t'i ngarkosh dhelprat të ruajnë qymezet!

* * *

Mjalti dhe kajmaku i sotëm që kanë për t'u bërë shkak nesër të gëlltitësh kripë e spec, janë më të hidhura se helmi!

* * *

Qesh mirë kush qesh i fundit!

* * *

Shumë gjëra që pandehen të dëmshme, për nga rezultati, janë të dobishme, kurse ato që pandehen të dobishme, mund të dalin në fund të dëmshme!

* * *

Momenti më i fundit i vështirësisë është fillimi i lehtësimit!..

Njeriu i kauzës

Fundja, nuk është kusht që burrat e së vërtetës të rrojnë pa tjetër mbi rrogozë!

* * *

Njeriu i kauzës nuk e ndryshon qëndrimin as kur është në fitore, as kur është në humbje!

* * *

Pa u rritur në shtëpitë e sakrificës, domethënë, pa u pjekur e maturuar me durim, çdo pritje është iluzion bruto!..

Pretekst-qëllim final

Te qëllimi final i drejtë e i vërtetë nuk arrihet me pretekste të paqena. Edhe pretekstet që do të përdoren, duhet të jenë reale!

Preteksti i paqenë

Sistemet e ngritura mbi gënjeshtër dhe ekzagjerime, edhe në qofshin jetëgjatë, herët a vonë shemben mbi krye të themeluesve të vet, duke mbetur veç një ëndërr e hidhur dhe një iluzion i përmalluar!..

Pasioni pas rehatisë

Çdo kauzë dhe e vërtetë e lartë fiton vazhdimësi dhe arrin një cilësi gjithëpërfshirëse me anë të vendosmërisë dhe besnikërisë së përfaqësuesve të saj, si dhe me anë të zellit dhe përpjekjeve që do të tregojnë për ta mbrojtur atë. Në të kundërt, nëse një kauzë e tillë, përballë sulmeve dhe goditjeve të shpeshta të armiqve, mbetet pa përkrahës dhe miq që e kuptojnë dhe besnikë, është e dënuar që herët a vonë të shembet e të fshihet nga kujtesa.

* * *

Ashtu siç ndodh që uji që s'ecën, të qelbet, edhe kalbja dhe humbja e njerëzve që e lëshojnë veten në rehati, është e pashmangshme. Dëshira për rehati të njeriut është shenja dhe alarmi i parë i vdekjes. Por, nëse një individ është paralizuar në ndjenja, as këtë shenjë nuk e dallon, as dhe kambanat e alarmit nuk i dëgjon. Natyrisht, ai nuk kupton asgjë as nga paralajmërimet e miqve të tij.

* * *

Dembelizmi dhe të shtënëti pas rehatisë trupore janë shkaqet më kryesore të çdo lloji mungese e varfërie. Nuk ka dyshim se shpirtërat e vdekura që e kanë lëshuar veten në prehrin e rehatisë, do të vijë një ditë që të bien aq poshtë, sa të presin nga të tjerët edhe nevojat e përditshme!

* * *

Kur pasionit për rehati t'i shtohet edhe pasioni ekstrem pas komoditetit shtëpiak, braktisja, më në fund, e luftës dhe vdekja shpirtërore e individit janë të paracaktuara. Por nëse, për më tepër, nuk parashikohet, sado pak, se ç'fshihet pas kësaj dhe gjendja vlerësohet me mendësinë e burrit me xhakëtë hedhur supeve, kjo është vetë fatkeqësia!

* * *

Në saje të dëshirës për të luftuar dhe “pasionit për kufij” ka lindur, nga një tribu e vogël, një perandori e madhe. Por, kur erdhi dita dhe vendin e kësaj dëshire dhe pasioni e zuri sevdaja për harem, një komb i stërmadh u shtri përtokë...

* * *

Ata që e kanë braktisur vendrojnë për pasionin për harem e komoditet shtëpiak, shpesh herë, në kundërshtim me qëllimin e vet, kanë ngrënë shpulla duke e humbur edhe vatrën familjare. Ç’kuptim të thellë kanë fjalët e thëna nga e ëma një komandanti andaluzian, që s’ka ditur të luftojë si burrë kur është dashur për të luftuar: “S’luftove dot në front si burrë, të paktën ulu e vër kujën si gratë!”

* * *

Tek njeriu, ndryshimi që çon në kalbje, zhvillohet shkallë-shkallë dhe jashtëzakonisht në heshtje. Për më tepër, disa herë, një mungesë e vogël vëmendjeje, një ndarje e vogël prej karvanit mund të shkaktojë humbjen. Ç’e do se të tillët, për shkak se vazhdojnë ta shohin veten në të njëjtën vijë, shpesh herë as që arrijnë ta dallojnë se kanë rënë nga maja e minares në fund të një gropë!..

* * *

Meqë ata që e braktisin vijën e luftës, me kompleksin e fajit të rrjedhur natyrshëm nga dezertimi, përfshihen nga mendimi kritik ndaj shokëve që shërbejnë dhe i mbrojnë, duket si e pamundur të shpëtojnë nga një perversitet i tillë e të kthehen në vijën e tyre të parë. Ndërsa profeti Adem, kur rrëshqiti, e rimori vendin shpejt, me një të hedhur, në saje të pohimit të fajit dhe pendesës, Djalli u ngrit ta mbrojë veten pavarësisht nga faji i madh që kishte bërë, andaj edhe ra në një disfatë të amshuar!..

* * *

Disa herë vërehet që personat me vetëdije, vullnet dhe vendosmëri të paralizuar ushtrojnë ndikim të madh asfiksues mbi guximin dhe fuqinë moral-shpirtërore të njerëzve përreth. Madje është vënë re shpesh se një lëkundje e vogël, një ngurrim i paktë i një njeriu të tillë të pavullnetshëm, bëhet shkak për lëkundje dhe pesimizëm sa vdekja e vërtetë e njëqind vetëve. Dhe kjo nuk vlen për tjetër veçse për t’u dhënë zemër e guxim armiqve të kombit dhe atdheut e për t’ua nxitur atyre oreksin që të na hidhen sipër!..

* * *

Bukuritë tërheqëse të botës, pasuria dhe fëmijët janë nga një provë më vete, nga një intrigë. Nxënësit më të suksesshëm të kësaj prove janë njerëzit fatlumë të vullnetshëm, të qëndrueshëm e të vendosur që mëngjes e mbrëmje i shprehin besnikërinë e tyre të Vërtetës pas të cilës janë lidhur me zemër!..

Pasioni për post

Ashtu siç ndodhen te njeriu esenca dhe farërat e shumë gjërave të mira, në funksion të disa qëllimeve, ndodhet edhe esenca e gjërave të këqija. Për shembull, krahas shprehive të bukura si mosdhënia pas interesit, sinqeriteti, vetëmohimi, syngopësia, te shumë vetë ndodhen edhe cilësi të këqija që e vrasin zemrën dhe e paralizojnë shpirtin si dashuria për post, mendimi për pozitë,

dëshira për t'u dukur. Nisur nga kjo, në marrëdhëniet me njerëzit duhet të krijojmë lidhje duke i mbajtur parasysh edhe këto aspekte të natyrshme në mënyrë që të mos zhgënjehemi!

* * *

Nëse dëshira për post e pozitë, dhe ndjenja e famës dhe popullaritetit që ndodhen në mënyrë të natyrshme shumë a pak te njeriu, nuk kënaqen në një mënyrë legale, ata që nuk arrijnë ta shpëtojnë veten prej këtyre komplekseve, mund të bëhen shumë të rrezikshëm si për vete, ashtu dhe për shoqërinë ku jetojnë. Ashtu siç pengimi i prirjes për t'u zbrazur te një element që ka arritur pikën e ngopjes, shkakton depresion, aritmi dhe shkatërrim, ashtu dhe shkatërrimi i botës sonë bëhet i pashmangshëm nëse dëshirat e thella te zemrat e robëruara nga fama dhe popullariteti nuk kanalizohen në një mënyrë të përshtatshme!

* * *

Edhe sikur çdo lëvizje dhe veprimtari e këtyre shpirtave vulgarë, të cilat pranohen si "e keqe relative" e tyre në rrugën për të kënaqur egot e veta, të konsiderohet, në një farë mase, si frakturë e shpirtit, duke u nisur nga përfundimi, mund të konsiderohet një "e keqe e mirë" përsa i përket pengimit të disa të këqijave dhe veprimit si pretekst për bukuri relative, madje, mund të konsiderohet edhe një e mirë e anasjelltë. Sigurisht, po qe se një këngëtar që kërkon për grykën e vet "të drejtën për të fituar", në vend që me anë të këngëve imorale të na spërkatë përreth tym dhe mjegull, zbrazet me një melodi hyjnore, me një kasidë të gjallë e me një temë mevludi, kjo është më pak e dëmshme, madje, për disa kjo mund të konsiderohet edhe e dobishme!

* * *

Sinqeriteti dhe qashtërsia janë shpirti i një pune si dhe karakteristika e autorit të saj. Sipas kësaj, pranueshmëria te Krijuesi e një akti çfarëdo varet nga kryerja e atij akti me gjithë zemër dhe me qëllimin për të mos pritur shpërblim, si dhe nga mosprania në shpirtin e autorit e asnjë gjëje tjetër veç pëlqimit të Zotit! Por ç'e do se është mjaft e vështirë që çdo individ të mund të bëhet në shërbim kaq i suksesshëm. Për rrjedhojë, opinionin mbi njerëzit duhet formuar sipas asaj se kush është sundues te ta: e mira apo e keqja. Sigurisht, ka punë të tilla që, megjithëse aspekti i tyre për dukje peshon më rëndë, nuk mund të pretendohet se janë absolutisht të dëmshme për idealet tona, për mendimet tona të shenjta dhe për njerëzit tanë. Njerëzit mund të përziejnë në punët që bëjnë kërkesat dhe dëshirat personale, pëlqimin e Zotit mund të mos e mendojnë për çdo radhë, mund të mos dinë të përthyhen më dysh me rënkim e pendesë për gabimet që bëjnë, por megjithëkëtë, kurrsesi nuk është e drejtë të thuhet se në besim dhe drejtim nuk janë me Zotin!

* * *

Megjithë këto, nëse secili prej individëve që shërbejnë brenda një ekipi, ngrihet ta përfaqësojë personalisht dhe në mënyrë të pavarur fushën ku shërben, dhe më pas, nëse edhe të tjerët, duke e parë atë, mbërthehen nga dëshira për t'u dukur në fushat e veta, disiplina e grupit prishet, çdo gjë kthehet përmbys dhe shkohet me shpejtësi drejt anarkisë. Më pas, në çdo pjesë të bashkësisë u hapet rrugë lëvizjeve të veçuara për llogari të egoizmit të personave, koka ngatërrohet me këmbët e këmbët, me kokën dhe autoriteti qendror shembet e mbaron.

* * *

Kur figurat e suksesshme brenda një qeverie, elementet aktive në trup të shtetit, shpirtat dinamike dhe ngadhënjyese brenda një institucioni kërkojnë pjesën e luanit sipas kapaciteteve dhe sukseseve personale, qeveria paralizohet, shteti shembet, institucioni kthehet në një monstër njëqindgojëshe. Qeveria ekziston me disiplinën e vet, shteti, me bazat dhe parimet e veta, ushtria, me bindjen, me respektimin e parimit të urdhrit dhe komandimit. Përpjekja për të pretenduar të

kundërtën e kësaj do të thotë të bësh sikur s'di gjë për këto elemente jetësore si garante të qenies sonë gjer më sot.

* * *

Eh, sikur zemrat, duke u kënaqur me aq sa ç'u jep e ç'do t'u japë Krijuesi i Lartë, të kërkonin, në çdo vatër, pëlqimin e Tij! Mirëpo duket se një sërë zemrash egoiste, që ua kanë kthyer shpinën rrezeve ndriçuese të diellit duke u kënaqur me dritën e amullt të fenerit që mbajnë në dorë, do të vazhdojnë edhe ca kohë të mos i korrigjojnë shikimet e tyre miope, për çka edhe nuk do të mund ta gjejnë derën e ndriçimit!..

Tensionimi i humbur

Çdo sukses është rezultat i një vuajtjeje, tensionimi dhe hapi, kështu, në një kuptim, edhe shkaku i një suksesi të dytë. Mjafton që personat që arrijnë një rezultat, të dehur nga fitorja, të mos e lëshojnë veten në komoditet e rehati!..

Defekt mase

Nga dje e gjer më sot, të gjitha të këqijat iu bënë popullit të pranueshme duke e bindur atë se "ka edhe më keq"! Për më tepër, ato u nxitën të duartrokiten si "e keqe e mirë"! Krejt si në fjalën e urtë, "Kur shoh të pafënë, lus mëshirë për mosbesimtarin!" Pavarësisht nga ç'sistem i mallkuar të burojnë kjo ide tradhtare, pranimi i një relativiteti të tillë për besimin tonë, mendimin tonë historik, për zakonet dhe traditat tona si një e vërtetë absolute duke e bërë, pastaj, njësi mase, s'është gjë tjetër veçse miratimi i një shfisnikërimi dhe shpërfytyrimi të pafund...

Dy qëndrime të skajshme

Ekstremizëm mund të ketë në çdo ide, në çdo mendim. Që të dy skajet e këtij ekstremizmi kanë vlerën e një helmi vrasës. Sigurisht, ashtu siç janë gënijyer ata që e kanë kërkuar thjeshtësinë, virtytin, çdo gjë sublime në veshjen dhe pamjen e jashtme të mjerë e të hallakatur, në një postiqe të vjetër, në një poçe të thyer dhe në një banesë me merimanga, ashtu janë gënijyer edhe ata që e kanë kërkuar në kësulën e një frëngu a në një veshje dekolte!

Përfytyrime prej beduini

Nëse përfytyrimet radhiten në drejtim të një ideali të lartë dhe iluzionet gjejnë mbështetje nga arsyeja, njeriu ka mundësi të arrijë në mendime të ndriçuara dhe suksese njëra pas tjetrës. Në të

kundërt, ëndërrimet prej beduini nuk kanë ndonjë dobi as për hapa shkencore, as dhe për ta gjetur të vërtetën!

Vorbulla e egoizmit

Amaneti i un-it i dhënë njeriut është një dhuratë e shenjtë kushtuar atij në udhën e kërkimit, gjetjes dhe njohjes së të vërtetës më të madhe, ndërkaq, një dhuratë që, sapo të marrë fund kjo detyrë, e domosdoshme për t'u përplasur për guri e për t'u thyer. Në qoftë se nuk veprohet kështu, un-i fryhet e bëhet një demon që e gëlltit të zotin. Me të, individi do ta njohë Krijuesin e Lartë, pafundësinë e fuqisë, diturisë dhe vullnetit të Tij, do të kuptojë se të metat e mangësitë nuk mund të futen në "zonën" e Tij e, pastaj, me zjarrin e dashurisë dhe afërsisë të ndezur në zemër për Të, do ta shkrijë un-in, kështu që do të shohë vetëm qenien e Krijuesit të Lartë, do të mendojë e do të kuptojë me Të dhe vetëm me Të do të marrë frymë!

* * *

Mbetja vetëm si egoist është shprehje e shikimit, por e mosnjohjes së Zotit, e pamundësisë për të ecur para në rrugën e pafundësisë dhe e rrotullimit me sy mbyllur në të njëjtin vend. Ata që mendojnë vazhdimisht për llogari të vetvetes, ata që ulen e ngrihen vetëm me egon e vet, dhe ata që kërkojnë atë që kërkojnë vetëm në atmosferën e errët të egos, edhe sikur të ecin me vite të tëra duke kapërcyer maja e gropa, nuk mund të bëjnë para as edhe një hap.

* * *

Nëse punët e bëra bëhen për llogari të un-it, edhe sikur të jenë më të rëndat e më të lodhshmet e punëve, kurrsesi nuk premtjnë vlerë dhe nuk marrin miratim në audiencën hyjnore. Çdo hap drejt botëve të përtejme i njerëzve që nuk e kanë kapërcyer dot veten, që nuk i kanë ngulur thikën për ta copëtuar un-in e që e kanë të mbyllur parashikimin, është një ngushëllim dhe vetëmashtrim, kurse çdo sakrificë e tyre, një punë e pamend!

* * *

Ngaqë egoizmi është një atribut djallëzor, nuk duhet të kihet dyshim se ata që kapen prej tij, ai ka për t'i çuar po në atë përfundim ku shkoi djalli. Edhe justifikimet dhe mbrojtjet e djallit, madje, janë nga një melodi e rëndë djallëzore. Ndërsa profeti Adem, në çastin kur horizonti iu errësua, krijoi, me anë të lotëve, re të reja me të cilat u përpoq të shuante zjarrin e zemrës, zjarrin e mallit, Djalli numëronte e derdhte justifikime, çdo fjalë e të cilave ishte krenari dhe inat, çdo shprehje e të cilave, paturpësi...

* * *

Egoizmi ka shumë lloje si ai i buruar prej diturisë, i dalë në shesh me anë të pasurisë dhe pushtetit, i fryrë e i zmadhuar me anë të bukurisë, etj. Meqë asnjëri prej këtyretributeve s'është pasuri personale e njeriut, çdo pretendim në këtë çështje është quajtur një pretekst dhe ftesë ndaj ndëshkimit të Pronarit të Vërtetë të Gjithësisë dhe është finalizuar me shkatërrimin e këtyre shpirtave shumëpretendues...

* * *

Egoja që ka vënë nën ndikim botën personale të individit, kur vihet sup më sup edhe me një egoizëm bashkësie, bëhet tamam një div dhe kthehet në një demon përdhunues. Më në fund, edhe gjërat më të dobishme në duar të një shpirti të harbuar kësisoj, bëhen si një re sterrë e zezë, dhe ai nis të hedhë përreth gjyle e bomba! Po, dituria në duar të njerëzve të tillë, kthehet në një dritë të

rreme, pasuria, në shkak dukjeje, zemra, në shtrat akrepash, bukuria, në një faqe ankthi që shpërndan përreth thartësirë, zgjuarsia, në një dallkawk keqndjellës që i nënvleftëson të tjerët...

* * *

Që në krye të herës, filozofia materialiste ka përfaqësuar egoizmin, kurse profetësia, të vërtetën dhe përlulen. Ndërsa në rrugën e të parëve ka patur dyshime, lëkundje, mashtrime, forcë dhe dhunë, përplasje të frikshme si përplasia e ajsbergëve me njëri-tjetrin dhe copëtim të frikshëm me bubullimë, në rrugën e të dytëve ndriçime, prehje shpirtërore, vrapim në ndihmë të njëri-tjetrit dhe mbështetje për njëri-tjetrin...

* * *

Gjendja shpirtërore me prirje për t'ua treguar veten të tjerëve në çdo rast, është shprehje te ai njeri e një të mete dhe e kompleksit të inferioritetit. Kjo gjendje vazhdon gjer ditën kur, me një edukim të mirë shpirtëror, do t'ia dorëzojnë qenien Pronarit të Vërtetë. Çdo punë e tyre, një punë për dukje, çdo thënie e tyre, egoizëm gurgullues, çdo sjellje përlulësie si dhe modestia e tyre, ose hipokrizi, ose investim për t'ua treguar veten të tjerëve. Një mijë mallkime egoistëve që s'e njohin të drejtën!

* * *

Egoisti jo vetëm që s'ka mik të vërtetë, por nuk ka as qetësi ndërgjegjeje.

Në rrugën e pafundësisë

Krijuesi i Lartë, ekzistenca e të cilit është shkaku i ekzistencës sonë, i ka rrethuar gjithë botët me madhështinë e Tij, drita e Tij duket në çdo gjë. Qiejt dhe toka janë nga një vezullim prej rrezatimeve të nurit të Tij, janë, me të gjithë qenien e tyre, nga një skllav me vëth në vesh të Tij! Ai është altari i amshuar i shpirtrave të përkryer që e kanë gjetur të vërtetën, Ai është e vetmja qenie që njohin të diturit me ndjenjat ngritur peshë dhe Ai është e vetmja kible, i vetmi orientim! Ta lësh Atë për të vrapuar te dikush tjetër, është marrëzi, t'ia qash hallet dikujt tjetër veç Atij, një vetëmashtrim. Ata që largohen prej portës së Tij, pësojnë disfatë të amshuar dhe mbeten në rrugë, zemrat që s'ndriçohen dot me dritën e Tij, ndjekin iluzionin optik në shkretëtirë dhe lodhen më kot. Botët ndriçohen fund e krye me dritën e Tij duke u kthyer në një libër. Me anë të frymëmarrjeve të magjishme në rrugën e Tij, koha del nga konvencionaliteti duke fituar një kuptim dhe vlerë...

Ai është që i ka dhënë materies ekzistencë, e ka vënë në rregull dhe e ka bërë të flasë me një mijë e një gjuhë. Po të mos krijonte Ai, asgjë nuk do të dilte në shesh vetvetiu, po të mos vinte rregull Ai, asgjë nuk do ta njihte rregullin. Me favorin e Tij, botët janë shndërruar në njeri, kurse rregullsia, në gjuhë. Çdo gjë mëmërit emrin e Tij dhe me bukuritë e Tij dehet! Po qe se qenia nuk do të ishte pasqyrë e Tij, ç'ndryshim do të kishte nga hekuri i ndryshkur? Po qe se njeriu nuk do të jetë në gjendje ta tregojë Atë, a mund t'i thuhet njeri? Ah, ju shpirtra të errëta, ju shurdhër që nuk e dëgjoni klithmën e ndërgjegjes! Gjer kur do t'i mbani mbyllur sytë ndaj së vërtetës, duke u ngushëlluar me lojëra të pakuptimta?..

Njeriu u beson në fillim gjërave që i përcakton me anë të organeve të shqisave meqë fiton ekzistencë në një botë të rrethuar krejt nga materia, pastaj, me kuptimet që shprehin këto, përpiqet ta shohë të vërtetën në ndërgjegjen e vet duke thyer "kularin e varur në qafë të qenies" së vet. Ç'e

do se nuk janë të paktë ata që ngecin diku në këtë zinxhir të hollë dhe nuk arrijnë të bëjnë as dhe një hap më tej. Prandaj, materia që na rrethon ngado, sa herë që të merret për t'u studiuar, duhet lexuar si një libër dhe duhet dëgjuar si një kor dhe, duke e lexuar a duke e dëgjuar, nuk duhet harruar ai që e ka shkruar librin apo ai që e drejton simfoninë. Në të kundërt, ashtu si budallai që e kontrollon materien fije për pe dhe mbytet në argumente pa ndjerë në ndërgjegje frymëmarrjet e së vërtetës, kurrë s'ka për ta gjetur Atë dhe kurrë s'ka për të arritur të gjejë kënaqësi, ashtu dhe shpirtrat e pafat që nuk munden të ngjiten tek e vërteta në ndërgjegje duke shpuar perdet e veshëve dhe syve me anë të Fjalës së Tij, nuk do të mund ta njohin Atë!

O Ti me mëshirë të pafundme që na i jep dritë ekzistencës me anë të ekzistencës Sate, që na u spërkat dritë syve e që na shpëton ne prej errësirave egoiste! Po të mos ishte kjo drita Jote e amshuar që u jep dritë botëve, ne nuk do ta shihnim drejt asgjë dhe nuk do të mund të jepnim asnjë konkluzion të drejtë! Të gjithë ne fituam ekzistencë në saje të favorit Tënd, e mësuam të vërtetën me ç'na tregove Ti! Po qe se s'do të kishe pasur mirësinë t'ua njoftoje ekzistencën Tënde shpirtrave tanë, si do të njihnim Ty, si do të ngopeshim me Ty?

Ti je Ai që e ka bërë çdo qenie, një gjuhë dhe, mes këtyre gjuhëve, njeriun, një bilbil! Po, kështu bërë, pastaj na dhe mundësi t'i lexojmë ajetet e Tua që i shpërndave në çdo vatër dhe na e njoftove edhe një herë tjetër të vërtetën e amshuar në ndërgjegjjet tona! Në saje të kësaj e ndiejmë ne lidhjen mes Krijuesit dhe krijesës, hidhemi lart për te Ti, me burimet e intuitës në zemrat tona. Gjithashtu në saje të kësaj ne shpëtojmë prej labirinteve të errëta të egos, prej të panjohurave të botës ndjesore të kthyerë në vorbull dhe mbrohemi! Duke të njohur Ty, gjetëm esencën e dijes dhe njohëm bukuritë e qëndisura prej Teje në shpirt të materies. Dhe nëse tani i kuptojmë urtësitë në fytyrë të çdo qenieje, i dëgjojmë, në çdo zë në natyrë, tingujt më të ëmbël brenda një burimi muzikor, kjo është krejtësisht sajë Teje! Në librin Tënd të shkëlqyer që na e shtrove para, ekspozove tablo me bukuri të pashoqe duke na i ngritur zemrat peshë! Duke na e zgjidhur gjuhën, na nderove me mundësinë që na dhe për t'u thurur epose bukurive të Tua! Edhe sikur me qindra herë ta studionim këtë librin e gjithësisë që është ekspozitë e bukurisë Sate të pangjashme, edhe sikur t'i dëgjonim shumë herë me radhë tingujt që mërmërisin ekzistencën Tënde dhe sikur të niseshim t'ua ofronim pa pushim këtë libër e këta tinguj shikimit e dëgjimit të spektatorëve të Tu të pasionuar, prapëseprapë nuk do të ngopeshim dot me këtë klimën dritësore Tëndën, përsëri do të vraponim për të të dëgjuar Ty e për të të ndjerë Ty dhe, si të pasionuar të rrugës Tënde, vetëm Ty do të të pëshpërisnim ndër buzë!

O Mbreti që na i bën të afërta zemrat për bukuritë e fshehta të ekzistencës Sate! Qindra herë gjer më sot na folën për Ty, shumë herë me radhë u ofruan ujë parajsor zemrave të etura për dashurinë Tënde. Po ç'do, tani, pranë zërave si frymë parajsore të atyre shpirtrave të shkëlqyer të bërë dheu e pluhuri i rrugës Sate, fjala e këtij zëri të këputur, e kësaj violine të thyer?..Por, duke e bërë vel për fytyrën tonë të paturpshme mirëkuptimin Tënd të gjerë, që i fal gjithkujt të drejtën e fjalës, përkrah thirrjeve të lajmëtarëve të ndryshëm dhe fjalës oratorike të Burrit të Fjalës të portës Sate, strehohemi nën faljen Tënde duke thënë: "Ja dhe zëri ynë i prerë e i këputur!"..

Prapë, fjala atyre u takon. Duke e pohuar edhe një herë këtë, do të përpiqemi, që, në përputhje me fjalën e tyre, të të tregojmë sërishmi Ty dhe të arrijmë oqeanet e pafunda të aftësisë për të të njohur Ty!

Dëgjuam, gjer tani, një sërë lajmëtarësh që na kanë treguar për Ty, u vumë veshin zërave të tyre, e i kapëm sakaq shenjat e tyre. Dhe tani, duke i pranuar të çarat e hapura gjer këtu, si nga një dritare më vete, kërkojmë, me anë të shenjave dhe shenjuesve të Tu, të pyesim për Ty në çdo gjë, të të kërkojmë Ty në çdo vend dhe të ngjitemi nëpër rrugë të ndryshme për te Ti!

Na i ndriço sytë me nurin Tënd, dhe jepu zemrave tona shërim! Duke u falur këtyre rojeve të portës Sate që vrapojnë në ndihmë të atyre që kanë mbetur në rrugë, edhe një herë tjetër mundësinë për të treguar për Ty, jepu gëzimin e amshuar skllevërve që s'pranojnë çlirim të rrugës Sate! Ty të ka hije madhështia, kurse atyre, në fjalën për Ty, përulësia!..

Lutja

Lutja është ushqimi i shpirtit, ndaj ky ushqim i duhet dhënë pandërprerë!

* * *

Lutja është një magjistar që i jep krahë vullnetit; sekretin e kësaj nuk arrijnë ta kuptojnë veçse ata që luten vazhdimisht!

* * *

Duke i kapërcyer shkaqet dhe pretekstet, lutja është edhe siguria në fuqinë e Allahut, edhe shpallja e dobësisë së njeriut!

* * *

Virusi më i rrezikshëm që i bie në qafë lutjes është njohja e shkaqeve si agentë të vërtetë. Shpirti i kapur nga ky virus kërkon mjekim "ekstra"!

* * *

Lutja më e mirë e bërë kundër dhunës, është lutja e bërë në kohën e prehjes dhe rehatisë!

* * *

Zoti im! Shtoma besimin dhe sigurinë në Ty dhe në lutjet drejtuar Ty dhe më bëj ta ndiej me vetëdije se respektimi i shkaqeve është një detyrë!

* * *

Zoti im! As nuk kam mundësi ta duroj ndëshkimin Tënd, e aq më pak kam fuqi të mbes pa mëshirën Tënd!

* * *

Zoti im! E në befsha pabesi duke ndenjur larg Teje, gjendja ime thërret me të madhe se nuk do të mund të rri pa Ty! E kërkoj ndihmesën Tëndë, jo për të shpëtuar prej pabesisë sime, por ngase kam aq shumë nevojë për Ty!..